



STUDIME PASDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË

Studime për Shkenca Politike

Teza:

Ndryshimet politike në Ballkanin Perëndimor pas Luftës së Ftohtë

Kandidati:
Elton Jashari

Mentori:
Prof. Dr. Jonuz Abdullai

Tetovë,
Korrik, 2020

Përmbajtja

Lista e shkurtesave.....	4
Abstrakt.....	7
Abstract.....	8
Hyrje.....	9
I - Fundi i Luftës së Ftohtë.....	11
1. Pasqyrë e shkurtër rreth periudhës së Luftës së Ftohtë.....	11
1.1 Faktorët që ndikuan në dobësimin e intensitetit të Luftës së Ftohtë.....	13
2. Rënia e Murit të Berlinit.....	15
3. Shembja e Bllokut Socialist dhe ndryshimet politike në Evropën Qendrore dhe Juglindore.....	17
4. Shpërbërja e Bashkimit Sovjetik.....	20
5. ShBA dhe Rendi i Ri Botëror.....	24
5.1 Rendi i Ri Botëror dhe Globalizimi.....	27
5.2 Politika Globale e ShBA-ve.....	28
5.3 Politika e Jashtme e ShBA-së në Ballkanin Perëndimor.....	29
II - Ndryshimet Politike në shtetet e Ballkanit Perëndimor – Procesi i tranzicionit.....	31
1. Shpërbërja e Jugosllavisë dhe formimi i shteteve të reja.....	31
1.1 Lufta në Bosnjë dhe Hercegovinë.....	35
1.2 Ndërhyrja e faktorit ndërkombëtar.....	36
1.3 Arritja e Marrëveshjes Paqësore të Dejtonit.....	38
1.4 Statusi i Kosovës brenda RSFJ-së dhe pas shpërbërjes së saj.....	40
1.5 Lufta në Kosovë dhe pavarësi.....	41
2. Shqipëria – fundi i regjimit komunist dhe procesi i tranzicionit.....	43
2.1 Aspekte historike të rrëgjimit komunist në Shqipëri.....	43
2.2 Vdekja e Enver Hoxhës dhe ardhja e Ramiz Alisë në pushtet.....	47
2.3 Fundi i regjimit komunist.....	48
2.4 Periudha e ndryshimeve politike dhe tranzicioni.....	51
2.5 Kriza e Skemave Piramidale e vitit 1997.....	56
2.6 Periudha e stabilizimit dhe procesi i integritimit në strukturat Euro - Atlantike.....	58

3. Procesi i tranzicionit dhe ndërtimi i institucioneve shtetërore	60
3.1 Aspekte historike dhe teorike të tranzicionit	60
3.2 Tranzicioni në shtetet ish – komuniste.....	61
3.3 Procesi i privatizimit, ndërtimi i institucioneve shtetërore dhe sfidat e tjera të tranzicionit	63
4. Roli i Shoqërisë Civile në demokratizimin e shoqërisë.....	66
4.1 Në përgjithësi mbi Shoqërinë Civile dhe liritë dhe të drejtat e njeriut	66
4.2 Zhvillimi i Shoqërisë Civile në shtetet ish-komuniste	67
4.3 Shoqëria Civile në Republikën e Maqedonisë së Veriut.....	69
III - Ndryshimet politike në Republikën e Maqedonisë gjatë periudhës 1991-2001.....	73
1. Pavarësia e Maqedonisë nga Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë.....	73
2. Zgjedhjet e para të lira dhe demokratike.....	75
3. Procesi i privatizimit gjatë periudhës së tranzicionit	77
4. Konflikti i armatosur i vitit 2001 dhe pasojat.....	79
4.1 Statusi politik i popullit shqiptar dhe diskriminimi institucional ndaj tyre para vitit 2001	79
4.2 Konflikti i armatosur i vitit 2001	83
5. Marrëveshja Kornizë e Ohrit dhe ndryshimet kushtetuese.....	84
6. Kriza politike në Maqedoni dhe sfidat me të cilat ballafaqohet shoqëria bashkëkohore	89
Konkluzione dhe rekomandime	97
Bibliografia	102

Lista e shkurtesave

- APJ – Armata Popullore Jugosllave
- ASNOM – Kuvendi Antifashist për Çlirimin Kombëtar të Maqedonisë (Антифашистичко собрание на народното ослободување на Македонија)
- BDI – Bashkimi Demokratik për Integrim
- BE – Bashkimi Evropian
- BH – Bosnjë dhe Hercegovinë
- BRSS – Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike
- FOSM – Fondacioni Shoqëri e Hapur – Maqedoni (Foundation Open Society Macedonia)
- HDZ – Unioni Demokratik Kroat (BH)
- IPA – Fonde të Bashkimit Evropian (Instrument for Pre – Accession Assistance)
- IRJM – Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë
- KFOR – Misioni Paqeruajtës Ndërkombëtar në Kosovë i udhëhequr nga NATO (The Kosovo Force)
- KGB – Komiteti për Sigurinë e Shtetit në BRSS
- LDK – Lidhja Demokratike e Kosovës
- LKJ – Lidhja Komuniste e Jugosllavisë
- LSDM – Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë
- MSA – Marrëveshja e Stabilizim – Asociimit
- NATO - Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut (North Atlantic Treaty Organization)
- NED – Fondi Kombëtar për Demokracinë (National Endowment for Democracy)
- OJQ – Organizatë Joqeveritare
- OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuara
- OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (Organization for Security and Co – operation in Europe)
- OShC – Organizatë e Shoqërisë Civile
- PAD – Partia Aleanca Demokratike
- PBK – Partia e Ballit Kombëtar

- PBDNj – Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut
- PD – Partia Demokratike
- PDSH – Partia Demokratike Shqiptare
- PDP – Partia Demokratike Popullore
- PR – Partia Republikane
- PSA – Procesi i Stabilizim – Asociimit
- PSD – Partia Socialdemokrate e Shqipërisë
- PS – Partia Socialiste
- PPD – Partia për Prosperitet Demokratik
- PPSH – Partia e Punës e Shqipërisë
- RD e Gjermanisë – Republika Demokratike e Gjermanisë
- RF e Gjermanisë – Republika Federale e Gjermanisë
- RM – Republika e Maqedonisë
- RMV – Republika e Maqedonisë së Veriut
- RSFJ – Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë
- RRF - Trupat ushtarake për intervenim të shpejtë të OKB-së gjatë luftës në BH (Rapid Reaction Force)
- SDA – Partia e Veprimit Demokratik (BH)
- SDC – Zyra për Bashkëpunim me Maqedoninë e Veriut pranë Agjensisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
- SDS – Partia Demokratike Serbe (BH)
- ShBA – Shtetet e Bashkuara të Amerikës
- UÇK – Ushtria Çlirimtare e Kosovës
- UÇK – Ushtria Çlirimtare Kombëtare
- UNDP - Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (United Nations Development Program)
- UNPROFOR – Misioni Paqeruajtës i OKB-së gjatë luftës në BH (United Nations Protection Force)

- USAID - Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (United States Agency for International Development)
- UT – Universiteti i Tetovës
- VMRO – DPMNE - Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partia Demokratike për Unitetin Kombëtar Maqedonas (Внатрешна македонска револуционерна организација - Демократска партија за македонско национално единство)

Abstrakt

Ky punim synon të analizojë dhe të hulumtojë procesin e ndryshimeve politike që ndodhën me mbarimin e Luftës së Ftohtë, në shtetet e Evropës Qendrore, Juglindore e në veçanti në shtetet e Ballkanit perëndimor. Duke hedhur dritë mbi rrethanat historike dhe zhvillimet të cilat karakterizuan modelin bipolar të marrëdhënieve ndërkombëtare gjatë Luftës së Ftohtë, jemi përqendruar kryesisht në periudhën pas shembjes së Murit të Berlinit në nëntor të vitit 1989 dhe mbi formimin e shteteve të reja si rezultat i procesit të shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik dhe Bllokut Socialist në përgjithësi, si dhe nga shpërbërja e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë. Për fat të keq, jo të gjithë shtetet fituan pavarësinë dhe sovranitetin e tyre në mënyrë paqësore, dhe duke u nisur nga ky fakt, kemi analizuar shfaqjen e politikës hegjemoniste dhe nacionaliste në shtete të caktuara, që rezultoi me krijimin e raporteve të tensionuara dhe shpërthimin e konflikteve ushtarake në territoret e ish RSFJ-së.

Periudha e tranzicionit paraqet një proces shumë kompleks, i cili në vete ngërthen transformime dhe ndryshime rrënjësore të shoqërisë, duke u reflektuar në çdo segment të jetës sociale të individit. Në këtë hulumtim, vëmendje e veçantë i është kushtuar periudhës së tranzicionit dhe të demokratizimit të shoqërive në shtetet e Ballkanit Perëndimor, duke analizuar në mënyrë më të detajuar kalimin nga sistemi njëpartiak komunist në sistemin pluralist demokratik, në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në Republikën e Shqipërisë.

Ndërkaq, arsyeja kryesore e përcaktimit të kësaj teme për të shtjelluar, bazohet në interesimin personal dhe nevojën shkencore për analizimin e problemeve dhe sfidave me të cilët është përballuar shoqëria jonë dhe shtetet tjera ish – komuniste gjatë procesit të tranzicionit të stërzgatur, që janë paraqitur si gjeneratorë të krizave të njëpasnjëshme politike dhe ekonomike. Trajtimi dhe njohja më e mirë e këtyre problemeve substanciale, na bën që të jemi më koshient në të ardhmen, që përmes zgjidhjes së tyre të arrijmë në demokratizimin e mirëfilltë të shoqërisë, funksionimin e shtetit të së drejtës dhe institucioneve shtetërore, avancimin e shoqërisë qytetare dhe të drejtave të njeriut, si dhe sigurimin e ardhmërisë afatgjate të vendit dhe rajonit me integrimin në NATO dhe Bashkimin Evropian.

Abstract

This paper aims to analyze and research the process of political change that occurred with the end of the Cold War, in the countries of Central and Southeast Europe and in particular in the countries of the Western Balkans. By shedding light on the historical circumstances and developments that characterized the bipolar model of international relations during the Cold War, we focused mainly on the period after the fall of the Berlin Wall in November 1989 and on the formation of new states as a result of the disintegration process of the Soviet Union and the Socialist Bloc in general, as well as the dissolution of the Socialist Federal Republic of Yugoslavia. Unfortunately, not all states gained their independence and sovereignty peacefully, and based on this fact, we have analyzed the emergence of hegemonic and nationalist policy in certain states, which resulted in the creation of tense relations and the outbreak of military conflicts in the territories of the former SFRY.

The transition period represents a very complex process, which in itself involves radical transformations and changes in society, being reflected in every segment of the social life of the individual. In this research, special emphasis is placed on the period of transition and democratization of societies in the Western Balkans, analyzing in more detail the transition from a one-party communist system to a pluralistic democratic system in the Republic of North Macedonia and the Republic of Albania.

Meanwhile, the main reason for defining this topic to elaborate is based on personal interest and scientific need to analyze the problems and challenges faced by our society and other former communist states during the long transition process, which are presented as generators of successive political and economic crises. The better handling and recognition of these substantial problems, makes us more aware in the future, that through their solution we can achieve genuine democratization of society, the functioning of the rule of law and state institutions, the advancement of civil society and human rights, as well as ensuring the long-term future of the country and the region with NATO and European Union integration.

Hyrje

Rënia e Murit të Berlinit dhe bashkimi i Gjermanisë në fund të viteve '80 të shekullit XX, ishin dy ngjarje shumë të rëndësishme, që shënuan fundin e periudhës së Luftës së Ftohtë, e cila zgjati pothuaj 40 vite, dhe definoi sistemin bipolar të marrëdhënieve ndërkombëtare. Vala e ndryshimeve politike, dhe përmbysja e sistemit komunist në shtetet e Evropës qendrore dhe juglindore u shfaq si një nevojë e kohës dhe si diçka që domosdoshmërisht duhej të ndodhte, duke e pasur parasysh situatën e rëndë socio – ekonomike të qytetarëve dhe pakënaqësitë dhe konfrontimet e vazhdueshme të tyre me regjimet ekzistuese. Natyrisht, shtetet që ishin pjesë e ish RSFJ-së dhe shtetet tjera komuniste të Ballkanit Perëndimor nuk mbetën immune ndaj këtyre ndryshimeve, kështu që edhe ato në këtë proces shihnin fundin e pashmangshëm të regjimit komunist dhe mundësinë për transformim dhe demokratizim të shoqërive të tyre.

Në fillim të procesit të tranzicionit dhe gjatë ngritjes së institucioneve demokratike dhe strukturave të ekonomisë së tregut, gati se të gjithë shtetet ish komuniste u gjetën para sfidave dhe problemeve të njëjta që ky transformim shoqëror i ngërthente në vete. Problemet më të shpeshta me të cilët këto shtete u ballafaquan ishin: rritja e papunësisë, inflacioni i lartë, keqpërdorimet në procesin e privatizimit të pronës shtetërore dhe grabitja e saj, paraqitja e korrupsionit, ulja e standardit jetësor, dështimi në rritjen e prodhimit dhe efikasitetit në industri, etj. Gjithë këto probleme, së bashku me reformat ekonomike joproductive, implementimi i tyre në mënyrë të cunguar si dhe zhvillimi i politikës diskriminuese dhe nacionaliste sollën kriza dhe gjendje jo stabile sociale në mënyrë të vazhdueshme. Në disa shtete të Ballkanit Perëndimor, këto probleme u përcjellën edhe nga konfliktet ushtarake ndëretnike, të cilat në mënyrë plotësuese e vështirësuan procesin e tranzicionit dhe përpjekjet për konsolidimin shoqëror demokratik dhe liberal.

Republika e Maqedonisë së Veriut, e cila tashmë gjendet në dekadën e tretë që nga pavarësimi i saj, duket se ende nuk ka gjetur mënyrën për të dalur nga procesi i stërzgatur dhe i vështirë i tranzicionit. Në periudhën e hershme të pavarësimi të saj, Maqedonia e Veriut zhvilloi një politikë mjaft diskriminuese dhe nacionaliste ndaj minoriteteve dhe popullsisë shqiptare, që

jetojnë në të. Zhvillimi i kësaj politike diskriminuese, mospërfillja e kërkesave të shqiptarëve për avancimin e statusit të tyre si popull shtetëformues, shtypja institucionale dhe ushtrimi i dhunës së tepërt ndaj tyre i dëshmuar në shumë raste, ishin disa prej faktorëve që sollën deri në Konfliktin Ushtarak të vitit 2001, i cili u përmbyll me nënshkrimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, me anë të së cilës u rregullua çështja e avancimit të statusit dhe e të drejtave të popullit shqiptar në RMV. Me këtë, u hap një faqe e re në historinë e shtetit, në raportet ndëretnike në mes dy etniteteve më të mëdha (shqiptarëve dhe maqedonasve) dhe minoriteteve tjera, në zhvillimin e konceptit qytetar si dhe në karakterin multietnik të shtetit.

Ky punim është i strukturuar dhe i ndarë në tre kapituj, të cilët organikisht ndërlidhen dhe shtjellojnë tema që rrjedhin nga vetë titulli i tezës që kemi përzgjedhur për të hulumtuar. Fillimisht, në kapitullin e parë analizohet periudha e Luftës së Ftohtë, fundi i saj që u shënuar nga rënja e Murit të Berlinit, ndryshimet politike në shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore, shembja e BRSS-së dhe Bllokut Socialist dhe ngritja e Rendit të Ri Botëror të kryesuar nga SHBA. Në kapitullin e dytë, kemi analizuar ndryshimet politike në Shtetet e Ballkanit Perëndimor, më konkretisht shpërbërjen e RSFJ-së dhe formimin e shteteve të reja, fundin e regjimit komunist dhe procesin e tranzicionit në Republikën e Shqipërisë, si dhe në përgjithësi ndërtimin e institucioneve shtetërore demokratike e konceptin dhe rolin e shoqërisë civile në procesin e demokratizimit. Në kapitullin e tretë jemi përqendruar në analizën e procesit të tranzicionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke filluar me shpalljen e pavarësisë në vitin 1991 dhe duke vazhduar me krizat politike dhe ekonomike, procesin e privatizimit, shpërthimin e Konfliktit të armatosur të vitit 2001, ndryshimet kushtetuese pas Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, dhe elaborimin e sfidave me të cilat ballafaqohet shoqëria bashkëkohore në vend.

I - Fundi i Luftës së Ftohtë

1. Pasqyrë e shkurtër rreth periudhës së Luftës së Ftohtë

Pas Luftës së Dytë Botërore në skenën ndërkombëtare lindën dy shtete të fuqishme me sisteme antagoniste politiko – shoqërore dhe ekonomike dhe kjo do të shënojë fillimin e një modeli të ri bipolar të marrëdhënieve ndërkombëtare, periudhë e cila ndryshe njihet edhe si Lufta e Ftohtë. Kjo periudhë karakterizohet për nga gjendja *as luftë as paqe* dhe gjithashtu për nga synimi i fuqive të mëdha për hegjemoni, por në të njëjtën kohë nga këto dy superfuqi shihej edhe si mundësi për zgjidhjen e konflikteve të tyre të ndërsjella. Për më tepër, vlen të përmendet se në këtë fazë të marrëdhënieve ndërkombëtare u zhvillua një nivel komunikimi ndërshtetëror, plot me armiqësi të hapura, rivalitet dhe luftë ndërmjet këtyre dy sistemeve plotësisht të kundërta.

Në këtë model të marrëdhënieve ndërkombëtare, konflikti kryesor zhvillohet ndërmjet dy aktorëve kryesorë, që përfaqësonin strukturat e polarizuara - ndërmjet Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik. *Përveç kësaj, pikërisht për shkak të pozitës së tyre dhe për pasojë të një lloj mbylljeje në vetvete të marrëdhënieve ndërkombëtare, të gjitha deformimet në marrëdhëniet e tyre të ndërsjella do të kalonin automatikisht edhe te shtetet e tjera të grumbulluara në dy aleancat antagoniste, të cilat u ishin nënshtruar plotësisht koncepteve të dy liderëve.*¹ Kjo gjendje solli deri në ashpërsimin e Luftës së Ftohtë dhe inicioi forcimin e prirjeve integruese që shoqëroheshin nga mekanizmat e grumbullimit bipolar në fushën ideologjike, politike, ushtarake dhe ekonomike, duke i bërë këto struktura gjithnjë e më të fuqishme dhe në vartësi gjithnjë e më të madhe nga liderët e aleancave.

Sipas Joshua S. Goldstein, shqetësimi kryesor i Perëndimit gjatë Luftës së Ftohtë ishte frika se Bashkimi Sovjetik mund të vinte nën kontroll Evropën Perëndimore, si nëpërmjet sulmit të drejtpërdrejtë ashtu edhe nëpërmjet marrjes së pushtetit nga komunistët në vendet e varfëruara e të lodhura nga lufta, të Evropës Perëndimore. *Plani Marshall* ose ndihma

¹ Radovan Vukadinović, *Marrëdhëniet ndërkombëtare nga Lufta e Ftohtë deri te rendi global*, Kolegji Universitar Victory, Prishtinë, 2007, fq. 154

financiare e ShBA-së për rindërtimin e ekonomive të vendeve evropiane, u përgjigjej këtyre frikave, ashtu siç bëri krijimi i aleancës së NATO-s.²

Në këtë periudhë të rivalitetit dhe të konflikteve ndërmjet dy fuqive secila prej tyre garonte për të mos mbetur mbrapa, kështu që çdo hap i njërës aleancë kundërpërgjigjej nga aleanca tjetër. Fuqia amerikane, e cila kryesisht ishte e para dhe printe me nismat e saja, do të provokonte menjëherë reagimin sovjetik që përpiqej të mos ngecte dhe ta mbante baraspeshën e forcave.

Krijimi i aleancës së NATO-s në vitin 1949 nga ana e ShBA-së dhe aleatëve të saj të Evropës Perëndimore ndikoi që Bashkimi Sovjetik dhe aleatët e saj, ndonëse me vonë në vitin 1955 të krijojnë Traktatin e Varshavës, dhe falë këtyre veprimeve procesi i armatimit në të dyja anët vazhdoi dhe po rritej me intensitetin gjithnjë e më të lartë.

*Gjermania ishte e ndarë, me tre të katërtat e vendit dhe tre të katërtat e kryeqytetit Berlin të pushtuara prej ShBA-së, Britanisë dhe Francës. Pjesa e saj e mbetur që rrethonte Berlinin Perëndimor, ishte e pushtuar prej Bashkimit Sovjetik.*³ Si rrjedhim, nën kontrollin e ShBA-së dhe aleatëve të saj më vitin 1949 u krijua Republika Federale e Gjermanisë, një veprim i cili u prit armiqësisht nga ana e Bashkimit Sovjetik dhe shkaktoi revoltën që do të çonte deri në formimin e shtetit tjetër gjerman, Republikën Demokratike të Gjermanisë.

Kulmi i Luftës së Ftohtë dhe ndarja rigoroze e sferave të influencës dhe interesit nga dy blloqet kundërshtarë ndodhi më 13 gusht të vitit 1961. Me iniciativën e Gjermanisë Lindore filloi ndërtimi i Murit të Berlinit që veçonte pjesën lindore prej asaj perëndimore të qytetit të Berlinit. Ai gjithashtu simbolizonte ndarjen e Evropës, me atë që Uinston Çërçilli në njërin prej fjalimeve të tij e kishte quajtur “Perdja e Hekurt.”

Gjermanolindorët kishin ngritur barrikada me tela me gjemba ndërmjet sektorit sovjetik të Berlinit dhe sektorëve të pushtuar nga tri fuqitë perëndimore dhe kishin rrethuar qytetin. Familjet në anën tjetër të murit, ishin ndarë. Me kalimin e ditëve, muri përforcohej, betoni, minat tokësore dhe qentë roje u bënë simbole të qytetit të ndarë dhe të mizorisë komuniste. Gjithë bota e mori vesh dështimin e regjimit komunist për t’i bindur shtetasit e tij të qëndronin

² Joshua S. Goldstein, *Marrëdhëniet Ndërkombëtare*, Bot. i katërt, Dituria, Tiranë, 2003, fq. 53

³ J. S. Goldstein, po aty, fq. 53

*në vendin e tyre.*⁴ Ajo që është me rëndësi të përmendet në këtë kontekst, është fakti që SHBA edhe pse u zu në befasi, këtë veprim nuk e gjykoj dhe nuk iu kundërpërgjigj ushtarakisht, duke e konsideruar atë si jo të rrezikshëm për interesat e tyre dhe duke ikur nga një luftë të mundshme bërthamore për mbrojtjen e Berlinit. Kjo situatë ishte në favor të të dyja palëve, pasi që asnjëra nuk ishte në gjendje të zëvendësojë diplomacinë me forcën, dhe secila tërhiqej përpara rrezikut të një lufte shkatërruese, gjithë këto rrethana rezultuan me krijimin e gjendjes së *status quo*-së në këtë fazë të Luftës së Ftohtë.

1.1 Faktorët që ndikuan në dobësimin e intensitetit të Luftës së Ftohtë

Ashtu si edhe shumë studiues tjerë të Marrëdhënieve Ndërkombëtare të periudhës në fjalë, edhe Radovan Vukadinović është i mendimit se kulmi i Luftës së Ftohtë njëkohësisht do të shënonte edhe fillimin e një fazë të re, e cila do të karakterizohej me dobësimin e intensitetit të konfliktit midis këtyre dy blloqeve kundërshtarë dhe që do të kërkonte ndërtimin e marrëdhënieve ndërkombëtare të reja dhe të ndryshme nga ato aktuale.

Elementet, apo faktorët që ndikuan në këtë proces të dobësimit të intensitetit të Luftës së Ftohtë ishin të shumtë, por ne do të përmendim dhe do të mundohemi t'i sqarojmë në pika të shkurtra ato të cilët i konsiderojmë si më të rëndësishëm.

- Të ashtuquajturat *konflikte lokale* apo *luftërat nëpërmjet të tretëve*, si p.sh. Lufta e Koresë, Lufta e Vietnamit, e Afganistanit ose mbështetja e revolucioneve apo qeverive në pushtet si në Etiopi, Somali dhe Kubë rezultuan me humbjen e dukshme si në resurse njerëzore ashtu edhe financiare apo ushtarake në të dyja blloqet, që ato vështirë mund t'i përballonin. Në këtë drejtim, do ta theksojmë Luftën e Vietnamit, që sipas shumë studiuesve paraqiste një gabim i politikës së jashtme amerikane të kësaj periudhe, kjo luftë e ndau opinionin te qytetarët amerikan dhe në fund, nuk mundi që ta parandalojë marrjen e pushtetit nga komunistët, dhe e gjithë kjo shfaqti dobësinë e ShBA-së. Nga ana tjetër, duke shfrytëzuar dobësinë amerikane, Bashkimi Sovjetik sulmoi Afganistanin. Megjithatë, ashtu si ShBA në Vietnam edhe Bashkimi Sovjetik nuk arriti t'i shtyp ushtritë kryengritëse të ndihmuara prej superfuqisë kundërshtarë. Sovjetikët më në fund u

⁴ Henry Kissinger, *Diplomacia*, Tiranë, 1999, fq. 583

tërhoqën, pas një lufte të lodhshme pothuaj dhjetëvjeçare që e dobësoi dukshëm Bashkimin Sovjetik.

- *Vendet neutrale apo vendet e papërfshira në blloqe* gjithashtu luajtën rolin e tyre në dobësimin por edhe në kapërcimin e Luftës së Ftohtë. Në këtë rast, do t'i përmendim shtetet e rajoneve të Azisë dhe të Afrikës, ndërmjet të cilëve krahas procesit të dekolonizimit dhe krijimit të shtetësisë së pavarur lindi një pikëpamje politike të mospërfshirjes në garën e blloqeve dhe ruajtjen e sovranitetit të sapofituar. Politika e Indisë, e cila që nga pavarësimi i saj në vitin 1947 vazhdoi me neutralitetin, pastaj angazhimi i politikës jugosllave për ruajtjen e pavarësisë së vet dhe politika e Egjiptit të Naserit, sinjalizuan shenjat e para të ndryshimeve, në të cilat forcat e strukturave të papërfshira me kontaktet e tyre të ndërsjella dhe me veprime të përbashkëta e të bashkërenduara, krijuan mundësitë për raporte të ndryshme ndërmjet shteteve dhe krijimin e një modeli të ri të marrëdhënieve ndërkombëtare.
- *Dobësimi i disiplinës dhe proceset e shpërbërjes brenda aleancave*, po ashtu patën ndikimin e tyre në dobësimin e intensitetit të Luftës së Ftohtë. Edhe pse ato u shfaqën në mënyra dhe kahje të ndryshme, megjithatë të secila prej tyre vihej re synimi i anëtarëve për një mëvetësi dhe pavarësi sa më të madhe. Komunikimi i kufizuar ndërshtetëror brenda kornizave të aleancave nuk i kënaqte të gjitha aspiratat e shteteve dhe ato vazhdimisht po kërkonin një model ndryshe nga ai bipolar, që do ju mundësonte lirinë për komunikim të ndërsjellë. Pra, e gjithë kjo dëshmoi se pengesat e vëna në periudhën e Luftës së Ftohtë ishin artificiale dhe nën trysinë e kohës dhe rrethanave të imponuara nga protagonistët kryesorë të të dy blloqeve kundërshtarë.
- *Gara për armatim dhe zhvillimi ushtarako – teknologjik* në mënyrë të pashmangshme hapën shtigje dhe pikëpamje të reja në zhvillimin e mëtutjeshëm të marrëdhënieve ndërkombëtare. Këto marrëdhënie të ashpërsuara ndërmjet dy grupimeve antagoniste politiko – ushtarake shkaktuan një garë kolosale ushtarake të paparë ndonjëherë në historinë e botës. Në bazë të armiqësive të hapura u krijuan doktrinat dhe konceptet që i hapën rrugë grumbullimit të pareshtur të armëve, por edhe zhvillimit të mjeteve gjithnjë

*e më të sofistikuara të asgjësimit në masë.*⁵ Secili inovacion do të nxiste pa vonuar reagimin e palës tjetër duke tentuar të mbajë ekuilibrin e forcave dhe kështu asnjëra palë nuk dëshironte apo nuk kishte guximin ta ndalonte garën. Megjithatë, prapa kësaj barazie ushtarake – teknologjike qëndronte një prapambetje shumë e madhe e Bashkimit Sovjetik në të gjitha fushat tjera, në ekonominë e vendit, në kushtet që u ofronte punëtorëve, në standardin jetësor të qytetarëve si dhe në infrastrukturë.

Përveç këtyre faktorëve, të cilët ndikuan dukshëm në dobësimin e intensitetit të Luftës së Ftohtë, duhet theksuar se edhe vdekja e Stalinit në vitin 1953, ndonëse në fazat e hershme të kësaj periudhe, lehtësoi dhe bëri të mundshëm procesin e zhvillimit të mëtutjeshëm të një modeli të ri të marrëdhënieve ndërkombëtare ndërmjet fuqive të mëdha. E gjithë kjo, ndodhi si rezultat i politikës së Stalinit që kishte sjellë Bashkimin Sovjetik në një gjendje tepër defensive të izolimit dhe të shkëputjes nga pjesa tjetër e botës. Pas vdekjes së Stalinit, udhëheqësit pasardhës sovjetik i priste një punë e guximshme në drejtim të zgjidhjes së çështjeve kyçe të pozitës së Bashkimit Sovjetik në politikën e jashtme si dhe në atë të brendshme.

2. Rënia e Murit të Berlinit

Dobësimi i intensitetit të Luftës së Ftohtë, detyrimisht paralajmëroi edhe fundin e kësaj lufte që zgjati pothuajse katër dekada dhe përfshiu jo vetëm dy protagonistët kryesorë, ShBA-të dhe Bashkimin Sovjetik, por edhe shtetet tjera të grumbulluara rreth këtyre dy blloqeve antagoniste politiko-ushtarake. Rënia e Murit të Berlinit, më 9 nëntor të vitit 1989 shënoi fundin e Luftës së Ftohtë dhe konsiderohet si një nga ngjarjet më të rëndësishme të shekullit XX. Kjo datë historike shënoi edhe fillimin e fundit të Bashkimit Sovjetik dhe të Bllokut Socialist në përgjithësi, po ashtu u bë simboli i përfundimit të sistemit bipolar që njëkohësisht hapi shtigjet për ndërtimin e marrëdhënieve të reja ndërkombëtare. Ky paraqet viti i shumë ndryshimeve politike dhe gjeostrategjike në aspektin global. Këto ndryshime do të reflektohen jo vetëm te shtetet e përfshira drejtpërdrejt në blloqe, por edhe te shtetet e ashtuquajtura satelite apo të treta, si dhe në një pjesë të vendeve neutrale të cilët vazhdimisht ishin nën presionin apo

⁵ R. Vukadinović, po aty, fq. 157

ndikimin e proceseve tejte të ndërlikuara dhe përplot me armiqësi që e karakterizuan periudhën e Luftës së Ftohtë.

Bashkimi i Gjermanisë Lindore dhe Perëndimore në një shtet të vetëm ndodhi si rrjedhojë e natyrshme të valës së ngjarjeve dhe ndryshimeve që kapluan kontinentin Evropian në veçanti, dhe që patën ndikim e tyre edhe në shumë vende të tjera të botës. Qeveria e Republikës Demokratike të Gjermanisë bëri përpjekjet e fundit që me frymën e ideve të reja të reformoj vendin, por së shpejti do të përballej me pakënaqësitë dhe demonstratat e masës, të cilët nuk pranonin më kurrfarë reformash të sistemit socialist. Shumica e madhe e popullatës synonin bashkimin me Republikën Federale të Gjermanisë, ku edhe e shihnin të ardhmen e tyre më të sigurt.

Në Otavë, në mbledhjen e ministrave të Punëve të Jashtme të Britanisë së Madhe, Francës, SHBA-së dhe BRSS-së, u vendos që për çështjen gjermane të pranohej formula 2+4,⁶ e cila ndryshe njihet edhe si “Formula e Otavës”. Në esencë kjo marrëveshje parashihte që për kushtet politike, ekonomike dhe juridike të bashkimit fillimisht të merreshin vesh përfaqësuesit e qeverive të dy shteteve gjermane. Më pastaj katër shtetet e mëdha të diskutonin lidhur më aspektin ushtarak të bashkimit gjerman, duke përfshirë këtu edhe sigurinë e shteteve fqinje dhe në një pikëpamje më të gjërë, edhe për sigurinë e sistemit të ri evropian.

Kancelari Helmut Kol, për të vazhduar bisedimet rreth bashkimit gjerman, kërkoi që këtë ta bëjë më atë qeveri të RD të Gjermanisë që do të zgjidhej nga populli në zgjedhje të lira dhe demokratike. *Në mars të vitit 1990 në RD të Gjermanisë u zhvilluan zgjedhjet e para të lira, të cilat i fitoi Aleanca për Gjermaninë, garant i listës së të cilës ishte kancelari Kol.⁷* Pas zgjedhjeve, procesi i bisedimeve për bashkimin e dy shteteve u intensifikua, Teksti i Traktatit u pranua nga të dyja palët dhe më 3 tetor 1990 u bë bashkimi i Gjermanisë.

Duke i pasur në konsideratë faktorët që ndikuan në dobësimin e intensitetit të Luftës së Ftohtë, që u përmendën më herët, dhe duke dashur t’i japim vazhdimësi rrjedhës së ngjarjeve që karakterizuan këtë periudhë do të përpiqemi t’i shtjellojmë edhe disa prej shkaqeve që çuan drejt përfundimit të kësaj lufte.

⁶ Po aty, fq. 254

⁷ Po aty, fq. 255

Është me rëndësi të theksohet fakti se ndërmjet studiuesve nuk ka një mendim të unifikuar lidhur me çështjen e shkaqeve të përfundimit të Luftës së Ftohtë. Sipas njërës pikëpamje, ishte fuqia ekonomike dhe ushtarake e ShBA-së në kohën e presidentit Regan ajo që e detyroi Bashkimin Sovjetik dukshëm të dobësohej dhe të falimentoj, meqenëse kjo e fundit mundi të ruante barazinë në garën e armatimeve. Një pikëpamje tjetër thotë se Bashkimi Sovjetik për një periudhë të gjatë kohore po përballlej me vështirësi dhe krizë ekonomike brenda territorit të vet. Në fund shpërtheu për shkak të dobësive të sistemit të qeverisjes dhe pamundësisë së udhëheqësve politik për tu përballuar me to, dhe kjo kishte të bëjë shumë pak me ndikimet apo trysnitë nga jashtë. Disa prej studiuesve mendojnë se Bashkimi Sovjetik mund të kishte dështuar edhe më herët, pa ndihmën e ShBA-së si armik dhe faktor i jashtëm që mbështeste legjitimitetin dhe autoritetin e qeverisë sovjetike ndaj popullit të vet. *Shpjegimi tjetër është i lidhur me fuqitë e perandorive, sipas këtij shpjegimi fuqitë ekspansioniste zgjerohen vazhdimisht derisa ky zgjerim e shkatërron fuqinë e brendshme.*⁸ Kur jemi te faktorët e brendshëm dhe ndikimin që patën ato, medoemos duhet të pajtohemi me mendimin se, faktori më i rëndësishëm përshpejtues i përfundimit të Luftës së Ftohtë ishte ardhja e Mikail Gorbaçovit në krye të Bashkimit Sovjetik.

Ndryshimet që solli përfundimi i Luftës së Ftohtë u reflektuan jo vetëm në raportet ndërmjet këtyre dy blloqeve kundërshtarë, por edhe në të gjitha aspektet tjera të marrëdhënieve ndërkombëtare. Bashkimi i Gjermanisë, anëtarësimi i saj në NATO, dhe shpërbërja e Bashkimit Sovjetik në vitin 1991, ndikuan edhe në rrjedhën e shumë konflikteve kudo në botë, përfshirë këtu luftën në Afrikën e Jugut dhe në Lindjen e Mesme. Politikat që ndoqën palët e përfshira në këto konflikte ishin të bazuara në ekzistencën e Luftës së Ftohtë dhe të modelit bipolar të marrëdhënieve ndërkombëtare, dhe fundi i saj solli ndryshime të politikave ekzistuese globale.

3. Shembja e Bllokut Socialist dhe ndryshimet politike në Evropën Qendrore dhe Juglindore

⁸ Bejtush Gashi, Pjetër Hidri, *Konfliktet Ndërkombëtare dhe Ndëretnike*, Prishtinë, 2008, fq. 209

Fundi i shekullit të 20-të ishte një kohë e trazirave dhe ndryshimeve të mëdha gjeopolitike në Evropën Qendrore dhe Juglindore. Rënia e Murit të Berlinit në nëntor të vitit 1989 i dha fund Luftës së Ftohtë dhe ndarjeve që datuan që në përfundimin e Luftës së Dytë Botërore. Rënia e bllokut komunist solli fundin e një sistemi bipolar të marrëdhënieve ndërkombëtare, i cili u ndërtua rreth rivalitetit midis Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Sovjetik. *Strukturat ekonomike dhe ushtarake si Këshilli për Ndihmën e Ndërsjellë Ekonomike dhe Pakti i Varshavës u shpërndanë në vitin 1991.*⁹ Ndërkaq, ndryshimet që ndodhën në fund të viteve '80 shënuan fillimin e marrëdhënieve të reja midis dy pjesëve të kontinentit që ishin ndarë për një periudhë të gjatë kohore. Reformat politike dhe ekonomike u zhvilluan në të gjithë Evropën, ndërsa transformimi rrënjësor i shoqërive, krijoi kushte të favorshme për krijimin e ekonomisë së tregut dhe krijimin e demokracive pluraliste parlamentare të bazuara në sundimin e ligjit.

Faza e parë e ndryshimeve, gati se në secilin prej këtyre vendeve lidhej me eliminimin e institucioneve dhe themeleve juridike mbi të cilat ishte ngritur pushteti totalitar - roli udhëheqës i partisë komuniste. Kjo filloi në vjeshtë të vitit 1989, kur në Poloni dhe Hungari ndodhi riorganizimi dhe riemërtimi i partive komuniste, duke hapur rrugën kështu për ndryshime edhe në shtetet tjera si Çekosllovakia, Republika Demokratike e Gjermanisë, Rumania dhe Bullgaria. Pas kësaj, pasoi faza e dytë, në të cilën te këto shtete u shpallën dhe u zhvilluan zgjedhjet e lira dhe demokratike, duke dashur që me këtë të arrijnë ndryshimet, bashkimin me pjesën tjetër të Evropës, si dhe ndërprerjen e marrëdhënieve që ekzistonin me Bashkimin Sovjetik në fushën politike, ekonomike dhe ushtarake.

Këto ngjarje politike në Evropën Qendrore dhe Juglindore në fund të viteve 1980 jo vetëm që ndryshuan rrënjësisht situatën gjeopolitike në Evropë, por ato edhe transformuan institucionet dhe strukturat ekzistuese. *Aspiratat për lirinë, demokracinë dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të cilat kishin qenë prej kohësh të shtypura nga regjimet autoritare të bllokut sovjetik, u shprehën gjithnjë e më shumë haptazi, në sajë të reformave të prezantuara në Bashkimin Sovjetik nga Mikhail Gorbaçov dhe politika e tij të hapjes graduale drejt Perëndimit.*¹⁰ Qeveritë e

⁹ Burim: <https://www.cvce.eu/en/recherche/unit-content/-/unit/02bb76df-d066-4c08-a58a-d4686a3e68ff/812f82eb-0e36-4146-b935-b768901971e6>

¹⁰ Po aty: <https://www.cvce.eu/en/recherche/unit-content/-/unit/02bb76df-d066-4c08-a58a-d4686a3e68ff/6ebcdbc-29c7-47e6-81df-70039b5977fd>

shteteve komuniste, tashmë të dobëta, u rrënuan shpejt, duke inkurajuar rizgjimën e identiteteve kombëtare dhe të pakicave në shtetet satelite të Bashkimit Sovjetik dhe më pas në vetë Bashkimin Sovjetik, ndërsa demonstratat dhe grevat në mbështetje të reformave politike dhe ekonomike u bënë gjithnjë e më të shpeshta. Brenda një periudhe tre vjeçare, regjimet komuniste u shembën dhe kombet individualisht fituan lirinë e tyre, fillimisht në vendet satelite dhe më pastaj në vetë Bashkimin Sovjetik duke rezultuar me ndarjen dhe krijimin e republikave të pavarura.

Ashtu siç përmendëm edhe më herët, Rënia e Murit të Berlinit dhe ribashkimi i Gjermanisë përshpejtuan edhe më tej rrëzimin e regjimeve komuniste dhe vendosjen e sistemeve demokratike. Në Çekosllovakë, udhëheqësi i opozitës, Vaclav Havel, u zgjodh President i përkohshëm i Republikës nga parlamenti i Republikës Socialiste në dhjetor të vitit 1989. Në të njëjtën mënyrë, lëvizja e Forumit Qytetar fitoi zgjedhjet e para parlamentare të lira në qershor 1990 dhe riemëroi Vaclav Havelin si President i Republikës në korrik të atij viti. Në Hungari, zgjedhjet parlamentare të mbajtura të vitit 1990 rezultuan me formimin e qeverisë së Forumit Demokratik. Më 9 dhjetor 1990, Lech Wałęsa u bë President i Republikës së Polonisë. Në Bullgari, një qeveri e koalicionit u formua më 7 dhjetor 1990 dhe kushtetuta e re u miratua në korrik të vitit 1991. *Në Rumani, pas demonstratave të dhunshme, diktatori komunist Nikolai Çausheku u ekzekutua në 25 dhjetor 1989, dhe një kushtetutë e re që vendosi pluralizmin u miratua në 8 dhjetor 1991.*¹¹

Dy federatat tjera shumënacionale që do të shpërbëheshin në Evropë, ishin Çekosllovakia dhe Jugosllavia. Paralelisht me fitimin e pavarësisë, në Çekosllovakë filluan konfliktet e para të brendshme midis atyre që ishin për zhvillimin e mëtejshëm të Federatës Çekoslloake dhe përkrahësve të pavarësisë së Sllovakisë. Në këto rrethana, u mbajtën zgjedhjet parlamentare të vitit 1992, të cilët vetëm se e përkeqësuan situatën. Këshilli Popullor Sllovak po atë vit miratoi deklaratën e njëanshme për pavarësinë e Sllovakisë, dhe udhëheqësi i grupit përfaqësues sllovak në parlamentin federal, Vladimir Meciar shprehu hapur dëshirën për shkëputje. Pas debateve të shumta parlamentare dhe përpjekjeve për të bllokuar krijimin e buxhetit të përbashkët, ndarja e vendit ishte më se e qartë. *Kryetari i Federatës Çekoslloake, Vaclav Havel*

¹¹ Po aty, <https://www.cvce.eu/en/recherche/unit-content/-/unit/02bb76df-d066-4c08-a58a-d4686a3e68ff/1e80c881-0680-4dcd-9f80-8afe1f181ad5>

*dha dorëheqjen, ndërkohë që Qeveria çeke, me Vaslav Klausin në krye, do të ndërmernte hapat e ndarjes. Parlamenti federal miratoi më 25 tetor 1992 ligjin për shpërbërjen e shtetit çekoslovak në datën 31 dhjetor 1992.*¹²

Për dallim nga shkëputja paqësore e shumicës së këtyre shteteve që u përmendën më lartë, procesi i shpërbërjes së federatës Jugosllave u zhvillua në mënyrë të dhunshme, duke u përcjellë me konflikte të ashpra dhe luftëra civile në disa prej këtyre shteteve. Ardhja e Millosheviçit në pushtet në Serbi në vitin 1989, dhe zhvillimi i politikës së tij hegjemoniste dhe nacionaliste, ndikimi nga ndryshimet gjeopolitike në Evropën Qendrore dhe Lindore, dhe fuqizimi i ideve nacionaliste brenda shteteve, ndikuan në përshpejtimin e shkatërrimit të Jugosllavisë. Procesi u intensifikua, sidomos pas dështimit të Kongresit të XIV të Lidhjes Komuniste Jugosllave në janar të vitit 1990, që inicioi dhe inkurajoi formimin e partive tjera kombëtare, dhe demokratizimin e shoqërive fillimisht në Slloveni, Kroaci dhe Maqedoni, e më pastaj edhe te shtetet tjera të federatës jugosllave.

4. Shpërbërja e Bashkimit Sovjetik

Në fillim të viteve '80 Bashkimi Sovjetik po ballafaqohej me një krizë ekonomiko – politike të brendshme shumë komplekse, gjendje e cila u reflektua edhe në aspektin ndërkombëtar dhe destabilizoi statusin e Bashkimit Sovjetik në raport me shtetet tjera të Bllokut Socialist. Dobësimi i ideologjisë komuniste, dështimi i ekonomisë socialiste dhe lëvizjet e shpejta dhe të paparashikuara të udhëheqësve politik sovjetik krijuan vështirësi të konsiderueshme edhe për ndërkombëtarët, sidomos për ShBA-të, të cilët për një periudhë të caktuar humbën orientimin se në çfarë drejtimi po zhvillohej politika e jashtme sovjetike dhe cila ishte pozita e tyre kundrejt marrëdhënieve me to.

Pas një periudhe të destabilitetit politik dhe vështirësive të brendshme, në mars të vitit 1985 Mikail Gorbaçovi u emërua Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Komuniste, i cili që në fillim të udhëheqjes, tregoi që dallon nga paraardhësit e tij. *Deri më 1991, Gorbaçovi konsiderohej në*

¹² R. Vukadinoviç, po aty, fq. 270-271

*Uashington, si një partner i domosdoshëm në ndërtimin e rendit të ri botëror.*¹³ Ai, duke qenë i vetëdijshëm për rrethanat dhe situatën në të cilën gjendej Bashkimi Sovjetik, mori një varg masash drejt reformimit të vendit dhe hapjes drejt botës perëndimore dhe trendeve bashkëkohore globale.

Gorbaçovi parashtroi doktrinën për ristrukturimin ekonomik dhe politik të vendit, duke i implementuar reformat e njohura si “perestrojka” dhe “glasnost”, poashtu me politikën e jashtme të cilën e quajti “mendimi i ri” ai theksoi dy elemente të rëndësishme. Së pari, Gorbaçovi ishte i mendimit se të gjithë mund të përfitonin nga bashkëpunimi i ndërsjellë, duke synuar që ta bindë Perëndimin se Bashkimi Sovjetik nuk do të paraqiste më asnjë lloj rreziku për marrëdhëniet ndërkombëtare. Së dyti ai shpalli doktrinën e “mjaftueshmërisë” duke hequr dorë nga gara e armatimit bërthamor dhe duke mbajtur një numër minimal armësh për mbrojtje. *Politikat e Gorbaçovit, mjerisht asnjëherë nuk u realizuan në praktikë ashtu siç i pati konceptuar e përfytyruar ai. Gorbaçovi ishte shumë më i avancuar se realiteti, ishte shumë përpara vizionit të popujve sovjetik, kishte shkuar shumë larg krahasuar me bashkëpunëtorët e tij partiak dhe shtetëror.*¹⁴

Në këtë drejtim, pajtohem me mendimin se procesi i implementimit të reformave të brendshme institucionale i konsumoi shumë kohë Gorbaçovit. Kjo kohë solli në zvarritjen e reformave, thellimin e krizës ekonomike e sociale dhe humbje të besimit tek idetë e tij brenda Bashkimit Sovjetik. Nga e gjithë kjo situatë, më vonë do të përfitonin shumë kundërshtar të Gorbaçovit. Por, duhet theksuar edhe faktin se nuk ishte vetëm procesi i stërzgatur i reformimit të institucioneve dhe pengesat brenda qarqeve konservatore të Partisë Komuniste që ndikuan në mosrealizimin praktik të perestrojkës dhe gllasnostit. Ai në esencë mbetej komunist dhe si i tillë dëshironte të reformonte komunizmin e jo ta zëvendësonte atë. *Gorbaçovi në fillim mendonte së një parti komuniste, e reformuar mund ta drejtonte shoqërinë sovjetike në botën moderne,*¹⁵ por ai nuk e kuptoi se në parim problemi ishte vetë ideologjia komuniste e jo reformimi i saj.

¹³ H. Kissinger, po aty, fq. 786

¹⁴ Lisen Bashkurti, *Diplomacia Shqiptare – Diplomacia e Vetëizolimit*, Vëllimi i tretë, Tiranë, 2004, fq. 516

¹⁵ B. Gashi, P. Hidri, po aty, fq. 211

Gjithashtu, Gorbaçovi paraqiti disa kontradikta të brendshme në idetë, vizionet dhe zbatimet praktike. Pra, pati disa dobësi serioze në aspekt të asaj se ai kurrë nuk e bëri të qartë vizionin si dhe qëllimin e tij afatgjatë, në mënyrë që populli i vet, udhëheqësit politik por edhe vendet tjera të Bashkimit Sovjetik ta kuptonin atë dhe ta mbështesnin atë në këto politika reformuese. Ai poashtu dëshironte të zhvillojë vendin ekonomikisht duke vazhduar të praktikojë sistemin ekonomik socialist, që rezultoi të jetë një nga paradokset më të mëdha, megjithëse disa prej elementeve të ekonomisë së tregut i pranoi dhe i zbatoi në praktikë ato nuk mjaftuan të japin rezultatet e pritshme. Me rëndësi është të themi se me këto veprime politike, Gorbaçovi hapi mundësitë për shumë individë të partisë socialiste në vend por edhe në republikat e Bashkimit Sovjetik të shfaqen me ide, alternativa madje edhe me pretendime politike superiore për ardhmërinë e Bashkimit Sovjetik si dhe për vetë Gorbaçovin.

Duke u ndërlidhur me atë që u tha më lartë, mund të themi se shpërbërja e Bashkimit Sovjetik paraqiste një proces i pashmangshëm, i cili më konkretisht filloi në mars të vitit 1990 me kërkesën e republikave sovjetike për pavarësi dhe mëvetësi jashtë BRSS-së. Kjo valë e ndryshimeve socio-politike do t'i përfshijë të gjitha vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore që ishin pjesë e Bllokut Socialist, duke u përhapur më pastaj edhe te republikat brenda Bashkimit Sovjetik. Lidhjet historike, numri i madh i popullsisë ruse, lidhjet kulturore dhe ato ekonomike ishin vetëm disa prej arsyeve që në disa shtete rruga drejt pavarësisë të zhvillohej më ngadalë dhe ajo të arrihej në mënyra të ndryshme.

Lituanian ishte republika e parë që shpalli pavarësinë e saj më 11 mars 1991. Estonia dhe Letonia pasuan, përkatësisht në gusht të po atij viti, gjatë përpjekjes së grushtit të shtetit në Moskë. Në Kaukaz, Gjeorgjia ishte e para që shpalli pavarësinë në prill 1991, pasuar nga Azerbajxhani në gusht dhe Armenia në shtator të vitit 1991. Njëra pas tjetrës, njësitë federale të Bashkimit Sovjetik shpallën pavarësinë: Ukraina, Bjellorusia, Moldavia, Uzbekistani dhe Kirgistani, të gjitha në gusht të vitit 1991, Taxhikistan dhe Turkmenistan në shtator, dhe më në fund Kazakistan më

16 dhjetor. *Shkëputja e Ukrainës më 1 dhjetor 1991 dhe refuzimi i saj për të nënshkruar Traktatin e Bashkimit sinjalizoi shembjen përfundimtare të Bashkimit Sovjetik.*¹⁶

Zhvillimet në planin e brendshëm vetëm e përshpejtuan procesin e shkëputjes së republikave nga BRSS-ja dhe shembjen e shtetit të madh. *Në konfrontim të vazhdueshëm të Gorbaçovit dhe Jelcinit, forcat që përkrahnin këtë të fundit do të zgjidhnin në qershor të vitit 1991 Boris Jelcinin kryetar të Rusisë, gjë që shënoi fillimin e procesit të marrjes së kompetencave të organeve shtetërore sovjetike.*¹⁷ Në ndërkohë, rrymat konservatore socialiste si dhe përfaqësuesit e lartë të ushtrisë, policisë dhe KGB-së synonin ta ndalonin këtë proces duke u frikësuar se do t'i vinte fundi BRSS-së dhe me atë edhe privilegjeve të tyre të shumta. Kështu që, më 19 gusht 1991 u tentua një grusht i shtetit, i cili do të shtypej pas disa ditësh me ndihmën e shumicës së forcave policore dhe ushtarake, të cilat u radhitën në anën e kryetarit rus Boris Jelcin.

Në aspektin e brendshëm, dhe atë ndërkombëtar shembja e BRSS-së ishte më se e qartë, dhe hapi i radhës në këtë drejtim ishte takimi i përfaqësuesve të Rusisë, Bjellorusisë dhe Ukrainës në Minsk më 8 dhjetor të vitit 1991. Në këtë takim u proklamua Bashkësia (Komonuelthi) e Shteteve të Pavarura fillimisht ndërmjet këtyre 3 shteteve, të cilës më 21 dhjetor të po atij viti do ti bashkëngjiteshin edhe 8 republika tjera, me përjashtim të tri shteteve baltike dhe të Gjeorgjisë, e cila në këtë strukturë do të hynte më vonë, në vitin 1993.

*Krijimi i Bashkimit të Shteteve të Pavarura përbënte një sukses tjetër i Boris Jelcinit, i cili me inaugurimin e kësaj strukture të re shtetërore do të eliminonte praktikisht ekzistimin formal të Bashkimit Sovjetik me kryetarin e tij, Mihail Gorbaçov. Menjëherë pas takimit të Minskit, më 25 dhjetor 1991 Gorbaçovi do të dorëzonte funksionin e vet të kryetarit të BRSS-së dhe me këtë akt do të shpërbëhej edhe formalisht Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike.*¹⁸

Për sa kohë që regjimi komunist sovjetik ishte në gjendje të kontrollonte gjendjen politike dhe kërkesat ekonomike dhe sociale të popujve të Republikave Socialiste, askush nuk vinte në dyshim nevojën e ekzistencës së BRSS-së. Politika e udhëheqjes së Partisë Komuniste, gjithmonë tentoi të ruajë një tërësi kohezive, përderisa çdo Republikë u përpoq të merrte

¹⁶ Burim: <https://www.cvce.eu/en/recherche/unit-content/-/unit/02bb76df-d066-4c08-a58a-d4686a3e68ff/a36c2b08-97a1-4308-b764-6ad5988d939b>

¹⁷ R. Vukadinoviç, po aty, fq. 269

¹⁸ R. Vukadinoviç, po aty, fq. 270

avantazhet më të mëdha. Për të mbajtur pushtetin e saj, udhëheqja e Partisë përdori çdo metodë që kishte në dispozicion dhe vepronte për të shtypur nacionalizmin e tepruar në rastet kur ai shfaqej. Në të njëjtën kohë ajo kujdesej që Republikat të shfrytëzonin burimet e ndryshme duke u dhënë liri dhe të drejtë për një shkallë të caktuar të autonomisë politike dhe ekonomike, përderisa kufijtë e vendosur nuk ishin tejkaluar dhe pushteti qendror nuk rrezikohej. Me dobësimin e fuqisë së pushtetit qendror dhe me decentralizimin e tij, i cili ishte i përkrahur nga faktori i brendshëm dhe ai ndërkombëtar filloi procesi i pakthyeshem i shpërbërjes së BRSS-së, i cili pritej dhe ishte plotësisht i ligjshëm, duke pasur parasysh të drejtën e Republikave Socialiste për shkëputje dhe shpallje të pavarësisë së tyre.

5. ShBA dhe Rendi i Ri Botëror

Kur flasim për termin Rendi i Ri Botëror shpesh i referohemi ndryshimit të strukturës së sistemit ndërkombëtar dhe ekuilibrit të forcave. Në rastin konkret, fundi i Luftës së Ftohtë, hapi rrugën për kalimin nga sistemi ndërkombëtar bipolar në atë njëpol apo *unipolar* ku ShBA mbeti fuqia e vetme hegjemone botërore. Pikërisht, ishte kjo periudha kur ideja për krijimin e Rendit të Ri Botëror u diskutua në përmasa globale, presidenti amerikan George H. W. Bush ishte ai i cili aktualizoi këtë koncept dhe angazhimi i tij politik u përqendrua në zbatimin e po të njëjtit. *Në të kaluarën, shumë sisteme të reja ndërkombëtare u krijuan si rezultat i luftërave të mëdha – duke filluar nga Traktati i Vestfalisë pas Luftës Tridhjetëvjeçare, pastaj Kongresi i Vjenës pas luftërave Napoleonike, duke vazhduar me Traktatin e Versajës pas Luftës së Parë Botërore, dhe në Jaltë dhe Potsdam pas Luftës së Dytë Botërore. Duke e mbajtur hapin me këtë histori, duhet të ishte krijuar një rend i ri botëror pas Luftës së Ftohtë.*¹⁹

Ndryshimet e mëdha gjeopolitike dhe ngjarjet e rëndësishme të cilat ndodhën në Evropën Qendrore dhe Juglindore gjatë viteve 80-të dhe 90-të patën ndikimin e tyre në aspektin global, duke vënë në dukje dobësitë e sistemit politiko-ekonomik të socializmit, dhe duke i lënë kështu hapësirë botës perëndimore të udhëhequr nga ShBA-të që të mbizotëroj plotësisht, në të

¹⁹ Burim: <https://www.nytimes.com/2004/01/03/opinion/after-the-cold-war-we-need-to-build-a-new-world-order.html>

njëjtën kohë duke mënjeluar edhe çdo formë të marrëdhënieve ndërkombëtare të ekuilibruara.

Pra, zëvendësimi i sistemit ndërkombëtar bipolar me atë unipolar shënoi fillimin e një faze të re të marrëdhënieve midis shteteve, ku ShBA-të do ta merrnin rolin e liderit duke shpallur synimin për ndërtimin e një Rendi të Ri Botëror. Ky koncept, historikisht ishte përmendur edhe më herët nga ana e presidentëve amerikan Vudrou Uillson dhe Franklin Delano Ruzvelt, kështu që presidenti Bush ishte ai i cili për herë të tretë e shpalli këtë koncept, kuptohet kësaj radhe në rrethana tërësisht ndryshe dhe me mundësi apo kapacitete konkrete ushtarako-ekonomike për implementimin e të njëjtit në praktikë.

Sipas Bushit, ky sistem i ri i marrëdhënieve ndërkombëtare do të ngrihej mbi disa elemente thelbësore: në radhë të parë do të ndërtoheshin marrëdhënie të tilla të reja ndërkombëtare, që do të forconin sigurinë kolektive, do të forcohej autoriteti i organizatave ndërkombëtare dhe do të ndihmohej krijimi i komunitetit botëror të popujve të lirë. Pikërisht në këtë bashkësi të popujve demokratikë dhe të lirë Amerika do të duhej ta kishte rolin udhëheqës.²⁰

Me mbarimin e Luftës së Ftohtë, përkaj problemeve dhe mosmarrëveshjeve që kishin, fuqitë e mëdha të botës përparuan në aspekt të rritjes së bashkëpunimit midis tyre. Rusia u pranua si shtet pasardhës i Bashkimit Sovjetik dhe e zëvendësoi atë në Këshillin e Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), poashtu ShBA-të dhe Rusia u pajtuan për të bërë reduktim të konsiderueshëm të sasive të armëve të tyre bërthamore dhe e realizuan atë gjatë viteve në vijim.

Sfida e parë me të cilën do të ballafaqohej Rendi i ri Botëror me ShBA-të si udhëheqës, ishte kriza e Gjirit Persik e verës së vitit 1990, në të cilën Iraku shfaqti pretendime tendencioze territoriale ndaj Kuvajtit. Duke ushtruar trysni të vazhdueshme mbi këtë shtet të vogël por shumë të pasur me naftë, Iraku ndërmori sulmin ndaj Kuvajtit më 2 gusht të vitit 1990 dhe e pushtoi atë brenda një dite, duke shpallur pas një jave aneksimin në Bagdad.

Ky aksion ushtarak, shkaktoi revoltën e shumë shteteve perëndimore e sidomos të ShBA-ve, të cilët i kushtonin një rëndësi shumë të veçantë rajonit të Gjirit Persik, duke e pasur parasysh

²⁰ R. Vukadinoviç, po aty, fq. 283

faktin se aty ndodhen vendburimet më të mëdha të naftës dhe gjithmonë duke dashur të mbajnë baraspeshën ndërmjet Iranit dhe Irakut për të ruajtur stabilitetin e të gjithë rajonit.

E gjithë kjo situatë, bëri që presidenti Bush të kërkonte përgjigje urgjente dhe në këtë drejtim administrata e tij dërguan thirrje të shumta, ndërsa OKB-ja ndërmori një sërë masash kundrejt Bagdadit për tu tërhequr nga Kuvajti. Ndërkaq, regjimi i Sadamit do ta injoronte të gjithë këtë duke u kërcënuar me sulmin edhe ndaj Arabisë Saudite, nëse do të vazhdonin këto masa kundër Irakut. Si rezultat i kësaj, Këshilli i Sigurimit në nëntor miratoi rezolutën 678, me të cilën parashihej përdorimi i forcës ushtarake në rast se Iraku nuk tërhiqej nga Kuvajti deri më 15 janar të vitit 1991.

Në këto rrethana, e ndihmuar dhe e mbështetur nga plotë 28 shtete, duke përfshirë këtu edhe mbështetjen ushtarake të fuqive të mëdha të Evropës perëndimore si Britania e Madhe dhe Franca dhe ndihmën me materiale dhe teknikë ushtarake nga ana e Gjermanisë, ShBA-ja ndërmori kundër Irakut aksionin ushtarak të ashtuquajtur “Shtrëngata e Shkretëtirës” i cili filloi më 16 janar të vitit 1991.²¹ Aksioni, në përgjithësi targetoi bazat ushtarake dhe luftimet u zhvilluan deri në fund të shkurtit, ku forca ushtarake ajrore irakiane u shkatërrua dhe më 25 shkurt Kuvajti u çlirua zyrtarisht nga Iraku.

Udhëheqësit e ShBA-së shpresonin se Lufta e Gjirit do të jepte një precedent me vlerë për të ardhmen, dënimin e agresorit, ripohimin e sovranitetit e të tërësisë tokësore – territoriale (si të Kuvajtit edhe të Irakut), dobinë e Këshillit të Sigurimit dhe gatishmërinë e ShBA-së për të udhëhequr rendin e periudhës së Pasluftës së Ftohtë, të cilin Presidenti Bush e quajti “Rendi i Ri Botëror”.²²

Si rikonfirmim i asaj që u tha më lartë, Presidenti Bush në kulmin e famës dhe suksesit, pas përfundimit të luftës, në mars të vitit 1992 deklaroi para Kongresit Amerikan se Lufta e Gjirit kishte treguar qartë se ishte krijuar një rend i ri botëror dhe se ky tregonte shembullin më të mirë se si mund të veprojë OKB-ja kundër agresionit. Nga ana tjetër, shpresat për një Rend të ri Botëror ku do të mbizotëronte paqja globale pas Luftës së Gjirit, u ndeshën shumë shpejtë me realitetin më pak të këndshëm. Kjo u shfaq më qartë se kudo, në Bosnjë dhe Hercegovinë, ku

²¹ R. Vukadinoviç, po aty, fq. 284-285

²² J. S. Goldstein, po aty, fq. 58

OKB-ja u detyrua të dërgojë misionin e saj më të madh paqeruajtës dhe ku politika e paqartë dhe mospërputhja ndërmjet fjalëve dhe veprave të Bashkësisë Ndërkombëtare ishte shumë e habitshme.

5.1 Rendi i Ri Botëror dhe Globalizimi

Duke dashur të sqarojmë natyrën komplekse të Rendit të Ri Botëror dhe Globalizimit, si dhe mënyrën e ndërlidhjes apo ndërveprimit të këtyre dy koncepteve që e karakterizojnë periudhën bashkëkohore në të cilën ne jetojmë, do t'i referohemi mendimit të Profesor Jonuz Abdullait i cili përkufizon Globalizmin si *“një proces, një gjendje, një sistem, një forcë dhe një epokë”* duke thënë në vazhdim se *“ky koncept përshkruan një proces dhe tregon një gjendje shoqërore, e cila karakterizohet me praninë e ndërlidhjeve dhe rrjedhave globale ekonomike, politike, kulturore dhe mjedisore”*.²³

Të gjitha këto parime që u përmendën më lartë, janë shumë të përafërta me ato mbi të cilat u ngrit edhe Rendi i Ri Botëror, prandaj mund të konstatojmë se këto dy koncepte lindën dhe u zhvilluan paralelisht, duke qenë gati se e pamundshme që ato ti veçojmë. Duke u nisur edhe nga vetë fakti se këto dy koncepte në veçanti u aktualizuan me mbarimin e Luftës së Ftohtë dhe me kalimin nga sistemi ndërkombëtar bipolar tek ai unipolar, është me rëndësi të potencohet se bartësit e këtij procesi janë shtetet me nivel të lartë të zhvillimit, të udhëhequr nga ShBA-të, si fuqia e vetme globale ekonomike, politike dhe ushtarake.

Në të njëjtën kohë vlen pohimi se *“globalizmi si fenomen tangon çdo segment të jetës bashkëkohore, sepse pasojat nga globalizmi politik i ndjejnë dhe i paguajnë qytetarët e tërë shoqërisë botërore, si pasojë e ndryshimeve shoqërore të cilat paraqesin një proces reverzibil”*.²⁴

Në periudhën e pas Luftës së Ftohtë, Globalizimi vërehet më theks të veçantë në marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare, ku vendet e të gjithë botës janë duke u integruar në një treg të vetëm botëror. Po lindin zona të reja të rritjes ekonomike, sidomos në disa pjesë të Azisë, të cilat në vitet 1990 arritën zhvillim ekonomik të shquar (pavarësisht prej rënies së madhe në vitin 1997). Në të njëjtën kohë, pabarazitë ndërmjet të pasurve e të varfërve po rriten, si në shkallë

²³ Jonuz Abdullai, *Ndryshimet Sociale dhe Tranzicioni*, CRPA & Arbëria Design, Tetovë, 2008, fq. 113-114

²⁴ J. Abdullai, po aty, fq. 115

*botërore ashtu edhe brenda vendeve të veçanta (duke përfshirë edhe ShBA-në).*²⁵ Globalizimi ka ushtruar ndikimin e vet si në mënyrë pozitive ashtu edhe në mënyrë negative, duke krijuar dallime të mëdha në zhvillimin e shumë vendeve dhe rajoneve botërore, ndërsa reagimet kanë ardhur kryesisht prej atyre që janë ndikuar për keq prej tij ose që besojnë se dallimet janë rritur si pasojë e ndikimeve të huaja. Poashtu, mund të themi që Globalizimi, si fenomen shoqëror mund të sjell pasoja negative që janë gjithëpërfshirëse, por mund të sjell edhe shumë beneficione, që në të shumtën e rasteve janë selektive dhe çojnë në marginalizimin e mëtejshëm të shteteve apo rajoneve të pazhvilluara të botës.

5.2 Politika Globale e ShBA-ve

Krahas zhvillimit të Rendit të Ri Botëror, procesi i Globalizimit është duke i dhënë një dimension ndryshe sistemit të marrëdhënieve ndërkombëtare, i cili karakterizohet nga format e policentrizmit apo multipolarizmit, si rezultat i zhvillimit të shpejtë ekonomik të disa shteteve të cilat gradualisht bëhen fuqi në ngritje në arenën e zhvillimeve ndërkombëtare. Megjithatë, në vijim duhet ritheksuar rolin e fuqisë globale udhëheqëse të ShBA-së, e cila me kapacitetin e saj në fushën politike, ushtarake, ekonomike, teknologjike dhe kulturore vazhdon të mbajë rolin e liderit global, duke i përballuar fuqimisht të gjitha sfidat e mileniumit të ri.

Në planin e politikës së jashtme, ShBA-të dhe administrata e parë e Klintonit u përqendruan në implementimin e strategjisë së *angazhimit* dhe të *zgjerimit*, që në thelb do të thoshte se politika globale amerikane ishte kthyer drejt vendeve të reja, të cilat kishin marrë rrugën e tranzicionit politik dhe të demokratizimit shoqëror. *Roli udhëheqës amerikan në këto ndryshime globale do të shtrohej gradualisht si i domosdoshëm dhe ky duke gërshetuar zhvillimin e brendshëm me atë ndërkombëtar.*²⁶

Në vazhdim, do të përmendim disa prej parimeve, mbi të cilat bazohej strategjia amerikane në politikën e jashtme. Në radhë të parë, ShBA synonte forcimin dhe qëndrueshmërinë e rolit të tyre si lider global, pastaj forcimin e institucioneve ndërkombëtare, që krijojnë bazën për paqe dhe mirëqenie. Element tjetër shumë i rëndësishëm ishte promovimi i vlerave demokratike dhe

²⁵ J. S. Goldstein, po aty, fq. 62

²⁶ R. Vukadinoviç, po aty, fq. 342

të drejtave të njeriut, duke mbrojtur idealet mbi të cilat qëndronte fuqishëm. Në fushën e bashkëpunimit, udhëheqja amerikane theksoi nevojën e praktikimit të marrëdhënieve konstruktive me shtetet e mëdha aleate të Evropës Perëndimore, Japoninë por edhe me rivalët e dikurshëm – Kinën dhe Rusinë.

5.3 Politika e Jashtme e ShBA-së në Ballkanin Perëndimor

Ajo që neve në veçanti na intereson, bazuar në temën që kemi përzgjedhur për të hulumtuar, është fushëveprimi dhe ndikimi i politikës së jashtme amerikane në korrelacion me Evropën Juglindore, posaçërisht me rajonin e Ballkanit Perëndimor pas mbarimit të Luftës së Ftohtë. Pikërisht, kjo është arsyeja që ne të ndalemi dhe ta analizojmë këtë pjesë, në mënyrë më të detajuar.

Që nga fundi i Luftës së Ftohtë, Shtetet e Bashkuara kanë qenë të angazhuara në Ballkanin Perëndimor që të sigurojnë një Evropë që është "e tërë, e lirë dhe në paqe" dhe për të siguruar një partner i besueshëm për t'u përballuar me sfidat globale. Qëllimi i tyre ka qenë stabilizimi i Ballkanit, dhe rritjen e sigurisë në të gjithë Evropën, nëpërmjet integritetit të Ballkanit Perëndimor në strukturat trans - atlantike.²⁷

Lufta në Bosnjë-Hercegovinë dhe intervenimi ushtarak amerikan shihet si momenti kur i tërë rajoni i Evropës Juglindore mori rëndësi të veçantë për politikën e jashtme amerikane. Angazhim i tyre për ruajtjen e paqes në BH që lindi nga Marrëveshja e Dejtonit dhe zhvillimet politike në fqinjësi vetëm e rritën interesin amerikan për këtë rajon. Interesi i ShBA-së në këtë drejtim u forcua me shpalljen e Planit për Evropën Juglindore me të cilin ofrohej bashkëpunimi më pragmatik dhe do të mundësohej një lidhje më të ngushtë ndërmjet njëmbëdhjetë vendeve të Evropës Juglindore me Amerikën dhe do të zmbropsej interesi i Rusisë deri te kufijtë moldavo-ruse. Në vazhdim pasoi Plani i Klintonit për Veprim në Evropën Juglindore me të cilin Bullgarisë, Rumanisë, Maqedonisë dhe Sllovenisë u ofrohej zgjerimi i bashkëpunimit bilateral politik, ushtarak dhe ekonomik. *Kjo përbënte një përgatitje për krijimin e forcave ushtarake*

²⁷ Burim: <https://www.ncafp.org/2016/wp-content/uploads/2018/05/Time-for-Action-in-the-Western-Balkans.pdf>, fq. 2

*multilaterale në Maqedoni, të cilat do të duhej të shërbenin si mbështetje për zgjidhjen e krizës së Kosovës ose si pjesë e forcave ndërhyrëse.*²⁸

Politikat e BE-së dhe NATO-s nuk kanë qenë të qëndrueshme në drejtim të angazhimit dhe adresimit të vështirësive dhe problemeve të rajonit, që do të arrihej me inicimin e procesit të zgjerimit të anëtarësimit. *Uashingtoni, Brukseli si dhe kryeqytetet tjera të Evropës, nuk arritën t'u japin prioritet nevojave të Ballkanit Perëndimor gjatë viteve të fundit, pasi u ngritën çështje urgjente në Lindjen e Mesme, Azinë Lindore dhe gjetiu në Evropë, dhe thirrjet u shumëfishuan për një riorientim të politikës së jashtme amerikane.*²⁹

Për sa i përket pranisë së politikës së jashtme, është më se e dukshme se ShBA atë e sheh si të domosdoshme në planin afatgjatë. Kjo prani, më konkretisht do të ndihmonte në stabilizimin e rajonit dhe mos përsëritjen e konflikteve luftarake dhe krizave që lehtë barteshin në fqinjësi. *Nga ana tjetër, prania amerikane do të duhej t'i ndihmonte të gjitha këto vende, që gradualisht, përmes zhvillimit të demokracisë, të përfshihen në nivele më të larta të bashkëpunimit dhe marrëdhënieve më të mira reciproke, sepse kjo është rruga që duhet të ndjekin për tu afruar me integrimet evropiane.*³⁰

Në këto rrethana, parashtrohet pyetja: Pse ShBA duhet t'i kushtojnë më shumë rëndësi Ballkanit Perëndimor? Në përgjithësi, Ballkani Perëndimor është pika e dobët e Evropës, që nëpërmjet konflikteve të ndryshme, destabilizon dhe rrënon sigurinë e tërë kontinentit. Krimi i organizuar, terrorizmi ndërkombëtar, migrimi i paligjshëm që rezultojnë nga ekonomitë jo-të zhvilluara, institucionet e paqëndrueshme dhe qeverisja e brishtë në Ballkan do të ndikojnë në Evropë. Dhe dobësitë e problemet e Evropës ndikojnë në interesat e sigurisë kombëtare amerikane.

²⁸ R. Vukadinović, po aty, fq. 352

²⁹ Po aty: <https://www.ncafp.org/2016/wp-content/uploads/2018/05/Time-for-Action-in-the-Western-Balkans.pdf>, fq. 7

³⁰ R. Vukadinović, po aty, fq. 354

II - Ndryshimet Politike në shtetet e Ballkanit Perëndimor – Procesi i tranzicionit

1. Shpërbërja e Jugosllavisë dhe formimi i shteteve të reja

Vala e ndryshimeve socio-politike që kapluan Evropën, e sidomos atë Lindore dhe Qendrore gjatë fundit të viteve '80 dhe në fillim të viteve '90 të shekullit XX, padyshim që përfshinë edhe vendet e Evropës Juglindore, përkatësisht ato të Ballkanit Perëndimor. Në vrullin e këtyre ndryshimeve, ndodhën edhe ngjarje shumë të rëndësishme që formësuan të ardhmen e shumë shteteve dhe vendosën për fatin e popujve që jetonin brenda tyre. Rënia e Murit të Berlinit dhe bashkimi i Gjermanisë, sinjalizuan ndryshimet rrënjësore ku secili vend socialist evropian shihte fillimin e pashmangshëm të fundit të regjimeve të deriatëhershme dhe të sistemit ekonomik – politik të socializmit. Përderisa shpërbërja e Bashkimit Sovjetik u zhvillua në mënyrë relativisht paqësore, për fat të keq nuk ndodhi e njëjta edhe në Republikën Socialiste Federale të Jugosllavisë. Shpërbërja e saj, çoi në luftë të hidhur civile disa vjeçare, që përfundoi vetëm me intervenimin e forcave ushtarake të fuqive perëndimore.

Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë, e shpallur në vitin 1945 nga udhëheqësi komunist, i cili ishte simbol i rezistencës kundër Gjermanisë Naziste, Josip Broz Tito, përbëhej nga gjashtë republika: Maqedonia, Sllovenia, Kroacia, Bosnjë-Hercegovina, Serbia dhe Mali i Zi dhe dy krahina autonome, që ishin Kosova dhe Vojvodina. Edhe përkajë antagonizmave midis kombësive të ndryshme, Tito kishte arritur të ruante stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e kësaj strukture federale nëpërmjet regjimit të tij autoritar dhe Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë, si dhe duke ruajtur një ekuilibër mes serbëve dhe grupeve të tjera etnike. Ai braktisi dhe i tha jo politikës së Bashkimit Sovjetik duke dashur të çlirohet nga kontrolli i Stalinit dhe ndërkohë duke qëndruar besnik ndaj ideologjisë komuniste, ai u bë një nga përfaqësuesit kryesorë të Lëvizjes së njohur si të Pajkuadruarit apo të Paangazhuarit (Non-Aligned Movement), dukë i dhënë Jugosllavisë prestigj të madh ndërkombëtar. Pas vdekjes së Titos në vitin 1980, pushteti u ushtrua nga një presidencë kolektive e cila duhej të përballonte përkeqësimin e situatës

ekonomike, dështimin e vetëorganizimit socialist dhe mbi të gjitha, ringjalljen e konfliktit ndëretnik.

Profesor Etem Aziri potencon faktin se "ndodhitë në ish – federatën jugosllave të fundshekullit të kaluar që e befasuan njeriun e rëndomtë, por jo edhe njohësit e mirë të rrjedhave shoqërore-politike ishin rezultat i kundërthënieve të pranishme në shoqëri dekada me radhë. Kriza, e cila kishte përfshirë të gjitha poret e shoqërisë së atëhershme jugosllave, u thellua edhe më shumë pas vdekjes së liderit harizmatik, Josip Broz Tito, ideologut të socializmit vetëqeverisës, Edvard Kardelit dhe demonstratave të studentëve kosovarë në vitin 1981."³¹

Në aspektin kronologjik, krizat socio – politike mund të ndahen në dy periudha kohore: periudha e parë përfshin krizat politike dhe shoqërore që nga themelimi i federatës jugosllave e deri në vdekjen e Titos, dhe periudha e dytë, në të cilën përfshihen ngjarjet që nga shpërthimi i demonstratave studentore në Prishtinë, të vitit 1981 e deri në Kongresin e XIV të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë, pas të cilit filloi edhe shpërbërja përfundimtare e Federatës jugosllave.

*Lufta e Ftohtë me sistemin e saj të ngurtë të aleancave e qeveritë komuniste autoritare në Evropën Lindore duket se kanë ndihmuar për të mbajtur nën kontroll dhe konfliktet ndëretnike, duke krijuar idenë e mosekzistencës së problemeve dhe përplasjeve ndëretnike. Në Bashkimin Sovjetik dhe në Jugosllavi, ose në shtetet shumëkombëshe, ekzistenca e një shteti të vetëm dhe të fortë (i gatshëm për t'i shtypur bashkësitë vendore) i mbante të shtypura acarimet ndëretnike dhe e detyronte me forcë paqen ndërmjet bashkësive fqinje.*³²

Këto pohime, vetëm se e vërtetojnë faktin që federata jugosllave në fazat e ndryshme të zhvillimit dhe të ekzistencës së saj po ballafaqohej me kriza të cilat edhe pse me shumë vështirësi, arrinte t'i përballojë kryesisht falë aftësive udhëheqëse politike të liderit të saj harizmatik Josip Broz Titos. Pas vdekjes së tij, udhëheqësit politik u treguan të papërgatitur dhe të paaftë për tu përballuar me këto sfida, dhe kriza në të cilën gjendej federata po thellohej gjithnjë e më shumë. Kështu që, në fund të viteve '80 të shekullit XX u bë më se i qartë fillimi i

³¹ Etem Aziri, *Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë: Formimi, sfidat dhe perspektiva e zhvillimit demokratik*, Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, 2012, fq. 90

³² B. Gashi, P. Hidri, po aty, fq. 238

procesit të shpërbërjes së RSFJ-së, një proces që nxiti luftëra të përgjakshme ndëretnike, pasojat e të cilave popullata e këtyre vendeve i ndjen edhe në ditët e sotme.

Në vitin 1989, në Serbi erdhi në pushtet Slobodan Millosheviqi i cili nëpërmjet politikës së tij nacional-shoviniste dëshironte të zbatoj idetë dhe synimet e tij për krijimin e Serbisë së Madhe, dhe me këtë të tregoj epërsinë dhe hegjemoninë e popullit serb ndaj popujve tjerë të federatës jugosllave. Këto veprime, ndikuan në nxitjen e nacionalizmit tek popujt tjerë, e sidomos te ato slloven dhe kroat, të cilët iniciuan fushatat për pavarësinë e shteteve të tyre. E konsiderojmë si të rëndësishme të përmendim se procesi i ndarjes së shteteve nga federata jugosllave u intensifikua pas dështimit të Kongresit të katërmbëdhjetë të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë në janar të vitit 1990. Gjatë kësaj periudhe, më saktë gjatë viteve 1990 dhe 1991 u zhvilluan një sërë bisedimesh dhe përpjekjesh për ruajtjen e Jugosllavisë apo krijimin e një lloj konfederate, që rezultuan të pasuksesshme.

Megjithëse Partia Komuniste, e cila u bë Partia Socialiste nën udhëheqjen e Slobodan Millosheviçit në vitin 1989 mbeti në pushtet në Serbi dhe Mal të Zi, ajo shkëputi lidhjet e saj me Lidhjen Komuniste të Jugosllavisë në Slloveni dhe Kroaci në shkurt të vitit 1990. Në korrik të atij viti Kuvendi i Sllovenisë miratoi Deklaratën për sovranitet, ndërsa në shtator Kuvendi i Kosovës shpalli kushtetutën e re dhe Kosovën Republikë. Në nëntor, zgjedhjet e lira në Bosnjë panë humbjen e komunistëve. Në dhjetor, Kroacia miratoi një kushtetutë të re që i jepte të drejtën të shkëputej, dhe sllovenët në referendum votuan për pavarësi. Më 21 dhe 22 shkurt 1991, parlamentet sllovene dhe kroate propozuan 'shkëputjen' e Federatës në disa shtete sovrane dhe autonome.

Më në fund, më 25 qershor 1991, Kroacia dhe Sllovenia shpallën pavarësinë dhe 'shkëputjen' e tyre nga Federata Jugosllave, një shpallje që u refuzua nga Parlamenti Federal. Më 27 qershor, Ushtria Federale, e përbërë kryesisht nga serbët, u urdhërua në Slloveni për të marrë kontrollin e pikave të kontrollit në kufijtë italianë, austriakë dhe hungarezë. Filloi konflikti i dhunshëm. Në

*Kroaci, u bë një konfrontim i përgjakshëm midis policisë kroate dhe ekstremistëve serbë, të cilët u mbështetën nga ushtria federale.*³³

Lufta që pasoi në Kroaci, rezultoi me dhjetëra mijëra të vdekur, dhe qindra mijëra njerëz të shpërngulur. Në Bosnje-Hercegovinë, referendumi për pavarësinë u mbajt në mars të vitit 1992, por u bojkotua nga pakica serbe. Pjesëmarrja e përgjithshme e votuesve në referendum ishte 63.6% nga të cilat 99.7% votuan për pavarësinë e Bosnje dhe Hercegovinës. Parlamenti i pranoi rezultatet dhe republika shpalli pavarësinë e saj nga Jugosllavia në mars të po atij viti, ndërsa serbët në Bosnjë deklaruan zonat e tyre një republikë të pavarur. Maqedonia shpalli pavarësinë pas një referendumi të suksesshëm në 8 shtator 1991, dhe një forcë paqeruajtëse dhe monitoruese e ShBA-ve u dërgua në kufirin me Serbinë për të monitoruar dhunën e mundshme. *Kroacia dhe Sllovenia u njohën ndërkombëtarisht në janar të vitit 1992, dhe pavarësia e Bosnjës u njoh së shpejti pas kësaj. Të tre vendet u anëtarësuan në Kombet e Bashkuara më 22 maj 1992. Serbia dhe Mali i Zi formuan një Republikë të re Federale të Jugosllavisë si një shtet pasardhës të Jugosllavisë së vjetër, por bashkësia ndërkombëtare nuk e njohu pretendimin e saj pasardhës.*³⁴ Në këtë drejtim, vlen të përmendim faktin që politika e SHBA-së për një kohë të caktuar qëndroi jashtë ngjarjeve dhe konflikteve që pasuan shpërbërjen e ish Jugosllavisë duke ndjekur fillimisht veprimet e institucioneve dhe shteteve evropiane. Shteti i cili në kuadër të Bashkimit Evropian u angazhua politikisht më shumë për ndërprerjen e operacioneve ushtarake në luftën e Kroacisë ishte Gjermania, e cila sapo kishte përfunduar procesin e ribashkimit të saj. Angazhimi i Gjermanisë për njohjen diplomatike të Kroacisë dhe Sllovenisë erdhi kryesisht si rrjedhojë e qëllimeve të saj për fuqizimin e pozitës së saj në Evropën Qendrore dhe Juglindore si dhe afirmimin e influencës në disa prej shteteve të ish Jugosllavisë.

³³ Burim: <https://www.cvce.eu/en/recherche/unit-content/-/unit/02bb76df-d066-4c08-a58a-d4686a3e68ff/60cec468-a4c6-4cda-917e-3860fe5dbfbf>

³⁴ Burim: <https://history.state.gov/milestones/1989-1992/breakup-yugoslavia>

1.1 Lufta në Bosnjë dhe Hercegovinë

Politika serbe e gjysmës së dytë të viteve tetëdhjetë e bazuar në konceptin e Millosheviqit, fillimisht pikësynimin e kishte homogjenizimin e serbëve dhe malazezëve në Kosovë, e më vonë përhapjen e këtij sindromi edhe në pjesët e tjera të vendit.³⁵ Këtë synim, Serbia e tregoi në vepër me zhvillimin e politikës ekspansioniste dhe nacionaliste kundrejt shteteve tjera anëtare të Jugosllavisë të cilët kërkonin pavarësinë e tyre, duke përfshirë fillimisht konfliktin e armatosur në Slloveni, luftërat e përgjakshme në Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe duke vazhduar me luftën në Kosovë në vitin 1998/1999.

Lufta në Bosnjë dhe Hercegovinë filloi në pranverë të vitit 1992, një vit pas shpërbërjes së dhunshme të Federatës jugosllave pjesë e së cilës ishte edhe ajo. Lufta boshnjake paraqiste fazën e tretë dhe më shkatërrimtare të shpërbërjes jugosllave, pas një konflikti për ndarje nga ana e Sllovenisë dhe një luftë serioze për ndarje të Kroacisë.³⁶ Për dallim nga Sllovenia dhe Kroacia, të cilët kishin një koncept të qartë dhe të unifikuar kombëtar për ndërtimin e shtetit të pavarur, të cilën e përkrahte shumica e popullsisë, situata në Bosnjë dhe Hercegovinë ishte më e ndryshme. Në fillim, populli ishte shprehur për mbetjen në Federatën jugosllave, duke dominuar më vonë tre kombësi – boshnjake, serbe dhe kroate. Mbas zgjedhjeve të dhjetorit 1990, u formua Qeveria e koalicionit me pjesëmarrjen e tri partive kombëtare (SDA, HDZ dhe SDS), kurse kryetar i Bosnjës dhe Hercegovinës u zgjodh Alija Izetbegović. Mirëpo, të nxitur nga politika e Millosheviqit dhe duke mos qenë dakord për një shtet të përbashkët, krerët e SDS-së nisën luftën për autonominë e serbëve në Bosnjë dhe Hercegovinë. Të ndihmuar nga forcat e Armatës Popullore Jugosllave (APJ), serbët iu vunë përvijimit të territorit nacional serb, por kjo do të nxiste rezistencën e kroatëve dhe të myslimanëve. SDA mobilizoi për mbrojtje forcat myslimane, kurse HDZ organizoi Këshillin Kroat të Mbrojtjes në rajonet kroate.³⁷

E gjithë kjo situatë e tensionuar që u krijua, vetëm se mori intensitet më të lartë me shpalljen e pavarësisë së Bosnjë dhe Hercegovinës pas referendumit të mbajtur ndërmjet datave 29 shkurt

³⁵ E. Aziri, po aty, fq. 103

³⁶ Elizabet M. Kusens, Çetan Kumar, Karin Vermester, *Ndërtimi i paqes si politikë: Ruajtja e paqes në shoqëritë e brishta*, Ars Lamina, Shkup, 2012, fq. 115-116

³⁷ R. Vukadinović, po aty, fq. 272

dhe 1 mars të vitit 1992, në të cilin popullata serbe nuk morri pjesë dhe rezultatet e të cilit i shpalli si jolegjitime. Si rrjedhojë, filloi veprimi ushtarak nga ana e serbëve të cilët ishin të ndihmuar nga APJ dhe në këtë mënyrë nisi procesi i “spastrimit etnik” dhe lufta për territore, në të cilën prinin serbët me SDS në krye, duke masakruar qindra mijëra njerëz të popullatës joserbe dhe duke ushtruar një terror dhe gjenocid të pa precedent, dhe të tillë që historia nuk kishte njohur deri atëherë.

Në periudhën në vijim, për tre vite e gjysmë, forcat qeveritare boshnjake luftuan për mbrojtjen e shtetit unitar dhe të pavarur, që do të kishte kufijtë e njëjtë dhe që do tu garantonte liritë dhe të drejtat e barabartë të gjithë qytetarëve të saj, ashtu siç gëzonin edhe kur Bosnja ishte pjesë e federatës jugosllave. Në fillim këtë luftë ato e zhvilluan kryesisht kundër nacionalistëve serbë, të cilët ishin të lidhur dhe të furnizuar nga Serbia dhe kërkonin republikën e pavarur serbe, që do të mund të bashkohej me Serbinë. Më pastaj, edhe pse jo me intesitet aq të lartë, luftoi edhe kundër kroatëve të Bosnjës, të cilët filluan përvetësimin e krahinave të banuara me kroatë në Bosnjën Qendrore dhe Jugore në prill të vitit 1993. Ky konflikt u zgjidh, të paktën në mënyrë taktike, në vitin 1994, pas përpjekjeve intensive diplomatike të ShBA-ve.

1.2 Ndërhyrja e faktorit ndërkombëtar

Aktiviteti i shteteve të mëdha në fillim të konfliktit në ish-Jugosllavi ishte shprehje e një përzierje interesash me konceptet e politikës së tyre të jashtme, por ai kishte edhe një veçori të përbashkët – synimin për të profilizuar secili ndikimin e vet në atë rajon. Duke ndjekur disa përvoja historike, tradita të marrëdhënieve si dhe përkime në fushë të kulturës dhe qytetërimit, fuqitë e mëdha kërkonin pikëmbështetje të tilla në situatën e krijuar, që do tu shërbenin si pika orientimi në kohën kur tashmë ishte shembur ish-shteti jugosllav dhe kur në hapësirat ballkanike ishin krijuar shtete të reja.³⁸

Në vazhdim të asaj që u tha më lartë, mund të themi se pozicionimi apo qëndrimi i shteteve të fuqishme, veçanërisht në lidhje me luftën në Bosnjë dhe Hercegovinë ishte mjaft konfuz dhe jo kompakt, dhe me këtë nënkuptojmë se individualisht çdo shtet kishte planet, idetë si dhe

³⁸ Po aty, fq. 273

propozimet e ndryshme se në çfarë mënyre do t'i jepej fund luftës së përgjakshme, gjithmonë duke qenë të kujdesshëm që të mos ndërhyjnë në interesat e tyre të ndërsjella.

Kjo pjesë në mënyrë të veçantë shpjegohet në librin *Ndërtimi i paqes si politikë: Ruajtja e paqes në shoqëritë e brishta* e edituar nga Elizabet M. Kusens, Çetan Kumar dhe Karin Vermester ku dhe thotë:

Gjatë luftërave që u zhvilluan pas shkatërrimit të Jugosllavisë, faktori ndërkombëtar ishte i ndarë dhe nuk kishte një qëndrim të përbashkët. Evropa dhe ShBA kishin raporte delikate dhe jo aq të mira me Rusinë, kjo e bënte edhe më të vështirë që ato merrnin dhe të mbështesnin anën boshnjake në konflikt. Në të njëjtën kohë ShBA-të, të cilët nuk donin të përfshihen në konflikt kritiknin politikën evropiane dhe mosefikasitetin e tyre, që në realitet ishte një sprovë për kapacitetin e ndërtimit të politikës së jashtme dhe të sigurisë së Evropës. *Në mënyrë institucionale, organizatat si KB, BE dhe NATO përpiqeshin që të zinin vend në botën e re pas përfundimit të Luftës së Ftohtë. Në qeveritë, ndarjet mes agjensioneve mes sektorëve luftarak dhe politik, mbyllën një spektër të gjerë të opsioneve të cilët do të përfshinin një përdorim më të gjërë të fuqisë ushtarake. Në mënyrë operative, siç zhvillohej lufta, komponentët kryesor të aksionit ndërkombëtar në Bosnjë – ruajtja e paqes, ndihmat humanitare dhe përpjekjet për ndërmjetësim bëheshin gjithnjë e më kontradiktore.*³⁹

Misioni i parë paqeruajtës i Kombeve të Bashkuara – UNPROFOR u dërgua në Bosnjë dhe Hercegovinë në fillim të muajit qershor të vitit 1992, përderisa betejat e luftës vazhdonin dhe forcat ushtarake serbe e kishin pushtuar më shumë se gjysmën e territorit të Bosnjës. Ashtu siç gjendja në Bosnjë dhe Hercegovinë përkeqësohej dhe lufta po zhvillohej me beteja të ashpra të intensitetit të lartë, roli i komunitetit ndërkombëtar mbetej i paqartë, e sidomos ai i ShBA-së, administrata e së cilës, nën udhëheqjen e këshilltarit për siguri ndërkombëtare Entoni Lejk, kah gjysma e vitit 1995 për herë të parë zhvilloi një strategji seriozë për përfundimin e luftës. Këtu, vlen të ritheksohet se më herët, në vitin 1994 strategjia amerikane ishte më tepër e fokusuar në arritjen e rindërtimit taktik të aleancës ndërmjet Boshnjakëve dhe Kroatëve të Bosnjës, të cilët nëpërmjet marrëveshjes së Uashingtonit u obliguan të bashkohen në një federatë të pasluftës.

³⁹ E. M. Kusens, Ç. Kumar, K. Vermester, po aty, fq. 119

Kjo marrëveshje, njëkohësisht i bashkoi të dy popujt në një aleancë ushtarake, që luftonin për kthimin e territoreve të marra nga serbët.

Si rrjedhojë e këtyre zhvillimeve, mund të themi se ndërmjetësimi ndërkombëtar, përpjekjet luftarake dhe humanitare deri nga mesi i vitit 1995 filluan të funksionojnë në mënyrë më produktive dhe më të harmonizuar duke ju përmbajtur një strategjie të përbashkët për përfundimin e luftës. Kur forcat serbe morën peng mijëra paqeruajtës të OKB-së pas sulmeve ajrore të NATO-s në maj të vitit 1995, ishte e dukshme ndërhyrja e qeverive botërore të inkuadruara, për gjetjen e zgjidhjes së krizës në Bosnjë dhe Hercegovinë. Kjo bëri që edhe intervenimi i trupave amerikane në konflikt të jetë gjithnjë e më i pashmangshëm, me qëllim që të mundësojnë tërheqjen e sigurt të trupave aleate. Ngjarjet brutale të marrjes së enklavës së Srebrenicës dhe Zhepës nga ana e serbëve të Bosnjës në korrik të po atij viti, duke i hequr së bashku me mijëra civilët e dëbuar ose të vrarë, dy grupet paqeruajtëse më të forta të OKB në vend, vetëm se e konfirmuan miratimin për intervenim të përbashkët ushtarak të faktorit ndërkombëtar.

1.3 Arritja e Marrëveshjes Paqësore të Dejtonit

Në takimin e korrikut të vitit 1995 në Londër, ministrat e punëve të jashtme të vendeve të cilat kishin trupat e tyre në Bosnjë e përfunduan marrëveshjen e “dyfishtë”, që kërkonte miratimin civil nga OKB për aksion të NATO duke u pajtuar për përdorimin e fuqisë ushtarake me qëllim pengimin e sulmit në Gorazhde – zona e ardhshme e sigurt që duhej të ishte sulmuar nga forcat ushtarake serbe, në të njëjtën duke i tërhequr paqeruajtësit e OKB nga enklava. Për më tepër, administrata e Klintonit deklaroi se trupat amerikane mund të përfshihen në çfarëdo lloj marrëveshje paqësore që do të arrihet. Të gjitha këto vendime sinjalizuan një bashkim të ri në diplomacinë ndërkombëtare dhe gatishmëri që ajo të mbështetet me përdorimin e fuqisë më të madhe ushtarake.⁴⁰

Presioni i fuqishëm diplomatik dhe ushtarak ndërkombëtar, tani më rolin kryesor dhe udhëheqës e të cilit e kishin marrë ShBA-të, dhe dobësimi i pozicioneve ushtarake serbe duke pësuar humbjen e territoreve nga armatat boshnjake dhe kroate, detyroi palën serbe e cila

⁴⁰ Po aty, fq. 122

ndodhej para disfatës, të pranoj bisedimet për arritjen e paqes. Motivi tjetër i rëndësishëm që e shtyri NATO-n të ndërmerr aksionin e sulmeve ajrore ishte gjithashtu sulmi minahedhës i forcave serbe i 28 gushtit ku humbën jetën 37 civilë në tregun e Sarajevës.

Ditët e fundit të luftës, tregojnë se sa ishte efikas operacioni ajror i NATO-s përkrah sukseseve ushtarake boshnjake dhe kroate. NATO dhe RRF (trupat ushtarake për intervenim të shpejtë të OKB-së) të vendosura në fazat më të vonshme të luftës, filluan bombardim të fuqishëm ajror mbi pozicionet serbe rreth Sarajevës më 29-30 gusht, menjëherë pas sulmit në tregun e Sarajevës, me të cilat vazhduan më 5 dhe 12 shtator. I udhëhequr nga Riçard Holbruk, misioni amerikan hartoi në shtator të vitit 1995 në Gjenevë, kornizën kryesore të Planit Paqësor, e cila si bazë e parashikonte krijimin e një Bosnje dhe Hercegovinë të pavarur dhe unike e përbërë nga dy entitete politike të njehta, edhe atë entiteti boshnjako – kroat me kontroll territoriale prej 51% dhe tjetri i kontrolluar nga serbet me 49% të territorit. Në tetor, sulmeve të ripërtërita të armatës serbe, iu kundërpërgjigjën NATO me sulme ajrore, derisa nuk hyri në fuqi armëpushimi nga mesi i po atij muaji.

Më 1 nëntor filluan bisedimet e ndara në bazën ushtarake Rrajt-Paterson në Dejton, Ohajo, ndërsa më 20 nëntor, kryetari kroat Tugjman, kryetari serb Millosheviq, kryetari boshnjak Izetbegoviq dhe kryetari i federatës boshnjako-kroate Kreshimir Zubak, e pranuan marrëveshjen e Dejtonit. Më 14 dhjetor 1995, “Marrëveshja e përgjithshme kornizë për paqe” ishte zyrtarisht e nënshkruar në Paris.⁴¹

Dispozitat kryesore kishin të bënin me krijimin e një Bosnje-Hercegovine unike, të përbërë nga dy entitete, me kthimin e refugjatëve dhe me themelimin e një gjykate të posaçme për dënimin e kriminelëve të luftës. Kontrollin e zbatimit të marrëveshjes e morën përsipër forcat e IFOR-it, komandimi i të cilëve iu besua NATO-s.

Para marrëveshjes së Dejtonit, u zhvilluan një sërë marrëveshjesh paqësore nga trupa të ndryshme ndërkombëtare për ndërmjetësim, prej të cilave asnjëra nuk ishte aq e pranueshme për palët në konflikt, ose i përmbajtur mjaftueshëm nga aktorët ndërkombëtar, me qëllim që të bëhet bazë për marrëveshje gjithëpërfshirëse.⁴² Në parim, kjo marrëveshje ishte e mundshme aty ku marrëveshjet më parë ishin të perealizueshme, si rezultat i rritjes së përfshirjes të

⁴¹ Po aty, fq. 124

⁴² Po aty, fq. 120

komunitetit ndërkombëtare në konflikt që ndihmoi të krijohet, si dhe të përforcohet baraspesha e ndryshueshme e fuqisë ushtarake mes palëve në konflikt.

1.4 Statusi i Kosovës brenda RSFJ-së dhe pas shpërbërjes së saj

Kosova ishte shteti i fundit i cili shpalli pavarësinë dhe sovranitetin e plotë të njohur nga faktori ndërkombëtar, që nga fillimi i shpërbërjes së RSFJ-së gjatë viteve 1990 dhe 1991. Që nga protesta dhe ndodhitë e vitit 1968, Kosova si njësi federative e ish Jugosllavisë mbante statusin Krahina Socialiste Autonome e Kosovës, duke fituar një shkallë më të lartë të autonomisë dhe vetëqeverisjes me miratimin e Kushtetutës jugosllave të vitit 1974 dhe që u trashëgua nga definimi administrativ i mëparshëm, Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë. Pas vdekjes së Titos, pakënaqësitë nga situata ekonomike dhe politike në RSFJ u rritën, ndërsa kriza sociale po thellohej gjithnjë e më tepër. Shpërthimi i demonstratave studentore të vitit 1981, në Prishtinë, në të cilat studentët shqiptarë kërkonin avancimin e drejtave të tyre dhe statusin e Kosovës brenda federatës jugosllave, dhe që u shtypën me dhunë policore dhe ushtarake nga Presidenca jugosllave, shënuan fillimin e acarimit dhe tensionimit të raporteve ndëretnike në mes shqiptarëve dhe serbëve, njëkohësisht duke paralajmëruar fillimin e procesti të shpërbërjes së RSFJ-së.

Fillimet e tranzicionit dhe të demokratizimit të shoqërisë, në Kosovë i hasim që në fillim të vitit 1990, që ndodhën paralelisht me ndryshimet socio-politike të vendeve të Evropës Qendrore, Juglindore dhe me shpërbërjen e RSFJ-së, ku populli shqiptar i Kosovës braktisi sistemin komunist njëpartiak dhe gradualisht përqafoi sistemin politik pluralist dhe demokratik. Në valën e pavarësimit të shteteve anëtare nga Federata jugosllave, në rrethana të vështira politike dhe nën presionin e vazhdueshëm të pushtetit serb, deputetët shqiptar të kuvendit të Kosovës më 2 korrik të vitit 1990, shpallën Kosovën shtet të pavarur brenda Jugosllavisë, ndërsa, *më 7 shtator 1990, kuvendi miratoi Kushtetutën e Republikës së Kosovës.*⁴³ Kuptohet që këto veprime u pritën në mënyrë armiqësore nga Republika Federative Jugosllave (Sërbia dhe Mali i Zi) dhe nga kryetari i saj nacionalist Slllobodan Millosheviçit, i cili ndërmori masat represive duke shpërbërë Kuvendin e Kosovës dhe duke urdhëruar arrestimin e deputetëve të Kuvendit të shpërbërë. Në

⁴³ Arsim Bajrami, *Demokracia Parlamentare: Aspekte Krahasese*, Prishtinë, 2005, fq. 291

*referendumin gjithëpopullor të mbajtur më 26-30 shtator të vitit 1991,*⁴⁴ u rikonfirmua pavarësia dhe sovraniteti i shpallur më herët, ku mbi 99% të popullatës shqiptare u deklaruan pro pavarësisë së Kosovës. *Zgjedhjet e para të lira dhe demokratike parlamentare dhe presidenciale në Kosovë u mbajtën me 24 maj të vitit 1992,*⁴⁵ me pjesëmarrjen masive nga populli shqiptar, në të cilët u zgjodhën deputetët e Kuvendit me kombinim të parimit të shumicës dhe atë proporcional, ndërsa Ibrahim Rugova, një ndër themeluesit dhe lideri i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) u zgjodh njëzëri kryetar i Republikës së Kosovës, duke udhëhequr rezistencën paqësore kundër pushtimit serb.

1.5 Lufta në Kosovë dhe pavarësimi

Tensionet ndëretnike vazhduan të përkeqësohen përgjatë viteve '90, ndërsa gjendja e popullsisë shqiptare vazhdoi të jetë shumë e vështirë. Presidenti serb Millosheviç duke përdorur kërcënime dhe manovrime politike filloi shtypjen dhe represionin ndaj popullatës etnike shqiptare të Kosovës, që solli deri në acarimin e skajshëm të tyre dhe mobilizimin për të vazhduar me rezistencë të armatosur. E gjithë kjo rezultoi me krijimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në periudhën e hershme të vitit 1995, e cila në fillim kryesisht u mbështet nga ndihmat financiare dhe materiale nga diaspora shqiptare dhe për qëllim kishte çlirimin e vendit nga represioni dhe terrori serb. Lufta në Kosovë filloi më shkurt të vitit 1998 dhe zgjati deri më qershor të vitit 1999, dhe ajo u zhvillua mes forcave të armatosura të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. *Gjatë kësaj lufte 800.000 shqiptarë u dëbuan nga vendbanimet dhe territoret e tyre, jetën e humbën 15.000 njerëz, nga të cilët 2.400 luftëtar të UÇK-së e të tjerët popullatë civile, poashtu janë zhdukur afër 5.000 njerëz, shumica e të cilëve kanë mbetur raste të pazbardhura.*⁴⁶ Situata eskaloj më tej, kur forcat serbe kryen spastrime etnike dhe masakra të shumta kundër popullatës shqiptare të Kosovës, siç ishte edhe masakra në Prekaz, në të cilën një nga themeluesit e UÇK-së, Adem Jashari dhe rreth 60 anëtarë të familjes së tij, ndër të cilët 18 gra dhe 10 fëmijë, u rrethuan në shtëpitë e tyre dhe u vranë.

⁴⁴ Po aty, fq. 291

⁴⁵ Po aty, fq. 292

⁴⁶ Burim: https://sq.wikipedia.org/wiki/Lufta_e_Kosov%C3%ABs

Deri në vitin 1998, presioni nga faktori ndërkombëtar detyroi forcat serbe që të nënshkruajnë armëpushim dhe të tërhiqte një pjesë të trupave të saj, proces i cili duhet të monitorohej nga vëzhguesit e OSBE-së, sipas marrëveshjes së negociuar nga Riçard Hollbruk. Armëpushimi nuk zgjati shumë dhe luftimet vazhduan në dhjetor të vitit 1998, duke arritur kulmin në masakrën e Reçakut, ngjarje e cila tërhoqi vëmendjen e mëtejshme ndërkombëtare. Disa javë më vonë, më shkurt 1999, filluan bisedimet për Marrëveshjen e Rambujesë, të negociuara nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Javier Sollana, e cila parashihte rivendosjen e autonomisë së Kosovës dhe vendosjen e forcave paqeruajtëse të NATO-s. *Në 18 mars 1999, delegacionet shqiptare, amerikane dhe britanike firmosën atë që u bë Marrëveshja e Rambujesë ndërkohë që delegacionet jugosllave (serbe) dhe ruse nuk pranuan.*⁴⁷ Disa ditë më vonë, pasi bisedimet për paqe dështuan, më 24 mars NATO ndërhyri në luftën e Kosovës, duke filluar me bombardimet kundër Jugosllavisë, të cilat zgjatën deri më 10 qershor të vitit 1999, dhe që detyruan që Millosheviçi të tërheq trupat e tij nga Kosova dhe të lejoj praninë e misionit paqeruajtës dhe ushtarak ndërkombëtar të KFOR-it.

*Rezoluta 1244 është miratuar nga Këshilli i Sigurimit të OKB-ës, në mbledhjen e tij të 4011-të, më 10 qershor të vitit 1999. Ajo i dha fund agresionit serb ndaj Kosovës dhe ndërpreu gjenocidin shtetëror serb, i cili synonte spastrimin etnik të Kosovës.*⁴⁸ Me fjalë të tjera, kjo rezolutë shënoi fundin e luftës çlirimtare të UÇK-së, që u ndihmua nga komuniteti ndërkombëtar dhe NATO, duke u kurorëzuar me lirinë e Kosovës, dhe duke mundësuar kthimin e një numri të madh të shqiptarëve në vendlindjet e tyre, të cilët gjatë kohës së luftës u larguan dhe u deportuan me dhunë në shtetet fqinje dhe anembanë botës. Rezoluta 1244 përcaktoi një administrim ndërkombëtar të përkohshëm, që synonte krijimin e kushteve të përshtatshme demokratike për zgjidhjen e statusit final të Kosovës. Pas dështimit të bisedimeve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit për statusin final të Kosovës, OKB-ja dërgoi përfaqësuesin e saj Marti Ahtisari, i cili në vitin 2007 nxori Planin Gjithëpërfshirës, ku përcaktohej pavarësia e mbikëqyrur me të drejta të zgjeruara për pakicat, sidomos serbët. *Shqiptarët bënë shumë koncesione dhe kompromise që, më në fund të fitojnë “pavarësinë e mbikëqyrur” të cilën e shpallën më 17 shkurt 2008, në akordim me Shtetet e Bashkuara dhe një numër shtetesh me influencë politike në Bashkimin*

⁴⁷ Po aty, https://sq.wikipedia.org/wiki/Lufta_e_Kosov%C3%ABs

⁴⁸ A. Bajrami, po aty, fq. 292

Evropian.⁴⁹ Kuvendi i Kosovës shpalli pavarësinë dhe sovranitetin e saj, duke u thirr në Rezolutën 1244 dhe Planin e përgjithshëm të Marti Ahtisarit, por në ndërkohë Serbia hapi procedurën e vlerësimit të ligjshmërisë së shpalljes së pavarësisë së Kosovës para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Pavarësisht kësaj, për në fund duhet thënë që pavarësia e Kosovës paraqet një fakt dhe realitet i pashmangshëm, dhe ndonëse jo me intensitetin e pritur, mbështetet nga vendet anëtare të OKB-së që e njohin pavarësinë e saj, numri i të cilëve vazhdimisht po rritet.

2. Shqipëria – fundi i regjimit komunist dhe procesi i tranzicionit

2.1 Aspekte historike të rrëgjimit komunist në Shqipëri

*Ndonëse shpesh herë jashtë vëmendjes së të Mëdhenjve të botës dhe jashtë tryezave vendimmarrëse edhe për fatet e tyre, popujt dhe vendet e Ballkanit gjithsesi kanë pasur, si për mirë ashtu edhe për keq impakte të padiskutueshme prej Fuqive Botërore, Evropiane dhe madje edhe Rajonale. Vetë pozicioni gjeografik dhe ekonomik, nga njëra anë, si dhe lidhjet dhe afiliacionet e shumta me popuj dhe vende të ndryshme të Evropës dhe botës nga ana tjetër, e bëjnë rajonin e Ballkanit që të mos i shmanget kurrësi prirjeve të zhvillimeve politike që përfshijnë Evropën dhe mbarë Globin.*⁵⁰

I referohemi mendimit të autorit Lisen Bashkurti, pasi që pikërisht edhe në rastin e Shqipërisë së pas Luftës së Dytë Botërore, vërehet prezenca e ndikimit të faktorit politik të jashtëm Evropian, botëror e sidomos atij rajonal në formësimin e kursit apo ideologjisë politike që do ta ndjek ky shtet në pothuajse 50 vitet e ardhshme, duke vazhduar të ushtrojë një model të regjimit totalitar komunist më të ashpër dhe më të paskrupull, ndërmjet shteteve të bllokut socialist të Evropës Juglindore në atë kohë. Ky pohim rrjedh nga fakti se komunistët shqiptar erdhën dhe konsoliduan radhët e tyre me mbështetjen nga jashtë, e sidomos nga Partia Komuniste Jugosllave, e cila njihej në atë periudhë edhe si një ndër partitë më të vjetra dhe më me ndikim në Evropën Lindore.

⁴⁹ Agni Aliu, Esat Stavileci, Qeverisja Lokale: Njoftime themelore dhe shqyrtime krahasimtare, Universiteti i EJT, Tetovë, Prishtinë, 2009, fq. 127

⁵⁰ Lisen Bashkurti, *Diplomacia Shqiptare në fillimet e Luftës së Ftohtë, 1945-1961*, Vëllimi i dytë, Tiranë, 2003, fq. 71

Periodha e hershme e mbas Luftës së Dytë Botërore mjafton për të kuptuar se Shqipëria u vetëpërcaktua për rrugën lindore dhe komuniste të zhvillimit, duke refuzuar kategorikisht konceptin perëndimor dhe demokratik dhe duke e humbur shansin për t'u bashkuar me të. *Këtë prirje thellësisht Lindore e vërteton edhe trajektorja e marrëdhënieve dypalëshe tejet të komplikuar midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë ndërmjet viteve 1944-1948. Kjo trajektore dëshmon se regjimi komunist i Tiranës ndoqi rrugën jugosllave për aq kohë sa Jugosllavia e Titos zbatonte linjën e ashpër kundër perëndimit dhe kishte afilacione të plota me Bashkimin Sovjetik dhe u largua nga rruga Jugosllave sapo Jugosllavia filloi afrimin me Perëndimin dhe ndërpreu lidhjet me Bashkimin Sovjetik.*⁵¹

*Rrethanat të cilat favorizuan vendosjen e regjimit komunist në Shqipëri janë komplekse dhe produkt i disa kushteve dhe faktorëve historikë, politikë, ekonomikë dhe socialë. Shumë studiues bien dakord që gërshetimi i kushteve primitive shoqërore, ekonomike, politike, si dhe pushtimi italian e më pas ai gjerman gjatë Luftës së Dytë Botërore ishin deri diku përcaktues për vendosjen e diktaturës pas luftës në vend.*⁵² Megjithatë, nuk duhet anashkaluar edhe faktin që strategjia e ndjekur për marrjen e pushtetit nga komunistët ishte shumë e rëndësishme si për vendosjen ashtu edhe për vazhdimin e pushtetit komunist. Ndër te tjera, kjo ndodhi si rezultat i dy arsyeve kryesore: e para, është se komunistët e propaganduan Luftën Nacionalçlirimtare të Shqiptarëve si arritje dhe meritë kryesisht e tyre, dhe e dyta, ashtu siç e cekëm edhe më lartë, komunistët, për dallim nga forcat nacionaliste kishin një ndihmë dhe mbështetje të madhe nga jashtë vendit. Kjo ndihmë materiale erdhi kryesisht nga forcat anglo – amerikane, e mbështetur edhe te ndihma e Moskës, e cila kryesisht ushtrohej në vend përmes emisarëve jugosllavë. Duke i pasur parasysh këto avantazhe, Partia Komuniste filloi luftën civile kundër kundërshtarëve të vet për marrjen e pushtetit. Njësoj si në Jugosllavi, qeveria e përkohshme komuniste e Enver Hoxhës nisi me larjen e hesapeve më “kriminelët e luftës” si dhe me bashkëpunëtorët e pushtuesve, dhe për një periudhë të shkurtër kohore u asgjësuan të gjitha elementet e asaj që mund të quhej opozitë.

⁵¹ Po aty, fq. 131-132

⁵² Burim: <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2014/04/Doktoratura-Elda-Zotaj-Instituti-Studimeve-Europiane.pdf>, fq. 63-64

Një vit pas çlirimit të vendit, duke mos u pasur asnjë konkurrencë politike opozitare por edhe si pasojë e presionit të perëndimorëve, duke mos e njohur qeverinë e drejtuar prej tyre, komunistët më 2 dhjetor të vitit 1945 shpallën zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese. Ato fituan bindshëm, dhe me marrjen e pushtetit “de jure”, më 11 janar të vitit 1946 Shqipëria u shpall Republikë Popullore, duke hequr edhe formalisht regjimin monarkik. Në 12 janar 1946, Presidiumi i Asamblesë Kushtetuese zgjodhi Dr. Omer Nishanin president të parë të saj, ndërsa më 14 mars Asambleja Kushtetuese u shndërrua në Kuvendin Popullor, si dhe votoi Kushtetutën e Republikës Popullore të Shqipërisë, e cila kishte ngjashmëri të mëdha me kushtetutën e Federatës jugosllave. *Më 22 mars të 1946-ës, Qeveria Provizore u zëvendësua me një qeveri tjetër, e kryesuar po nga Hoxha dhe me një legjitimitet që vinte nga zgjedhjet e 2 dhjetorit të vitit 1945. Veç postit të Kryeministrit, Hoxha mbante edhe atë të ministrit të jashtëm dhe të ministrit të mbrojtjes, ndërsa zëvendëskryeministër dhe ministër i brendshëm ishte numri dy i regjimit, Koçi Xoxe.*⁵³

Ishte pikërisht kjo periudha kur Shqipëria ishte në fazën e nënshtrimit total ndaj Jugosllavisë dhe periudha në të cilën marrëdhëniet bilaterale të këtyre dy shteteve ishin duke u intensifikuar deri në atë masë, sa që filluan bisedimet serioze për idenë e bashkimit të këtyre dy vendeve. Këtë nënshtrim ndaj Jugosllavisë dhe drejtimin të cilin e ndoqi Shqipëria në politikën e jashtme, shumë studiues e shohin si negativ, pasi ka qenë në kundërshtim me interesat kombëtare dhe e ka vënë në rrezik pavarësinë e brishtë të shtetit shqiptar të dalë nga Lufta e Dytë Botërore. Nëse nuk do të kishte ndodhur konflikti midis Moskës dhe Beogradit, Shqipëria praktikisht do të ishte republika e shtatë e Konfederatës jugosllave. Denoncimi që i bëri Stalini – Titos për antisovjetizëm dhe revizionizëm pozicionuan përnjëherë drejtuesit komunist Shqiptarë në krahun e tij. Situata e krijuar (konflikti Stalin – Tito) u shfrytëzua nga Enver Hoxha jo vetëm që të eliminonte grupin projugosllav (që ishte një kërcënim serioz) por mbi të gjitha për të fuqizuar pozitën dhe pushtetin e tij. *Shumë vendime dhe veprime politike të më vonshme,*

⁵³ Blendi Fevziu, *100 Vjet (1912-2012)*, UET Press, Tiranë. 2012, fq. 195-196

*përfshirë ndërprerjen e lidhjeve me Bashkimin Sovjetik dhe Kinën, janë nxitur kryesisht nga marrëdhëniet e përmirësuara të Titos me Hrushovin dhe Mao Zedong-un.*⁵⁴

Një valë spastrimesh ndaj elementeve projugosllave nga radhët e partisë dhe shtetit bënë që të rikonfigurohej Byroja Politike në të cilën Kongresi i I-rë i Partisë zgjodhi njerëzit më besnikë të Hoxhës.⁵⁵ Për mënyrën se si Enver Hoxha konsolidoi, fuqizoi dhe ushtroi pushtetin e tij, do tu referohemi të dhënave rrëqethëse të cilat autori Blendi Fevziu i nxjerr në pah, duke e cituar atë: “Dhuna ndaj kundërshtarëve politik, ose atyre që konsideroheshin kundërshtarë politikë, ishte e frikshme. Në 46 vitet e sundimit të tij, Regjimi krijoi një bilanc tragjik: 5037 burra dhe 450 gra u ekzekutuan. 16788 burra dhe 7367 gra u dënuan me burgime nga 3 deri 35 vjet. Shpeshherë dënimet shtoheshin përmes ridënimit brenda në burg. 70 mijë vetë u internuan, 354 shtetas të huaj u pushkatuan, ndër ta 95 shqiptarë të Kosovës. Në vend u ngritën 40 burgje, shumica e të cilëve shfrytëzonte punën pa pagesë të të dënuarve në miniera”.⁵⁶

Ndërkaq, në politikën e jashtme, aleancat kryesore të cilat Shqipëria i realizoi në periudha të ndryshme nën sundimin e Enver Hoxhës në mes tjerash ishin, aleanca me Jugosllavinë, Bashkimin Sovjetik dhe Kinën. Gjatë regjimit të Enver Hoxhës, marrëdhëniet me fqinjët mbetën prioritare dhe u kushtojë një vëmendje e posaçme. Edhe pse ato dallonin në periudha të ndryshme kohore, Republika Popullore e Shqipërisë iu përmbajt parimeve të fqinjësisë së mirë të sanksionuara me Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe ajo kurrë nuk u bë faktor për shkeljen e këtyre parimeve. *Sidomos mbas ndërprerjes së marrëdhënieve diplomatike me Bashkimin Sovjetik dhe reduktimin e bashkëpunimit me vendet e Evropës Lindore, Republika Popullore e Shqipërisë demonstroi akoma më shumë vullnetin e mirë për paqe, stabilitet dhe bashkëpunim fqinjësor.*⁵⁷ Duke e pasur parasysh inferioritetin e Shqipërisë në raport me shtetet tjera fqinje, ajo zhvilloi një politik relativisht të tërhequr dhe paqësore, duke e reduktuar Luftën e Ftohtë vetëm në aspekt ideologjik, dhe duke lejuar bashkëpunim të ndërsjellë shtetëror ndërmjet vendeve fqinje, pavarësisht ndryshimeve në sistemet politiko – ekonomike. Kjo kuptohet që nuk

⁵⁴ Бленди Февзиу, *Енвер Хоџа: Прва биографија заснована на документи од лична архива и на исповедите на оние што го познаваа*, Фондација Отворено Општество – Македонија, Shkup, 2014, fq. 155

⁵⁵ Po aty: <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2014/04/Doktoratura-Elda-Zotaj-Instituti-Studimeve-Europiane.pdf>, fq. 71

⁵⁶ B. Fevziu, po aty, fq. 185-186

⁵⁷ Lisen Bashkurti, *Diplomacia Shqiptare – Diplomacia e Vetëizolimit*, Vëllimi i tretë, Tiranë, 2004, fq. 186

vlente edhe për raportet me Jugosllavinë, në të cilat Hoxha e shihte me skepticizëm çdo tentim të Titos për të forcuar pozitën e tij dominuese në rajonin e Ballkanit, duke i kundërshtuar vazhdimisht iniciativat dhe veprimet e tij.

2.2 Vdekja e Enver Hoxhës dhe ardhja e Ramiz Alisë në pushtet

Diktatura në Shqipëri u zhvillua si një diktaturë e drejtuar nga një kastë politike që gllabëroi pushtetin politik duke sakrifikuar interesat shoqërore në emër të interesave të saj vetjake. Realpolitika e aplikuar nga udhëheqja komuniste (marrja dhe mbajtja e pushtetit me të gjitha mjetet) përvijoi politikën 50 vjeçare të shtetit shqiptar. Si pasojë e politikës ekstreme, në Shqipëri u aplikuan format më të egra të dhunës dhe terrorit në shoqëri. Sistemi diktatorial u mbështet në atë çka u quajt mentaliteti i gjendjes së rrethimit ose i shtetit - kazermë, i cili e vinte theksin mbi ekzistencën e grupeve armiqësore nga brenda dhe jashtë vendit.⁵⁸ Kjo ishte mënyra se si regjimi komunist mbajti pushtetin gjatë tërë periudhës së ekzistencës, ngjashëm si edhe në shtetet tjera komuniste ato vazhdimisht shpiknin grupe armiqësore të cilët ose eliminoheshin fizikisht ose mbylleshin në burgje apo kampe përqendrimi. Aparati i sigurisë së shtetit, dhënia e një rëndësie të madhe këtij segmenti dhe gjithsesi eliminimi të gjitha elementeve të shtetit të së drejtës, ishin mjeti dhe strategjia që rezultoi e suksesshme për të mbajtur shoqërinë të shtypur, të përçarë dhe të frikësuar.

Në fillim të viteve 1980 Shqipëria radhitej ndër shtetet më të varfra të Evropës, me një rrogë mesatare prej 6 dollarësh, dhe me racionim prej 1kg mish në javë dhe pa asnjë lloj prone private. Tirana ishte kryeqyteti më i varfër në Evropë dhe në gjithë vendin qarkullonin 1265 makina. Ajo që vlen të përmendim është se arsimi megjithëse i ideologjizuar kishte njohur zhvillim masiv, ku përveç shkollave të mesme të përgjithshme dhe profesionale të shtrirë në gjithë vendin, në vitin 1957 u hap edhe Universiteti Shtetëror i Tiranës me 3600 studentë dhe 200 mësues, i pari Universitet në Shqipëri. Nga ana tjetër, shoqërisë i mungonin të gjitha liritë, ajo ekonomike, fetare politike, e shprehjes dhe e mendimit, qytetarët e kishin të ndaluar të dilnin jashtë Shqipërisë dhe ato të cilët tentonin të arratiseshin në shumë raste kishin humbur

⁵⁸ Po aty: <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2014/04/Doktoratura-Elda-Zotaj-Instituti-Studimeve-Europiane.pdf>, fq. 67

edhe jetën. Kushtetuta e vitit 1976 i përfshiu të gjitha këto, ndaloi fenë, e shpalli Shqipërinë shtetin e vetëm ateist në botë dhe ndaloi çdo lloj forme të pronës private, duke shërbyer si një shembull unik i rendit kushtetues, të cilin nuk e kishte asnjë vend tjetër komunist në botë.

Në vitin 1984, Enver Hoxha ishte në vitin e 40-të të “mbretërimit” të tij dhe në mbarim të jetës. Ai u shfaq për herë të fundit në publik në 28 nëntor të 1984-ës, plot 40 vjet pas shfaqjes së parë si drejtues i Shqipërisë, ditën që qeveria provizore e Beratit hyri në Tiranë. Komunizmi po festonte 40-vjetorin, ai kishte dominuar më shumë se gjysmën e ekzistencës së shtetit shqiptar.⁵⁹

Mëngjesin e 9 prillit të 1985-ës, rreth orës 9.00, Enver Hoxha ra në vdekje klinike. Njeriu që kish sunduar Shqipërinë për 41 vjet me radhë jetoi edhe dy net. Ai nuk u zgjua më kurrë. Enver Hoxha ndërroi jetë në ora 2 e 10 minuta duke gdhirë mëngjesi i 11 prillit të vitit 1985. Më 18 prill të 1985-ës, Ramiz Alia u zgjodh Sekretar i Parë i KQ të PPSH-së, ose njeriu që do të pasonte tashmë zyrtarisht Enver Hoxhën. Ai do të sundonte vendin me metoda shumë më të buta, por me të njëjtën vazhdimësi, deri në 4 prill të vitit 1992, por pasi kishte humbur kontrollin absolut me shpalljen e pluralizmit në 11 dhjetor 1990.⁶⁰

2.3 Fundi i regjimit komunist

Gjatë tërë lidërshiptit të tij, Alia nuk do të shpalosej as si diktator dhe as si liberal. Si i tillë Alia do të humbiste gradualisht besimin e fanatikëve enveristë, pa arritur të fitonte simpatinë e komunistëve reformatorë dhe të mbështetësve të tij ndërkombëtar. Si makiavelist i politikës shqiptare, Ramiz Alia më tepër i kushtoi kohë, energji, dhe aftësi ruajtjes së ekulibreve të vogla udhëheqëse që e sollën dhe e mbanin në pushtet, sesa ekulibreve të mëdha që do të ndryshonin dhe do të reformonin Shqipërinë drejt Evropës. Atëherë kur prishja e ekulibreve të mëdha shqiptare lëkundti për vdekje edhe ekulibrat e vogla në udhëheqjen e lartë në krye të së cilës qëndronte Ramiz Alia, ky i fundit filloi ndryshimet e detyruara, të sforcuara, të kufizuara dhe tepër të vonuara.⁶¹

⁵⁹ B. Fevziu, po aty, fq. 218

⁶⁰ Po aty, fq. 219-220

⁶¹ L. Bashkurti, po aty, fq. 656

Plotësisht dakordohemi me faktin që Ramiz Alia me ardhjen e tij në pushtet trashëgoi edhe të gjitha problemet që ishin ngarkuar në shoqërinë shqiptare për vite me radhë, dhe sfidat me të cilat ai do të ballafaqohej nuk ishin aspak të lehta. Megjithatë, duhet potencuar edhe faktin që ai kurrë nuk tregoi shenja konkrete, vullnet politik por edhe gatishmëri të vërtetë për të ndërmarrë reforma rrënjësore duke refuzuar të pranojë realitetin në të cilin gjendej vendi në çdo segment të mundshëm të jetës shoqërore dhe realitetin e ri politik që kishte filluar të kaplojë shtetet tjera komuniste të Evropës juglindore. Përpos lëvizjeve antikomuniste që kishin filluar të zhvillohen në të gjitha vendet e bllokut lindor, ishte pikërisht ekzekutimi i homologut të tij Nikolae Çausheku në Rumuni në 25 dhjetor të vitit 1989 që paralajmëroi Ramiz Alinë se ishte e paevitueshme që Shqipëria të mos përfshihej nga këto ndryshime dhe se ai ishte ndër liderët e fundit të mbetur komunist, të cilit tanimë seriozisht po i kërcënohej pozita udhëheqëse.

Viti 1990 është një vit i rëndësishëm për historinë e shtetit Shqiptar, pasi që pikërisht ky, ishte viti në të cilin ndodhën shumë ngjarje të rëndësishme që shënuan fillimin e ndryshimeve dhe kthesën në rrjedhën e zhvillimeve politike të vendit. Që në fillim, pra në janar të vitit 1990 filluan lëvizjet e para të demonstratave kundër regjimit komunist, më saktë në 14 janar ndodhi demonstrata e parë në qytetin e Shkodrës, ku pati tentativa konkrete për rrëzimin e bustit të Stalinit. Kjo ngjarje e ndezi situatën në vend dhe kështu u përhapën lajmet për organizimin e protestave në qytetet tjera dhe në kryeqytet, të cilës do ti pasonte një periudhë mjaft kaotike të përcjellë me kriza politike dhe trazira të shumta.

Në vazhdim të revoltës dhe pakënaqësive të shumta ndaj regjimit komunist, të cilët tashmë qytetarët merrnin guximin që ti shprehin lirshëm, ishte Protesta studentore e dhjetorit të vitit 1990, e cila filloi me daljen e më shumë se 100 studentëve në sheshin e Qytetit Studenti në krye me Azem Hajdarin. Këtij grupi të vogël të studentëve iu bashkëngjitën edhe shumë të tjerë, dhe grupi i cili tashmë numëronte afër 2000 student filluan të ecin nëpër rrugët që të çonin në bulevardin qendror të Tiranës ose në sheshin “Skënderbe”, me të vetmen kërkesë, takimin me Ramiz Alinë. Kësaj kërkesë iu përgjigj vetë ai, dhe lajmi për takimin me atë mbërriti te grupi i protestuesve pak pas mesnatës midis 8 dhe 9 dhjetorit. Një grup i vogël i udhëhequr nga Azem Hajdari u nisën drejt korpusit qendror të Universitetit për tu takuar me Ramiz Alinë, me të cilin

zhvilluan një bisedë të shkurtër gjatë së cilës ai kërkoi nga ato të zgjidhnin një përfaqësi, e cila do të takohet me të ditën e hënë pasdite, dhe kërkoi që deri atëherë ato të ndiqnin ligjëratat e rregullta. Përfaqësia e studentëve mbërriti te protestuesit dhe në ndërkohë Ministri i Brendshëm kishte dhënë urdhër për shpërndarjen e protestës me akuza se studentët i kishin vjedhur pistoletën një oficeri. Grupet e forcave speciale sulmuan me armë të forta studentët, dhe ato u mbrapsën për te qyteti Studenti ku edhe kërkuan hartimin e kërkesave të tyre, ndërmjet të cilave për herë të parë doli në skenë ideja e pluralizmit.

Më 9 dhjetor 1990, grupi i studentëve vendosën që të vazhdonin me protestën dhe përsëri ishin të bllokuar nga forcat e policisë, Sali Berisha kur mori lajmin se çfarë po ndodhte në qendër të Tiranës u nis në drejtim të qytetit student. Në mbrëmje po atë ditë, ndodhi takimi ndërmjet Ramiz Alisë dhe Sali Berishës, një ngjarje shumë e rëndësishme për të cilën Alia me vonë do të deklarojë që ka qenë e rastësishme dhe se shkakun që thirri Berishën ishte se drejtuesit e protestës ishin nga Tropoja, dhe ai kërkonte një njeri me influencë që të fliste me ta. Berisha ia ktheu përgjigjen Ramiz Alisë të nesërmen, në takimin e dytë midis tyre, ku edhe u bë më se e qartë që kishte ardhur koha e shumëpritur e pluralizmit politik. Në këto rrethana, më 12 dhjetor 1990 grupi nismëtar i studentëve dhe intelektualëve në qytetin Studenti shpallën krijimin e Partisë Demokratike, partinë e parë opozitare në Shqipëri. *Lideri i lëvizjes studentore, Azem Hajdari, lexoi vendimin për krijimin e saj, ndërsa Arben Limani programin minimal të partisë.*⁶²

Gjatë muajve janar-mars të vitit 1991 manifestimi dhe shprehja e lirë e ideologjive të ndryshme politike vazhdoi, kështu që përpos Partisë Demokratike, në bllokun politik opozitar u paraqitën edhe parti të tjera, si Partia Republikane, Partia Social-demokrate, Partia Ekologjike etj. Në një situatë mjaft të tensionuar, më 14 dhjetor të vitit 1991, Partia Demokratike zhvilloi zgjedhjet e para për kryetar, ku kardiologu Sali Berisha u zgjodh kreu i saj. Ishte pikërisht muaji shkurt, kur edhe protestat studentore filluan të intensifikohen, duke filluar me atë të studentëve të Institutit bujqësor të Kamzës të cilëve më pas ju bashkëngjitën edhe studentët e Tiranës, tashme duke shtuar një kërkesë të re, heqjen e emrit “Enver Hoxha” nga Universiteti i Tiranës. Në mëngjesin e 20 shkurtit të vitit 1991, mbi 100 000 vetë kishin vërshuar rrugët e Tiranës në mbështetje të studentëve duke i shoqëruar ato përballë godinës ku zhvillohej Greva e urisë.

⁶² B. Fevziu, po aty, fq. 250

Turma e protestuesve u nisë drejt sheshit Skënderbe, forcat policore kishin vendosur më shumë përforcime rreth Bllokut dhe më pak rreth monumentit të Enver Hoxhës. Kështu grupi i policëve dhe i ushtarëve me qen, që qëndronin në mbrojtje të tij filloi të humbasë nën një turmë kërcënuese që numërohej në afro 100 mijë vetë. *15 minuta përpara orës 14.00 sulmi i protestuesve u bë aq i papërballueshëm sa policët u tërhoqën drejt qendrës së sheshit. Dikush lidhi në dorën e monumentit një kavo çeliku. Në 14.05 të datës 20 shkurt të 1991-it, pasi u lëkund 2-3 herë, monumenti i bronzit të Hoxhës u shemb.*⁶³ Ky akt u shoqërua me veprime të ngjashme në Korçë e në qytete tjera, ndërsa kërkesa e studentëve për heqjen e emrit Enver Hoxha të Universitetit të Tiranës u pranua me vendim të qeverisë. Në këto rrethana, në mbrëmjen e 20 shkurtit mbaroi protesta dhe greva e urisë së studentëve, që njëkohësisht shënoi edhe fillimin e fundit të regjimit komunist në Shqipëri.

2.4 Periudha e ndryshimeve politike dhe tranzicioni

Si diçka shumë e natyrshme dhe që pritej të ndodhte, pas ngjarjeve që tronditën fuqishëm regjimin komunist dhe shtetin shqiptar në përgjithësi erdhi edhe reagimi i Ramiz Alisë. Një ditë pas përfundimit të protestës, ai njoftoi themelimin e një këshilli presidencial, që do të luante funksionet e Presidentit si organ kolegjal. Këtë vendim e kundërshtoi ashpër opozita, duke e konsideruar atë si një grusht shteti, për arsye se Presidenti po merrte kompetencat e kryeministrit që nuk ia jepte kushtetuta. Po atë natë Alia rrëzoi qeverinë Çarçani, ndërsa kryeministër u emërua Fatos Nano, personi i cili deri më vitin 2005 do të zgjidhej edhe tre herë të tjera si kryeministër i Shqipërisë.

Marsi i vitit 1991, poashtu filloi me një ngjarje të rëndë, ndryshe e njohur edhe si *Eksodi i Marsit*, ku brenda tre ditëve afër 25 mijë qytetarë u larguan nga vendi në drejtim të Italisë. Kjo erdhi ndër të tjera, si pasojë e krizës politike dhe ekonomike, ngjarjeve destabilizuese që goditën vendin si dhe ndjenja e pasigurisë në rritje te qytetarët. Në këto rrethana, pas zhvillimit të një fushate zgjedhore të ashpër midis subjekteve politike, në 31 mars 1991 në Shqipëri u mbajtën zgjedhjet e para pluraliste që nga ato të fundit të vitit 1923. Ato ishin zgjedhje të përgjithshme për në Kuvendin popullor, dhe do të zhvilloheshin sipas sistemit mazhoritar,

⁶³ Po aty, fq. 255

ndërsa vendi ishte i ndarë 250 zona elektorale. Zgjedhjet u zhvilluan kryesisht pa incidente dhe pengesa të mëdha, PPSH-ja kishte fituar në zgjedhje 169 deputetë, ose 67.6% të Parlamentit, Partia Demokratike 75 deputetë ose 30%, Omonia 5 deputetë ose 2% dhe veteranët 1 deputet. Qytetet i kishte fituar pothuajse të gjitha opozita, ndërsa fshatin Partia e Punës. *Në Tiranë nuk kish fituar asnjë kandidat i PPSH-së, i vetmi që kishte dal në balotazh ishte Kryeministri Fatos Nano, që do të përballej në një raund të dytë më 14 prill. Njeriu më i votuar i Shqipërisë ishte kreu i PDSH-së, Sali Berisha me 83% të votave në Kavajë.*⁶⁴

Në ndërkohë, në 2 prill në Shkodër u organizua një protestë e madhe si shenjë pakënaqësie nga rezultatet e zgjedhjeve, në të cilën humbën jetën 4 të rinj, aktivist të Partisë Demokratike. Gjendja u acarua përsëri, punëtorët, sidomos ata të minierës së Valiasit filluan grevën e urisë, që u përhap edhe në qytete të tjera. *Një javë më pas, PD-ja kushtëzoi hyrjen në parlament me gjetjen e vrasësve të Shkodrës dhe vënien e tyre para drejtësisë. Në seancën e parë, ajo dërgoi në parlament vetëm kryetarin e grupit parlamentar, Neritan Cekën që lexoi një deklaratë tejet të ashpër. PD-ja u kthye në Parlament dy javë më pas.*⁶⁵

Kuvendi i ri popullor ndryshoi emërimin nga Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë në Republika e Shqipërisë, u hoqën simbolet e komuniste si ylli i kuq në flamur, si dhe me propozim të PD-së u zhvleftësua Kushtetuta e vitit 1976, në vend të cilës u hartua Paketa Kushtetuese që do të rregullonte jetën në vend deri në miratimin e Kushtetutës së re. Kuvendi popullor me 2/3 e votave zgjodhi Ramiz Alinë president të Republikës, opozita votoi kundër, ndërsa Alia dekretoi sërish Fatos Nanon si kryeministër. Në ndërkohë, nga data 10 – 13 Qershor 1991, u zhvillua Kongresi i X i PPSH-së në të cilin përveç distancimit nga trashëgimia e Hoxhës, kongresi miratoi vendimin për ndryshimin e emrit të Partisë së Punës në Partia Socialiste e Shqipërisë, me statut dhe program të ri, kryetar i së cilës u zgjodh Fatos Nano. Detyrë që do ta mbante, me një shkëputje të vogël në vitin 1999, deri më 2005-ën, kohë kur në vend të tij do të ngjitej Edi Rama.

Situata në vend ishte tepër e tensionuar, pakënaqësia te populli rritej, dhe në këto rrethana qeveria Nano u detyrua të jep dorëheqje në qershor të vitit 1991. Ajo u zëvendësua nga Qeveria e Stabilitetit, e cila qëndroi në fuqi deri më 4 dhjetor 1991, kur edhe PD-ja tërhoqi ministrat e

⁶⁴ Po aty, fq. 262-263

⁶⁵ Po aty, fq. 263

*saj. Drejtimi i vendit deri në zgjedhjet e parakohshme të 22 marsit do të bëhej nga një qeveri teknike e drejtuar nga Vilson Ahmeti.*⁶⁶

Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare, të mbajtura më 22 mars 1992, Partia Demokratike fitoi 92 vende në parlament ose 62.8% të votave ndërsa Partia Socialiste mori vetëm 38 vende ose 25.7%, PSD-ja 7 vende ose 4.3% të votave dhe partitë e tjera numër të pamjaftueshëm votash. Parlamenti zgjodhi president Sali Berishën, kryetarin e PD-së, i cili u bë presidenti i parë postkomunist i vendit, dhe ai ngarkoi Aleksandër Meksin si kryeministër të krijonte qeverinë e parë demokratike, e cila u miratua nga parlamenti. Të gjitha këto zhvillime, e vendosën Shqipërinë në procesin e vërtetë demokratizues, por kishte një nevojë të madhe për depolitizimin e institucioneve dhe administratës shtetërore, për reforma rrënjësore në të gjitha sferat shoqërore, sidomos në sektorin drejtësisë dhe të sundimit të ligjit, në atë të ekonomisë së tregut, politikës fiskale dhe atë sociale.

*Përtej euforisë dhe entuziazmit, Presidentit të vendit i duhej të përballej me një realitet të frikshëm. Më 1992 vendi numëronte zyrtarisht 730 mijë të papunë, numri i tyre filloi të shtoej, 100 mijë vetë u hoqën për 3 javë vetëm në administratën qendrore. Pothuajse gjithë ndërmarrjet u mbyllën dhe vendimi më i rëndësishëm që heqja e sistemit ku punonjësit paguheshin me 80% të pagës edhe kur nuk kishte punë. Po në muajt e parë, qeveria mori vendimin për liberalizimin e çmimeve të shportës, ku përfshihej edhe buka. Çmimi i saj u rrit 20 herë brenda natës.*⁶⁷

Qeveria e re dhe parlamenti nxorën disa ligje të reja për kryerjen e reformave demokratike. Ligjet më të rëndësishme të cilët u sollën ishin: Dispozitat e përgjithshme Kushtetuese, ligjet për tokën, për mbrojtjen e investimeve të huaja në Shqipëri, për privatizimin, për të drejtat e njeriut etj. Partitë politike dhe shoqatat u shtuan shumë, mirëpo dy parti ishin kryesore, Partia Demokratike dhe ajo Socialiste. U privatizuan, tokat e kooperativave dhe të ndërmarrjeve bujqësore, artizanati, tregtia, banesat etj. U liberalizuan çmimet dhe u gjallërua tregu, Shqipëria u hap ndaj botës dhe u lidhën shumë marrëveshje bashkëpunimi me firma e shtete të huaja. Këto shndërime ekonomike dhe politike shënuan fitoren e revolucionit demokratik në Shqipëri

⁶⁶ Po aty: <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2014/04/Doktoratura-Elda-Zotaj-Instituti-Studimeve-Europiane.pdf>, fq. 105

⁶⁷ B. Fevziu, po aty, fq. 273

dhe e forcuan pozitën e saj në raport me shtetet tjera fqinje si dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare në përgjithësi. Në qershor të vitit 1992, vetëm dy muaj pasi që zgjedhur President, Sali Berisha mbërriti në Uashington për një takim zyrtar me Presidentin Xhorxh Bush. Ai kish vendosur lidhje të forta me republikanët dhe në Ballkan, afërsia e shqiptarëve me Uashingtonin pati ngjallur jo pak xhelozë.⁶⁸

Më 26 korrik 1992 u zhvilluan zgjedhjet e para pluraliste për pushtetin lokal. Rezultati i zgjedhjeve ishte një surprizë e vërtetë. Vetëm 3 muaj pas fitores së thellë në zgjedhjet parlamentare, pozitën e Partisë Demokratike tronditen. Partia Demokratike kishte fituar në rang kombëtar përqindje më të madhe votash se Partia Socialiste, por kjo e fundit kishte fituar numër më të madh bashkishë e komunash, numër më të madh përfaqësuesish në këshillat e rretheve, bashkive dhe komunave.⁶⁹ Si shkak kryesorë për këto rezultate të Partisë Demokratike në zgjedhjet lokale, u cilësua efekti i reformave ekonomike të popullsisë. Përgjegjësia poashtu u hodh edhe të një grup i anëtarëve të Partisë Demokratike, ku bënë pjesë disa prej themeluesve, si Gramoz Pashko, Arbem Imami, Preç Zogaj etj. Të cilët u akuzuan si shkaktarë të këtij rezultati, pasi ishin treguar neglizhentë në fushatë dhe kishin kritikuar Sali Berishën, funksionimin e PD-së dhe qeverisë. Gjatë kësaj periudhe, PD-ja kaloi një krizë të brendshme, që rezultoi me përjashtimin nga partia të këtij grupi të cilin ata gjatë mbledhjes së Këshillit Kombëtar të partisë e quajtën “grup armiqësor” dhe “mocionist”, duke i akuzuar anëtarët si karrieristë, komunistë, bashkëpunëtorë të sigurimit të shtetit, dhe antireformatorë. Vlen të përmendet se kjo ishte ndër betejat e para për pushtet brenda partisë dhe fraksionimi i parë i saj. Të përjashtuarit nga partia, bashkë me Neritan Cekën do të krijonin partinë e re të quajtur Aleanca Demokratike, e cila ishte aktive në skenën politike shqiptare kryesisht deri në vitin 2001.

Gjatë vitit 1994, raportet ndërmjet partisë në pushtet dhe opozitës u tensionuan edhe më tej, ky debat u ashpërsua sidomos pas vendimit të Gjykatës së Tiranës, për dënimin e Fatos Nanos me 12 vjet burg për veprën penale të përvetësimit të pasurisë shtetërore me anë të

⁶⁸ Po aty, fq. 274

⁶⁹ Burim: <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2018/10/Tranzicioni-A.-Nexhipi.pdf>, fq. 59-60

shpërdorimit të detyrës dhe për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve zyrtare. Partia Socialiste rifilloi protestat dhe kërkesën për zgjedhje të parakohshme duke e akuzuar Sali Berishën dhe qeverinë për korrupsion, autoritarizëm, keqmenaxhim të situatës politike në vend, dhe krime politike. Poashtu, gjatë këtij viti me punë vazhdoi komisioni Kushtetues që kishte për detyrë hartimin e projektkushtetutës, për të cilën PD-ja dhe PS-ja patën shumë mospajtime prej në fillim, e duke vazhduar me ato deri në momentin kur kushtetuta duhet të miratohej në parlament. Si rrjedhojë e këtyre mosmarrëveshjeve, më datë 10 tetor u votua në parlament projektvendimi i Presidentit për miratimin e kushtetutës me referendum. Akt, me të cilin socialistët nuk u pajtuan, me arsyetimin që referendumi në këtë rast ishte i paaplikueshëm, duke mos ju dhënë qytetarëve mundësinë për të ndryshuar diçka, pasi atyre u jepej hapësira të thoshin vetëm JO ose Po. *Referendumi u mbajt më 6 nëntor 1994, i gjithë procesi i votimit u drejtua dhe monitorua nga Komisioni Qendror i Votimit, i krijuar me vendim të Presidentit. Pavarësisht disa parregullsive proceduriale të vëna re në procesin e votimit, Komisioni Qendror i Votimit në deklaratën zyrtare shprehej se referendumi u zhvillua normalisht, pjesëmarrja në votim ishte 84,43% e zgjedhësve, 41,7% votuan pro kushtetutës, 53,9% votuan kundër.*⁷⁰ Dy ditë pas mbajtjes së Referendumit, i dëshpëruar nga rezultati, Sali Berisha doli me deklaratë se e ka pranuar humbjen, ndërsa Shqipëria mbeti pa Kushtetutë, deri më vitin 1998, kur do të hartohej një tjetër.

Në 26 maj të vitit 1996, në një atmosferë tepër të tensionuar u zhvilluan zgjedhjet parlamentare, të cilëve u paraprinë përplasjet e ashpra ndërmjet dy subjekteve politike kryesore të vendit. Partia Socialiste, ditën e zgjedhjeve, akuzoi PD-në se po vidhte votat, dhe se po pengonte procesin zgjedhor dhe shprehjen e lirë të vullnetit popullor. Për këtë arsye ajo bojkotoi procesin zgjedhor, ndërsa rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve rikonfirmuan PD-në në pushtet me 125 deputetë në parlamentin e ri. Partia Socialiste fitoi 10 vende në parlament, PBDNJ (Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut) 3 deputetë, PR (Partia Republikane) 1 deputet dhe PBK (Partia e Ballit Kombëtar) 1 deputet.

PS-ja refuzoi të hyjë në Parlament, Aleksandër Meksi u zgjodh sërish Kryeministër më 11 korrik. Gjendja u duk sikur po qetësohej pas zgjedhjeve lokale të 20 tetorit që i fitoi kryesisht PD-ja, por

⁷⁰ Po aty: <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2018/10/Tranzicioni-A.-Nexhipi.pdf>, fq. 79

*problemi tashmë nuk qëndronte tek opozita. Sfida e vërtetë e pushtetit me legjitimitet të cenuar politik ishte ajo me firmat piramidale.*⁷¹

2.5 Kriza e Skemave Piramidale e vitit 1997

Kriza e firmave piramidale, dhe gjendja anarkike e krijuar nga trazirat që goditën rëndë Shqipërinë në gjysmën e parë të vitit 1997, e kaloi në plan të dytë çështjen e kushtetutës. Hartimi i kushtetutës vazhdoi të mbetej një detyrë dhe kërkesë e pashmangshme, sidomos e faktorit ndërkombëtar. Në atë periudhë Shqipëria ishte i vetmi vend në Evropë që nuk kishte ende kushtetutë. Poashtu viti 1997 paraqet pika më kritike për qeverisjen e Sali Berishës dhe të PD-së, që erdhi si pasojë e falimentimit apo shembjes së firmave piramidale, që rezultuan me protesta masive dhe të dhunshme të popullatës, duke shkaktuar krizën ndoshta më të rëndë që shteti shqiptar ka njohur në historinë e tij.

*Skemat piramidale ose firmat rentiere, siç e quanin veten, filluan të shfaqen në Shqipëri që në vitin 1991. Aktiviteti i tyre bazohej mbi marrjen e një sasive parash dhe kthimin e një sasive më të madhe në bazë të një përqindjeje që shkonte deri në 5% në muaj. Ndonëse në dukje funksiononin si banka, piramidat nuk kishin asnjë investim konkret nga ku mund t'i nxirrnin paratë.*⁷² Deri më vitin 1997 u themeluan dhe zhvilluan aktivitetin e tyre shume firma piramidale huamarrëse, ndër të cilat më të mëdha ishin: ajo e para e Hajdin Sejdisë e vitit 1991, më pastaj vinin Vefa, Demokracia Popullore – Xhaferi, Sudja, Kamberi, Bashkimi, Gjallica, e shumë të tjera. Këto firma merrnin hua me interesa që shkonin nga 10% deri në 30 – 50% në muaj, kishte prej atyre që ofronin 300% në tre muaj. Mënyra e këtillë e funksionimit hapi shumë pyetje dhe dyshime, dhe paralajmëroi falimentimin e sigurt të tyre brenda një periudhë të shkurtër.

Fillimi i dështimit të qeverisë ishte kur qeveria reagoi në mënyrë pasive ndaj këtij fenomeni dhe nuk morri masa për të lajmëruar popullin për rrezikun e mundshëm. Kjo sjellje nxitej nga fakti që këto firma më parë sponsorizonin partitë politike dhe fushatat e tyre, kështu që, partitë politike ishin, vetë, duke përfituar prej tyre. Duke rezultuar në mosbindjen e paralajmërimeve

⁷¹ B. Fevziu, po aty, fq. 281

⁷² Po aty, fq. 283

që vinin nga organizatat ndërkombëtare, të tilla si FMN dhe Banka Botërore. Ishte pikërisht fillimi i muajit janar i vitit 1997, kur filloi falimentimi i shumicës së firmave piramidale, duke qenë të pafuqishëm për ti shlyer detyrimet ndaj qytetarëve, ato morën me vete edhe paratë dhe huazimet e tyre. Situata e krijuar nxiti protesta të qytetarëve, të cilët akuzonin qeverinë për humbjen e parave dhe kërkonin të kthehen investimet e tyre. Trazirat filluan në Vlorë dhe Tiranë, e më pastaj u zgjeruan edhe në qytetet tjera të vendit: në Berat, Shkodër, Korçë, Gjirokastër etj.

Me kalimin e kohës situata po tensionohej më shumë dhe protestat u kthyen në të dhunshme, ku përleshjet e qytetarëve me forcat e rendit rezultuan me shumë të vrarë dhe të lënduar nga të dyja palët. Deri në mars të vitit 1991, situata eskaloj deri në atë masë, sa që pushteti në rajonin nga Vlora deri në Sarandë nuk kishte autoritet, dhe ky territor nuk kontrollohej nga shteti. Partitë opozitare, u bënë bashkë me përfaqësues të ish - të burgosurve politik të regjimit komunist për të krijuar “Forumin për Demokraci”, që paraqiste një aleancë antiqeveritare që akuzonte politikën e gabuara të qeverisë për gjendjen anarkike në të cilën gjendej vendi dhe kërkonin zëvendësimin e qeverisë me një qeveri teknike dhe zhvillimin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Në këto rrethana, Presidenti Berisha u detyrua të shpall gjendje të jashtëzakonshme, Qeveria Meksi ra, ndërsa Berisha në limitet e fundit të kushtetutës në 3 Mars të vitit 1993 u rizgjodh President i Republikës, akt i cili shtoi edhe më shumë pakënaqësinë të opozitës dhe të popullit, që kërkonin largimin e Berishës nga pushteti.

Po atë muaj, me ndihmën dhe nën vëzhgimin e OSBE-së, udhëheqësit e të gjitha partive politike shqiptare shprehën gatishmërinë për të arritur marrëveshje e cila do të nxirrte shtetin nga situata e rëndë në të cilën ndodhej. *Ajo parashikoi ngritjen e Qeverisë së Pajtimit Kombëtar të kryesuar nga PS-ja, me ministër të brendshëm nga PD-ja, rikthimin e PS-së në Parlament, rikthimin e autoritetit të shtetit, amnisti të përgjithshme dhe të përhershme për ata që qenë përfshirë në këto ngjarje deri në datën 9 mars dhe zhvillimin e zgjedhjeve të parakohshme brenda fundit të muajit qershor.*⁷³ Kryesuesi i Qeverisë së Pajtimit kombëtar u zgjodh Bashkim Fino, dhe me ardhjen e tij në pushtet, ai së bashku me presidentin Berisha, në pamundësi për të siguruar rendin publik kërkuan ndihmë nga faktori ndërkombëtar. OKB-ja iu përgjigj kësaj

⁷³ Po aty, fq. 288

kërkese dhe dërgoi misionin paqeruajtës të quajtur “ALBA”, i përbërë prej 7000 ushtarëve shumëkombësh, i cili u drejtua nga Italia dhe qëndroi në Shqipëri deri më gusht të vitit 1997.

Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të qershorit të vitit 1997, PS-ja dhe partnerët e saj të koalicionit korrën një fitore të madhe, po atë ditë paralelisht u mbajt edhe referendumi për formën e regjimit. Në periudhën pasuese Rexhep Meidani, sekretari i përgjithshëm i PS-së u zgjodh President i Republikës, ai e mandatoi si Kryeministër Fatos Nanon, i cili krijoi qeverinë e re të koalicionit së bashku me PSD-në dhe PAD-në.

2.6 Periudha e stabilizimit dhe procesi i integritimit në strukturat Euro - Atlantike

Me ardhjen në pushtet, Partia Socialiste trashëgoi edhe shumë çështje të pazgjidhura dhe përballëj me detyra shumë të rëndësishme që do të kthenin shtetin shqiptar në normalitet dhe do të rivendosnin rendin dhe sundimin e ligjit. Në mes tjerash, më të rëndësishmet ishin rimëkëmbja e ekonomisë si dhe hartimi dhe miratimi i kushtetutës. *Situata politike që ende e tensionuar, dhe ajo pati shumë ulje-ngritje deri në 12 shtator të 1998-ës, kur përpara selisë së PD-së u vra deputeti dhe ish-kryetari i parë i saj, Azem Hajdari.*⁷⁴ Kjo ngjarje, destabilizoi sërish situatën në vend, PD-ja akuzoi partinë në pushtet dhe shpërthyen demonstratat e dhunshme, nga të cilat Kryeministri Nano u detyrua të largohej nga shteti, dhe u qetësuan vetëm me ndërhyrjen e ndërkombëtarëve.

Trazirat e muajit shtator ishin të fundit që pasuan ato të vitit 1997, por njëkohësisht shënuan edhe humbjen politike të Fatos Nanos, të cilin PS-ja rimandatoi për kryeministër, por ai kurrë nuk pati sukses në ngritjen e qeverisë. Në vend të tij, u ngarkua Pandeli Majko, sekretari i përgjithshëm i PS-së, me zëvendës Ilir Metën. *Më 22 nëntor shqiptarët votuan në një referendum për Kushtetutën dhe në datën 28 nëntor të 1998-ës, Kushtetuta e re e Republikës së Shqipërisë hyri në fuqi.*⁷⁵ Kjo konsiderohej një prej sukseseve më të mëdha të kësaj qeverie, e cila pas një periudhe të gjatë pune, e mbushur me shumë debate dhe përplasje politike arriti që të organizoj një referendum kredibil dhe demokratik, ku populli shqiptar shprehu lirshëm

⁷⁴ Po aty, fq. 293

⁷⁵ Po aty, fq. 295

vullnetin e tij politik. Në Kushtetutën e re Shqipëria cilësohej republikë Parlamentare, shtet unitar dhe i pandashëm⁷⁶ dhe ajo zëvendësoi Ligjin mbi Dispozitat Kryesore Kushtetuese të vitit 1991.

Pas vitit 1997, e sidomos nga viti 2000, vërehej një dëshirë e madhe nga ana e politikës zyrtare shqiptare për të qenë pjesë e bashkësisë ndërkombëtare, ku edhe pse realisht ishte shumë larg, u hodhën hapat e para serioze në drejtim të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO dhe Bashkimin Evropian. Gjatë kësaj periudhe, ndodhën disa ngjarje të rëndësishme në aspekt të dialogut politik Shqipëri – BE, ku në vitin 1998 BE-ja u dha Shqipërisë dhe vendeve tjera të Ballkanit perëndimor tarifa asimetrike preferenciale për rritjen e bashkëpunimit ekonomik me shtetet anëtare. *Në maj të vitit 1999, Bashkimi Evropian miratoi një iniciativë të re për 5 vende të Ballkanit: Shqipëria, ish – Republika Jugosllave e Maqedonisë, Kroacia, Bosnjë-Hercegovina dhe Republika Federale Jugosllave, të quajtur Procesi i Stabilizim – Asociimit (PSA).*⁷⁷ Kjo iniciativë paraqiste një hap përpara për rajonin në përgjithësi, dhe parashihte fillimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe përbashkët në të lehtë të krizave ekonomiko – politike në të cilat gjindeshin këto shtete, me qëllim stabilizimin, demokratizimin e rajonit dhe krijimin e një tregu të përbashkët. Kuptohet që, shkaku i përgatitjes së pamjaftueshme, Shqipëria dështoi disa herë në përpjekjet e saj për të afirmuar statusin e saj në raport me BE-në, ndërsa një moment shumë i rëndësishëm për afrimin e rajonit të Ballkanit Perëndimor me BE-në ka qenë viti 2003, ku u organizua Samiti i Selanikut, në të cilin u hartua dhe u miratua dokumenti “Agjenda e Selanikut për Ballkanin Perëndimor – Drejt Integritimit Evropian”.

Natyrisht, procesi i integritimit varej nga performanca individuale e secilit prej vendeve të Ballkanit Perëndimor në drejtim të reformave institucionale dhe ekonomike, demokratizimit të shoqërisë, respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut, sundimit të ligjit, depolitizimit dhe pavarësisë së pushtetit gjyqësor, etj. *Shqipërisë iu deshën tre vjet negociata derisa, në shkurt të vitit 2006, në Tiranë të siglohej Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit dhe më 16 qershor 2006, në Luksemburg, në Këshillin e Çështjeve të Përgjithshme dhe Marrëdhëniet me Jashtë, të nënshkruhej Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit dhe Marrëveshja e Përkohshme për Tregtinë*

⁷⁶ Po aty: <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2018/10/Tranzicioni-A.-Nexhipi.pdf>, fq. 97

⁷⁷ Po aty, fq. 146

*dhe Bashkëpunimin Tregtar.*⁷⁸ Me fjalë të tjera, negociatat e Shqipërisë me BE-në për MSA-në zgjatën tre herë më shumë se negociata e BE-së me Kroacinë dhe Maqedoninë, shkaku i reformimit të ngadaltë, veçanërisht në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Në Korrik të vitit 2007 hyri në fuqi Marrëveshja e Re e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) dhe Shqipëria bashkë me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimore dhe Moldavinë nënshkruan dhe ratifikuan këtë marrëveshje. Dy vite më pas, Marrëveshja e Stabilizim Asociimit u ratifikua nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së dhe më 1 prill 2009 ajo hyri në fuqi. Më 28 prill pa atë vit, Shqipëria zyrtarisht paraqiti aplikimin e saj për anëtarësim në BE, ndërsa në vitin 2010 në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të Brendshëm dhe të drejtësisë së BE-së, u morr vendimi për liberalizimin e regjimit të vizave për Shqipërinë me vendet e Zonës Shengen, i cili hyri në fuqi më 15 dhjetor të atij viti.

Krahas aspiratave dhe procesit të zhvillimit të negociatave për anëtarësim në BE, Shqipëria kishte edhe një sfidë tjetër shumë të rëndësishme para vetes, dhe kjo ishte marrja e ftesës për anëtarësim në NATO. Në prill të vitit 2008, me ndikimin dhe lobimin e fortë amerikan, në Samitin e Bukureshtit u vendos që Shqipëria dhe Kroacia të merrnin ftesë për në NATO. *Një vit më pas, në Samitin e Strazburg – Kiehl, në prill të 2009-ës, Shqipëria u bë edhe anëtare me të drejta të plota e NATOS-s. Ishte integrimi i parë real i Shqipërisë në një strukturë evropiane dhe më gjerë.*⁷⁹

3. Procesi i tranzicionit dhe ndërtimi i institucioneve shtetërore

3.1 Aspekte historike dhe teorike të tranzicionit

Gjatë viteve 1970 e 1980 mbi tridhjetë vende kaluan nga sistemet politike autoritare te sistemet demokratike. Për këtë dallgë tranzicioni pati një varg arsyes që e shkaktuan.⁸⁰ Në mes tjerash, Samuel P. Huntington përmend zhvillimin ekonomik, si faktor themelor i cili i ka përfutur këto ndryshime politike. Sipas tij, politikat e veprimet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e fuqive kryesore të Evropës Perëndimore dhe institucionet ndërkombëtare poashtu

⁷⁸ Po aty, fq. 150

⁷⁹ B. Fevziu, po aty, fq. 308

⁸⁰ Samuel P. Huntington, *Përplasja e Qytetërimeve dhe Ribërja e Rendit Botëror*, Logos-A, Shkup, 2017, fq. 217

kanë ndihmuar në mënyrë plotësuese që të vendosej demokracia në Spanjë e Portugali, në shumë shtete të Amerikës Latine, në Filipine, Korenë e Jugut dhe Evropë.

Është me rëndësi të potencojmë faktin që shoqëria njerëzore paraqet një tërësi dinamike, e cila zhvillohet dhe pëson ndryshime në mënyrë të vazhdueshme. Një ndër faktorët më të rëndësishëm, që ndikojnë në këtë proces janë padyshim ndryshimet politike. Nacion, i cili në esencë nënkupton ndryshime të tërësishme apo të disa elementeve të një sistemi apo strukture politike, brenda një shteti të caktuar. *Sipas David Easton-it ndryshimi politik është çështje e mundësisë apo pamundësisë për mbijetimin e sistemit përballë tensionimit dhe humbjeve që i përjeton.*⁸¹ Në këtë drejtim mund të themi që tranzicioni është një proces brenda të cilit ngërthehen ndryshime sociale, politike, ekonomike dhe kulturore, nocion për të cilin shumë studiues kanë shfaqur interes dhe kanë dhënë mendime të ndryshme lidhur me të.

Procesi i tranzicionit paraqet një ndryshim shoqëror, i cili në radhë të parë paraqet ndryshim politik, që prek çdo pore të shoqërisë bashkëkohore.⁸² Proces i transformimit, nëpërmjet të cilit kaluan edhe shtetet e Evropës Qendrore dhe Juglindore, të cilët gjatë përmbysjes së regjimit komunist kaluan nga sistemi njëpartiak totalitar në atë pluralist dhe demokratik. Për më tepër, një tjetër përkufizim e paraqet tranzicionin si: *Proces të ndryshimeve radikale në strukturën shoqërore, me çka, duke ndryshuar strukturën ekonomike të shoqërisë për një kohë të shkurtër ndryshohet pozita materiale dhe statusi social i njeriut.*⁸³

3.2 Tranzicioni në shtetet ish – komuniste

Sipas Samuel P. Huntington, historikisht, regjimet jodemokratike apo autoritare kanë kaluar procesin e tranzicionit në periudha dhe faza të ndryshme, që ai i quan “Valë” dhe bën ndarjen e tyre në tre kategori. Në valën e parë, janë demokratizuar kryesisht monarkitë absolute, aristokracitë feudale të qëndrueshme dhe shtetet pasuese të perandorive kontinentale. Në valën e dytë u përfshinë shtetet fashiste, kolonitë dhe diktaturat ushtarake personale, të cilët paraprakisht kanë pasur ndonjë përvojë demokratike. *Regjimet që lëvizën drejt demokracisë në*

⁸¹ Jonuz Abdullai, *Politika dhe Politikat Publike*, Arbëria Design, Tetovë, 2010, fq. 164

⁸² Jonuz Abdullai, *Ndryshimet Sociale dhe Tranzicioni*, CRPA & Arbëria Design, Tetovë, 2008, fq. 20

⁸³ J. Abdullai, po aty, fq.34

*valën e tretë, në përgjithësi futen në tre grupe: sistemet njëpartiake, regjimet ushtarake dhe diktaturat personale.*⁸⁴

Në valën e tretë të demokratizimit të regjimeve, e në veçanti në grupin e sistemeve njëpartiake u përfshinë vendet komuniste, të cilët shpesh arritën një nivel të lartë të institucionalizimit politik. Proceset e tranzicionit në këto vende janë zhvilluar kryesisht nga brenda, por kanë pasur influencë të rëndësishme edhe nga jashtë, ndërkaq për të kuptuar mënyrën se si ato u vendosen duhet të analizojmë raportin ndërmjet grupeve qeverisëse dhe opozitare, si burime të demokratizimit. Në këtë rast, ekzistojnë tre lloje të gjëra të proceseve: *Transformimi (apo sipas frazës së Linzit, reforma) ndodhte kur elitat në pushtet merrnin drejtimin për të sjellë demokracinë. Zëvendësimi (ruptura e Linzit) ndodhte kur grupet opozitare merrnin drejtimin për të sjellë demokracinë, kurse regjimi autoritarist bie ose përmbysset. Ajo që quhet transferim apo “ruptforma” ndodhte kur demokratizimi ishte kryesisht rezultat i aksionit të përbashkët të qeverisë dhe grupeve opozitare.*⁸⁵

Procesi i transformimit dhe ai i transferimit, me përjashtim të disa vendeve, karakterizuan tranzicionet e valës së tretë, të cilët kaluan nga sistemet njëpartiake komuniste në ato demokratike. Këto procese politike ishin mjaft komplekse, në të cilat përfshiheshin grupe të ndryshme, që luftonin për pushtet, që luftonin pro e kundër demokracisë dhe reformave, pro dhe kundër liberalizimit, si dhe për qëllime tjera.

Reformat politike dhe ekonomike, të cilat u ndërmorën në shtetet komuniste të Evropës Qendrore dhe Juglindore në fund të viteve të '80 të shekullit XX, dhe që filluan me ardhjen e Mihail Gorbaçovit në krye të BRSS-së, ndërsa kulminuan me rrëzimin e Murit të Berlinit në nëntor të vitit 1989, padyshim që e trasuan dhe lehtësuan rrugën e demokratizimit dhe transformimit shoqëror. Fillimisht, qëllimi i këtyre ndryshimeve ishte reformimi i vetë sistemit socialist, por kjo u dëshmuar si e pamundur. Popullata e këtyre vendeve, në mënyrë kategorike e refuzuan këtë fenomen dhe kërkuan përmbysjen e tërësishme të sistemit socialist, që rezultoi me transformimin e sistemit politik dhe ekonomik, i cili ndikoi në ndryshimet rrënjësore të shtetit dhe shoqërisë.

⁸⁴ Samuel P. Huntington, *Vala e Tretë: Demokratizimi në Fund të Shekullit të Njëzetë*, AIIS, Tiranë, 2011, fq. 131

⁸⁵ Po aty, fq. 135

Kultura e re politike e shoqërive postkomuniste është një produkt procesesh, që po zhvillohen, të paktën në tre dimensione:

1. Në dimensionin universal; ku kultura politike shoqërohet me simptomat dhe dukuritë tipike për çdo kthesë me karakter revolucionar,
2. Në dimensionin rajonal; ku element i saj integral janë ndryshimet karakteristike, për ato shoqëri, të cilat gjenden në rrugën nga komunizmi për në rendin demokratik e të ekonomisë së tregut,
3. Në dimensionin e “rrugës së veçantë”; ku historia, kushtet gjeopolitike dhe struktura kombëtare e shteteve posttotalitare ndikojnë në atë, që sfidat, para të cilave këto shtete gjenden, të kenë një karakter të diferencuar dhe një rreze veprimi të ndryshme.⁸⁶

Procesi i lindjes dhe i zhvillimit të kulturës së re politike në vendet postkomuniste të Evropës, u shoqërua me shumë gabime dhe paqartësi të cilat nuk mund të parashikoheshin dhe faza e ndryshimeve dinamike u pasua nga një stanjacion, përballë sfidave dhe implementimit të reformave gjysmake dhe jo efektive. Kultura politike e shoqërive në tranzicion karakterizohet nga kontradikta të shumta, dhe këto lindin kryesisht nga nevoja për të reformuar njëkohësisht të gjitha fushat jetësore, duke u shfaqur si një faktor destabilizues. Konfliktet dhe problemet kryesore në këto vende janë rezultat i sjelljes së elitave politike të cilat realizojnë programe reformash në kundërshtim me dëshirat dhe interesat e shumicës, të cilat krijojnë pakënaqësi, pabarazi dhe përçarje në shoqëri, dhe duke qenë në kundërshtim të plotë me të gjitha idealet dhe vlerat demokratike, për të cilat populli ka luftuar gjatë përmbysjes së regjimeve komuniste.

3.3 Procesi i privatizimit, ndërtimi i institucioneve shtetërore dhe sfidat e tjera të tranzicionit

Gjatë periudhës së tranzicionit dhe në rrugëtimin drejt demokratizimit dhe të ardhmes së panjohur, shtetet ish-komuniste u ballafaquan me shumë sfida dhe probleme, sidomos gjatë procesit të ngritjes së strukturave të ekonomisë së tregut dhe të institucioneve demokratike. Nga procesi i transformimit radikal, në këto shtete lindën edhe shumë probleme, të cilat sollën kriza të njëpasnjëshme dhe destabilizuan gjendjen politiko – ekonomike të tyre. Problemet më

⁸⁶ Verner Vajdenfeld, *Demokracia dhe Ekonomia e Tregut në Evropën Lindore: Strategji për Evropën*, (Ana Volf-Poveska, *Kultura politike në shoqëritë postkomuniste*), Argeta LMG & Shtëpia e Librit e Fondacionit Soros, Tiranë, 1999, fq. 33-34

të shpeshta me të cilat këto shtete u ballafaquan ishin: rënia e prodhimit industrial, papunësia në rritje, si dhe inflacioni i lartë. Gjithë këto elemente, paralajmëruan faktin që procesi i tranzicionit do të zgjasë shumë më tepër dhe do të jetë shumë më i kushtueshëm nga sa ishte menduar fillimisht.

*Rreziku i varfërimit social ecën bashkë me problemet e konsolidimit të institucioneve të reja politike dhe ato të sistemit administrativ veprues. Të gjithë shoqëritë postkomuniste vuajnë nga mungesa e një elite administrative dhe politike të formuar.*⁸⁷ Kjo vjen si rezultat nga mbingarkimi i forcave demokratike me detyrat për të krijuar baza institucionale të afta dhe funksionale për të shërbyer si themel për veprimet politike. Zvarritja e procesit të reformave dhe implementimi i tyre i pjesshëm, problemet dhe kostot e tranzicionit ekonomik rrisin në të njëjtën kohë edhe pakënaqësinë ndaj proceseve politike të demokracisë parlamentare, duke i çuar qytetarët të ndjehen të zhgënjyer, pasi që liria e re nuk u ofron atyre atë që ata kanë pritur prej saj.

*Gjendja politike dhe ekonomike, në disa shtete të Evropës Qendrore dhe Lindore u keqësua edhe më tepër pas vendosjes së masave preventive nëpërmjet të së ashtuquajturës “shok terapi” (shock therapy).*⁸⁸ Kjo ishte diagnoza e ekonomistit amerikan Xhefri Saks, që ai e propozonte për shtetet ish - komuniste që kalonin kriza gjatë procesit të tranzicionit dhe që në esencë do të thotë, ato shtete të cilët do të kalojnë këtë trajtim do të shpëtojnë, ndërsa shtetet tjera të cilët nuk do të kenë qëndrueshmëri dhe gatishmëri të ballafaqohen me atë, do të falimentojnë ose do të copëtohen.

*Kultura politike e shoqërive që braktisën komunizmin është e mbushur plot me paradokse, të cilat lidhen me karakterin edhe e thelbin e proceseve të tranzicionit. Ndërmjet të tjerave edhe për faktin se çdo vendim i marrë në kohë përmbysjesh dhe krizash të përgjithshme, shkakton lindjen e problemeve shoqëruese.*⁸⁹ Në rastin konkret e kemi fjalën për procesin e privatizimit të pronës shtetërore, proces i cili u zhvillua në mënyrë paralele me tranzicionin dhe nga i cili u paraqitën shumë keqpërdorime dhe dukuri devijante në të gjitha shtetet e Evropës Juglindore.

⁸⁷ V. Vajdenfeld, (Verner Vajdenfeld, *Përgjegjësia e Perëndimit për ndryshimet në Evropën Qendrore dhe Lindore*), po aty, fq. 17

⁸⁸ J. Abdullahi, po aty, fq.23

⁸⁹ V. Vajdenfeld, (Ana Volf-Poveska, *Kultura politike në shoqëritë postkomuniste*), po aty, fq. 42

Në mesin e studiuesve ekziston një ballafaqim të ideve rreth këtij fenomeni, njëri grup e arsyetojnë procesin e privatizimit, duke u mbështetur në konceptin që prona private është një produkt i liberalizimit ekonomik dhe është pjesë përbërëse e sistemit kapitalist. Megjithatë, grupi i dytë i studiuesve janë kritik ndaj këtij procesi, duke e potencuar rrezikun nga implementimi i përshpejtuar dhe nga mospasja e privatizimit.

Ashtu siç e cekëm edhe më herët, ekonomisti i njohur amerikan Xhefri Saks, në lidhje me procesin e privatizimit të shtetesh ish-komuniste preferonte të praktikohesh e ashtuquajtura “shok terapi”, që nënkuptonte privatizim të shpejtë dhe pa kompromis, pavarësisht nga pasojat. Megjithatë, qëndrimi i ekonomistit hungarez Kornaj ishte krejtësisht i kundërt, duke potencuar rëndësinë e rolit të shtetit që duhej të ketë në procesin e privatizimit, duke qenë të kujdesshëm me ndarjen e pronës shtetërore në duart e pronarëve të rinj.

Procesi i tranzicionit dhe privatizimi në shtetesh ish-komuniste solli rritje të papunësisë, ulje të standardit jetësorë, dhe pasurimin e oligarkëve politik ose një grupi të vogël njerëzish që i blenë ndërmarrjet me një çmim shumë të lirë ose pa para. Ky fenomen negativ i plaçkitjes apo grabitjes së kapitalit shoqëror ishte prezent në përgjithësi në të gjitha shtetesh ish – komuniste të cilat kaluan procesin e privatizimit, mirëpo duhet potencuar faktin që në mesin e tyre kishte edhe të tillë që kaluan procesin e privatizimit me sukses. Një ndër ato shtete është Sllovenia, në të cilën procesi i privatizimit filloi të marrë hovin në vitin 1993, dhe e cila *ishte e para dhe e vetmja nga republikat e ish – Jugosllavisë që formoi fondet investuese për përkrahjen e privatizimit të pronës shoqërore. Këto fonde, në Slloveni, ishin nën kontrollin e Parlamentit dhe Qeverisë.*⁹⁰

Një tjetër dukuri shoqërore negative, e shtetesh në tranzicion është korrupsioni, i cili në përgjithësi haset shumë me herët edhe në periudhën kur këto shtete udhëhiqeshin nga qeveritë komuniste por edhe të shtetesh me traditë të gjatë demokratike. Dukuritë negative si korrupsioni dhe grabitja e pronës shtetërore u paraqitën dhe gjetën tokë pjellore për zhvillim në vendet ish – komuniste, si pasojë e shumë faktorëve. Gjendja e rëndë ekonomiko - sociale, problemet e grumbulluara politike, dështimi në krijimin e institucioneve demokratike të qëndrueshme, administrata e stërngarkuar, e politizuar dhe jo efikase, politizimi i pushtetit

⁹⁰ J. Abdullai, po aty, fq.29

gjyqësor, mos transparenca dhe mos llogaridhënia e institucioneve publike, janë vetëm një pjesë e faktorëve që sollën këto dukuri shoqërore devijante dhe që çuan në procesin e tranzicionit të stërzgatur dhe të përcjellë me shumë ulje dhe ngritje të këtyre shteteve.

4. Roli i Shoqërisë Civile në demokratizimin e shoqërisë

4.1 Në përgjithësi mbi Shoqërinë Civile dhe liritë dhe të drejtat e njeriut

Një prej attributeve më të rëndësishme të demokracisë është sigurimi i lirive dhe të drejtave të njeriut, i cili në shoqërinë bashkëkohore është parakushti themelor për vendet që dëshirojnë krijimin e shoqërisë civile. *Liritë dhe të drejtat e qytetarit dhe sigurimi i mekanizmave kushtetuese, për mbrojtjen e tyre janë tregues i mirëfilltë i demokratizimit të shoqërisë.*⁹¹ Në shtetet demokratike, të gjithë qytetarët janë të barabartë para ligjit dhe të gjithë gëzojnë të njëjtat liri dhe të drejta, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre kombëtare, fetare, gjinore, pozitën shoqërore, profesionin etj. Për të siguruar një shoqëri civile aktive dhe për të fuqizuar rolin e qytetarit në shoqëri, rëndësi të posaçme kanë të drejtat dhe liritë politike individuale dhe kolektive, të cilët janë: liria e të menduarit dhe e të shprehurit, liria e bashkimit politik, e organizimit, e zgjedhjes, e informimit, të drejtat e grupeve etnike, e minoriteteve etj.

*Shoqëria civile, nënkupton strukturat jo shtetërore dhe jo qeveritare, të cilat reflektojnë mendimin e lirë dhe të pavarur të qytetarëve, si dhe artikulin e interesave të tyre, në mënyrë të lirë.*⁹² Ky koncept bazohet në të drejtën themelore të qytetarëve, që të organizohen dhe të themelojnë organizata apo shoqata qytetare dhe në mënyrë kolektive të ushtrojnë veprimtarinë e tyre, duke ndikuar dhe duke bërë presion ndaj institucioneve dhe qendrave politike, për artikulin e kërkesave apo nevojave të tyre. Në parim, shoqëria civile mbron të drejtat universale themelore dhe interesat e individit, por edhe të grupeve të caktuara shoqërore, të cilat shpeshherë mund të jenë të marginalizuara apo të diskriminuara në baza të ndryshme, dhe angazhohet në drejtim të artikulimit dhe realizimit të tyre nëpërmjet rrugës institucionale.

⁹¹ A. Bajrami, po aty, fq. 26

⁹² Po aty, fq. 58

Në konceptin e sotëm, vlerësohet shoqëria civile, por edhe shtetit i kërkohet të luajë rolin e tij në promovimin, nxitjen, përkrahjen dhe mbështetjen e veprimtarisë së strukturave të shoqërisë civile, pa tentuar për t'i kontrolluar ato, madje duke e trajtuar këtë veprimtari si një oponencë konstruktive, emancipuese e qeverisje – korrigjuese.⁹³ Qeverisjen e mirë në shoqëritë demokratike, e karakterizojnë bashkëpunimi dhe partneriteti ndërmjet aktorëve dhe institucioneve të ndryshme brenda shtetit në tërësi, siç janë: parlamenti, qeveria – institucionet shtetërore në rrafshin qendror apo lokal, pushteti gjyqësor, sektori privat dhe padyshim shoqëria civile e përfaqësuar nga Organizatat Joqeveritare.

Në teorinë e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Organizatat Joqeveritare të mëdha dhe më me ndikim në aspekt global, hynë në grupin e aktorëve jo shtetëror, më konkretisht si aktorë përtej-kombëtarë dhe njihen gjithnjë e më shumë në OKB si aktorë të ligjshëm, krahas shteteve, edhe pse nuk janë të barabartë me ta. Këto organizata kanë burime të mëdha financiare dhe vazhdimisht ushtrojnë aktivitetin e tyre, duke bashkëpunuar dhe ndërvepruar me shtetet, kompanitë shumëkombëshe si dhe me organizata tjera joqeveritare. Fushëveprimi i tyre është i gjerë, kështu që qëllimet e tyre mund të jenë: politike, ekonomike, humanitare, teknike, religjioze etj. *Shembuj organizatash të tilla janë Kisha Katolike, Green Peace, Komiteti Olimpik Ndërkombëtar dhe Shoqata Ndërkombëtare e Studimeve.*⁹⁴ Përpos këtyre, ekzistojnë edhe Organizatat ndërqeveritare, anëtarë e të cilave janë qeveritë kombëtare dhe në të cilat shtetet shpesh veprojnë brenda ose në rrethanat e tyre. E tillë është OKB dhe agjencitë e saj si dhe institucionet ekonomike ndërkombëtare si Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar. Në përgjithësi, organizatat joqeveritare dhe ato ndërqeveritare konsiderohen si organizata ndërkombëtare, të cilat lehtësojnë bashkëpunimin dhe koordinimin midis vendeve anëtare përtej kufijve shtetërore, duke mundësuar integrimin e politikës dhe ekonomisë botërore.

4.2 Zhvillimi i Shoqërisë Civile në shtetet ish-komuniste

Shoqëria civile paraqet elementin kyç dhe të pashmangshëm, që është pjesë përbërëse e shoqërive bashkëkohore, sistemit demokratik dhe ekonomisë së tregut në përgjithësi. *Përvoja*

⁹³ Rexhep Meidani, *Mbi Qeverisjen, Pjesa e parë*, Botimet Dudaj, Tiranë, 2009, fq. 151

⁹⁴ J. S. Goldstein, po aty, fq. 28

*perëndimore ka treguar se institucionet demokratike, bindjet liberale dhe një ekonomi tregu mund të konsolidohen vetëm atje, ku një shoqëri e tillë qytetare ka shekuj që ekziston.*⁹⁵ Elementet e një shoqërie të tillë civile të zhvilluar kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në përmbysjen e regjimeve komuniste në Evropën Qendrore dhe Juglindore. Në ato shoqëri, ku këto elemente ishin më të konsoliduara, procesi i ndryshimeve dhe tranzicioni u zhvillua relativisht mirë dhe në mënyrë paqësore. Ndërkaq, te ato vende ku ato ishin të dobëta ose inekzistente, procesi i tranzicionit u përcjell me sfida dhe probleme të shumta, që sollën në pikëpyetje zhvillimin e mëtejshëm dhe qëndrueshmërinë e vet sistemit demokratik. Rastet konkrete të shteteve si Polonia, ku Solidarnost kishte lidhje të forta me kishën katolike, “Charta 77” në Çekosllovakia dhe rrjeti që lindi si pasojë e aktiviteteve të tyre, pastaj krijimi i të ashtuquajturës zonë ekonomike të lirë në Hungarinë e Janosh Kadarit, janë shembuj se si tranzicioni dhe demokratizimi në këto shoqëri u zhvillua në mënyrë pozitive dhe të qetë. *Përkundrazi, zhvillimet problematike në vendet si Rumania dhe Bullgaria, për të mos folur më për Shqipërinë, mund të lidhen drejtpërdrejt me traditat e mangëta të një shoqërie qytetare në këto vende.*⁹⁶

Shtetet e Ballkanit Perëndimor, aktualisht ende po ballafaqohen me angazhim të ulët të qytetarëve, kapacitete dhe legjitimitet të dobët të Organizatave Jo Qeveritare (OJQ), korrupsionin, varfërinë, papunësinë, pabarazinë gjinore, shkeljen e të drejtave themelore të njeriut, mosrespektimin e të drejtave të punëtorit, dhe mosbesimi i qytetarëve ndaj institucioneve shtetërore. Të gjithë këto përbëjnë kërcënim për zhvillimin e demokracisë dhe stabilitetin në rajon, poashtu ato paraqesin komponente shumë të rëndësishme për krijimin e shoqërive funksionale demokratike, ku do të respektohen liritë dhe të drejtat e njeriut. *Ndërsa OJQ-të kanë qenë të pranishme e në zhvillim që nga vitet '50, numri i vogël i tyre dhe fondet e kufizuara fillimisht i penguan ata që të kenë një ndikim të madh. Megjithatë, brenda disa dekadave të fundit, numri dhe ndikimi i tyre janë rritur në shkallë të lartë.*⁹⁷

⁹⁵ V. Vajdenfeld, (Shlomo Avineri, *Shanset dhe pengesat në rrugën e shoqërisë qytetare në Evropën Qendrore dhe Lindore*), po aty, fq. 51

⁹⁶ V. Vajdenfeld, po aty, fq. 51

⁹⁷ Etem Aziri, Nazmi Maliqi, Ali Pajaziti, *Proceset e Integritetit Euroatlantik dhe Republika e Maqedonisë*, Qendra për Hulumtime në Administratën Publike, UEJL - Tetovë dhe Friedrich Ebert Stiftung - Shkup, Tetovë, 2008, fq. 236

Roli i OJQ-ve kredibile, është thelbësorë në luftën për një shpërndarje të barabartë të pushtetit, qasje në drejtësinë sociale, dhe për një shoqëri demokratike të qëndrueshme dhe solidare.

Shoqëria civile në Ballkanin Perëndimor ka forcuar pozicionin e saj dhe në krahasim me periudhën e hershme të tranzicionit ka shënuar një zhvillim të dukshëm. *OJQ-të konsultohen më shpesh sesa më parë në vendimmarrjen lokale dhe kombëtare. Ekzistojnë gjithashtu shenja pozitive të përparimit në lidhje me statusin dhe pozicionin e sektorit në tërësi dhe janë bërë disa ndryshime në legjislacion, politikë dhe buxhet, duke marrë parasysh vullnetin e qytetarëve. Kjo, kryesisht për shkak të negociatave të mëdha dhe të suksesshme, dhe presionit publik nga shoqëria civile.*⁹⁸

4.3 Shoqëria Civile në Republikën e Maqedonisë së Veriut

*Rrënjët e shoqërisë civile në Republikën e Maqedonisë së Veriut gjenden në periudhën e rilindjes kombëtare (fundi i shekullit XIX, fillimi i shekullit XX). Sidoqoftë, ngritja e këtij sektori filloi pas pavarësisë së vendit në vitin 1991, dhe veçanërisht pas miratimit të ligjit të parë për shoqatat e qytetarëve dhe fondacioneve në 1998, i cili lejonte organizatat të regjistroheshin si subjekte të pavarura për kryerjen e llojeve të ndryshme të aktiviteteve.*⁹⁹ Ndërkaq, përmirësimi i kornizës ligjore për themelimin dhe funksionimin e organizatave u bë me miratimin e Ligjit për Shoqata dhe Fondacione në vitin 2010. Sipas Nenit 3, të ligjit për Shoqata dhe Fondacione: *“Organizatë nënkupton çdo shoqatë, fondacion, lidhje si dhe çdo formë organizative të një organizate të huaj, dhe çdo formë tjetër të bashkimit, të regjistruara në përputhje me dispozitat e këtij ligji”.*¹⁰⁰

Gjatë periudhës së tranzicionit u themeluan një numër i madh i OSHC-ve, me qëllim të artikullimit të nevojave të qytetarëve dhe adresimit të çështjeve dhe sfidave sociale të asaj kohe. Ashtu siç rritej numri i tyre, u rrit edhe rëndësia dhe roli i tyre në zhvillimin e shoqërisë demokratike, impakti i tyre në proceset vendimmarëse poashtu rritej, ndërsa kontaktet e tyre

⁹⁸ Burim: https://www.palmecenter.se/wp-content/uploads/2014/03/ContextAna_2015_WESTERN-BALKANS_eng.pdf, fq. 3

⁹⁹ [https://www.nvosorabotka.gov.mk/sites/default/files/dokumenti/STRATEGY_FOR_COOPERATION_OF_THE_GOVERNMENT_WITH_THE_CIVIL_SOCIETY\(2012-2017\).pdf](https://www.nvosorabotka.gov.mk/sites/default/files/dokumenti/STRATEGY_FOR_COOPERATION_OF_THE_GOVERNMENT_WITH_THE_CIVIL_SOCIETY(2012-2017).pdf), fq. 19

¹⁰⁰ <https://www.nvosorabotka.gov.mk/sites/default/files/ZZFprecistentekst2016.pdf>, (Закон за Здруженија и Фондации, Редакциски пречистен текст), fq. 1/30

me organizatat e ngjashme jashtë shtetit, e ngritnin pozitën dhe imazhin e vendit në rajon e më gjerë. Numri i organizatave në vendin tonë është rritur ndjeshëm, kështu që numri i organizatave dhe fondacioneve të regjistruara deri më vitin 2010, ishte 11457. Ndërsa, me procesin e ri-regjistrimit të tyre, bazuar në Ligjin për Shoqata dhe Fondacione të vitit 2010, numri i organizatave të ri-regjistruara deri në mars 2012, arriti në 3,372.

*Në vitin 2007, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi Strategjinë e parë për bashkëpunim të qeverisë me shoqërinë civile dhe Planin e veprimit 2007-2011.*¹⁰¹ Në këtë strategji, qeveria theksoi rëndësinë e shoqërisë civile në përgjithësi dhe vendosi bazat e bashkëpunimit të mëtejshëm me Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC). Atje, poashtu parashihej vendosja e një qasjeje sistematike për forcimin e kushteve themelore për zhvillimin më të shpejtë dhe më efikas të këtij sektori. Kjo strategji, u pasua edhe nga miratimi i dokumenteve tjera të ngjashme, siç janë: Strategjia për bashkëpunim të qeverisë me shoqërinë civile 2012-2017 dhe ajo aktualja, Strategjia për bashkëpunim të qeverisë me shoqërinë civile dhe Plani i veprimit 2018-2020.

Që nga viti 1992, OSHC-të në vendin tonë, për realizimin e aktiviteteve të tyre, kanë qenë të mbështetur nga ndihmat e donatorëve të jashtëm, nëpërmjet programeve të ndryshme. Në këtë rast do të përmendim vetëm disa prej donatorëve më të rëndësishëm, edhe atë:

- *Unioni Evropian*, me mbështetjen e dhënë kryesisht nëpërmjet programit të IPA fondeve (Instrument for Pre – Accession Assistance), fondit “Instrumenti Evropian për Demokracinë dhe të Drejtat e Njeriut” dhe Erasmus + projekteve.
- *USAID (United States Agency for International Development)*, nga viti 1993 në mënyrë të vazhdueshme mbështetin shoqërinë civile me financim të projekteve dhe aktiviteteve të OSHC-ve në fusha të ndryshme, kryesisht nëpërmjet Zyrës për Demokraci dhe Qeverisje Lokale.
- *Agjensia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim*, e përfaqësuar nga Zyra e saj për Bashkëpunim në Maqedoninë e Veriut – SDC, nëpërmjet Programit për Mbështetje të

¹⁰¹ Po aty:

[https://www.nvosorabotka.gov.mk/sites/default/files/dokumenti/STRATEGY_FOR_COOPERATION_OF_THE_GOVERNMENT_WITH_THE_CIVIL_SOCIETY\(2012-2017\).pdf](https://www.nvosorabotka.gov.mk/sites/default/files/dokumenti/STRATEGY_FOR_COOPERATION_OF_THE_GOVERNMENT_WITH_THE_CIVIL_SOCIETY(2012-2017).pdf), fq. 9

Shoqërisë Civile - CIVICA Mobilitas, *me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të OSHC-ve dhe qëndrueshmërinë e tyre.*¹⁰²

Në mesin e këtyre donatorëve të rëndësishëm, kuptohet që përfshihen edhe ambasadat e shteteve perëndimore në vend, siç janë: Ambasada e ShBA-ve në Shkup, Ambasada Britanike, e Holandës, ajo e Gjermanisë, etj. të cilat nëpërmjet fondeve të posaçme vazhdimisht kanë mbështetur OShC- të dhe zhvillimin e tërësishëm të shoqërisë civile në vend.

Një grup tjetër shumë i rëndësishëm i donatorëve të huaj, që shtrojnë fushëveprimin e tyre në vendin tonë por edhe në rajon, janë fondacionet dhe organizatat ndërkombëtare, ku bëjnë pjesë: Misioni i OSBE-së në Shkup (OSCE – Organization for Security and Co-operation in Europe) - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, UNDP (United Nations Development Program) - Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, NED (National Endowment for Democracy) - Fondi Kombëtar për Demokracinë, FOSM (Foundation Open Society - North Macedonia) – Fondacioni Shoqëri e Hapur – Maqedonia e Veriut, etj.

Këtu, do të ndalemi shkurt mbi rëndësinë dhe rolin që Fondacioni Shoqëri e Hapur – Maqedonia e Veriut – FOSM, ka luajtur në ndërtimin dhe ngritjen e shoqërisë civile, që nga pavarësimi i vendit dhe fillimi i tranzicionit. Fondacioni Shoqëri e Hapur – Maqedonia e Veriut, është themeluar në vitin 1992, si pjesë e rrjetit global të Fondacioneve të Shoqërisë se Hapur, të themeluara nga investitori dhe filantropi amerikan, Xhorxh Soros. Programi i Shoqërisë Civile, ka qenë një nga fushat kryesore të veprimtarisë së FOSM, i cili ka nxit zhvillimin e një shoqërie të hapur, vlera dhe parime qytetare përmes mbështetjes së OJQ-ve dhe iniciativave qytetare.

Në periudhën e gjatë të ekzistencës, FOSM nëpërmjet Programit të Shoqërisë Civile dhe në bashkëpunim me donatorë tjerë të huaj, kanë investuar shuma të mëdha të mjeteve financiare në mbështetje të shoqërisë civile, në nivelin lokal dhe atë kombëtar. *Mbështetja e OSHC-ve u ka mundësuar atyre që të punojnë në disa fusha: të drejtat e njeriut, praktikat demokratike, angazhimi i të rinjve, nismat ndëretnike dhe ndërkulturore, integrimi i popullatës Rome, liria e*

¹⁰² Po aty:

[https://www.nvosorabotka.gov.mk/sites/default/files/dokumenti/STRATEGY_FOR_COOPERATION_OF_THE_GOVERNMENT_WITH_THE_CIVIL_SOCIETY\(2012-2017\).pdf](https://www.nvosorabotka.gov.mk/sites/default/files/dokumenti/STRATEGY_FOR_COOPERATION_OF_THE_GOVERNMENT_WITH_THE_CIVIL_SOCIETY(2012-2017).pdf), fq. 29

*shprehjes, lufta kundër korrupsionit, transparenca e buxhetit, mbështetja e Qendrave të komunitetit, pjesëmarrja në iniciativa rajonale, etj.*¹⁰³

Me miratimin e ligjit të parë për Shoqata Civile dhe Fondacione, u hap edhe rruga për decentralizim apo de – metropolizim të fondacionit, me çka filloi edhe pavarësimi i programeve dhe projekteve. Që nga viti 2000, FOSM ka filluar mbështetjen për zhvillimin e shoqërisë civile jashtë kryeqytetit të Shkupit, duke themeluar qendra mbështetëse të OJQ-ve në 12 qytete. Pothuaj se gjithë, programet e pavarura të fondacionit, në qytete të ndryshme të vendit, kanë mbetur partnerë të fondacionit, por kanë vazhduar të ndërtojnë partneritet dhe rrjete edhe me OJQ dhe institucione tjera. *Sot janë aktive dhjetëra programe të atëhershme të regjistruar si persona juridik (fondacione, shoqata të qytetarëve ose ente të pavarura kulturore).*¹⁰⁴ Në vazhdim do të përmendim vetëm disa prej tyre: Qendra për Arte Bashkëkohore - Shkup, Forumi Arsimor Rinor, EUROTHINK – Qendra për Strategji Evropiane, Fondacioni për Internet dhe Shoqëri “Metamorfozis”, Shoqata për Zhvillim dhe Aktivizëm “Akua” - Strugë, Qendra për Zhvillim të Komunitetit – Kërçovë, Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm të Komunitetit - Dibër etj. Programi i Shoqërisë Civile filloi mbështetjen e krijimit të OJQ-ve, si një mënyrë për të inkurajuar pjesëmarrjen e qytetarëve në ndërtimin e idesë së një shoqërie të hapur dhe demokratike, ndërsa FOSM ofroi mbështetje materiale dhe teknike për OJQ-të dhe pranimin e tyre në organizata ndërkombëtare.

Për në fund mund të themi që, ashtu siç populli po e humbë besimin në aftësitë e institucioneve shtetërore tradicionale për tu angazhuar, vetë – monitoruar dhe për të reformuar praktikën e diskutueshme, ashtu edhe shfaqet nevoja për intervenime nga jashtë, apo nga aktorë tjerë. Padyshim, si një nga aktorët më të besuar për intervenime të tilla dhe adresimin e këtyre çështjeve, na paraqiten OJQ-të ndërkombëtare dhe ato të brendshme.

¹⁰³ Burim: <https://fosm.mk/25-godini-temi/foom-za-graganskoto-opshtestvo-vo-makedonija/>

¹⁰⁴ Vladimir Milçin, *25 vite dedikim*, Fondacioni Shoqëri e Hapur – Maqedoni, Shkup, 2018, fq. 200

III - Ndryshimet politike në Republikën e Maqedonisë gjatë periudhës 1991-2001

1. Pavarësia e Maqedonisë nga Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë

Në përpjekjet për shtetëformësimin e Republikës së Maqedonisë¹⁰⁵, me rëndësi janë tre data historike që kanë shënuar ngjarjet si: kryengritjen e Ilindenit të vitit 1903, mbledhjen e ASNOM-it, të vitit 1944 dhe referendumin për pavarësim nga ish RSFJ-ja në vitin 1991. Njohja e etnitetit maqedonas nga ana e Josip Broz Titos, gjatë periudhës së Luftës së dytë Botërore dhe krijimi i shtetit të veçantë pas luftës, brenda Federatës Jugosllave, i dha popullatës maqedonase një identitet të ri, i cili dallonte nga ai serb dhe bullgar, dhe me kalimin e kohës u pranua si i tillë. Mbledhja e parë e ASNOM-it, e mbajtur më 12 gusht të vitit 1944, konsiderohet gurthemeli i formimit të Maqedonisë si shtet në vetë. Ndërsa me miratimin e Kushtetutës së parë, në vitin 1946, u definua që populli maqedonas në bazë të vullnetit të lirë i bashkohet RSFJ-së dhe se Maqedonia do të jetë njëra nga gjashtë njësitë konstituive të federatës.

Në vitin 1945 u miratua kushtetuta federative, e cila karakterizohej me një centralizim të shprehur, duke u bazuar në kushtetutën e Bashkimit Sovjetik. *Federalizimi i centralizuar mbi të cilin ndërtohej edhe rregullimi i kushtetues – politik i Republikës Socialiste të Maqedonisë do të përjetojë ndryshime që shkonin në favor të njërive federative me amandamentet kushtetuese të vitit 1971, e sidomos me ndryshimet që i solli Kushtetuta e vitit 1974.*¹⁰⁶ Për dallim nga fazat e hershme të regjimit komunist, ku erdhi në shprehje parimi i unitetit të pushtetit në nivel të federatës, duke u lënë shumë pak hapësirë republikave për sovranitet më të gjërë. Ndryshimet në drejtim të sistemit shoqëror – politik filluan pas miratimit të Kushtetutës federale të vitit 1963, ku vetëqeverisja e klasës punëtore u shndërrua në një sistem të vetëqeverisjes shoqërore. Sistem ky, që u avancua edhe më shumë me kushtetutën e vitit 1974, në bazë të së cilës “socializmi vetëqeverisës” arriti kulmin e vet.

¹⁰⁵ “Republika e Maqedonisë”, emri kushtetues i shtetit për periudhën në fjalë dhe shkurtimi i tij “Maqedonia” do të përdoren sipas nevojës në këtë kapitull të punimit, edhe pse emri kushtetues i shtetit prej vitit 2018 është “Republika e Maqedonisë së Veriut”

¹⁰⁶ E. Aziri, po aty, fq. 74

Sa i përket statusit të Maqedonisë, si pjesë konstituive e RSFJ-së, mund të themi që si rrjedhojë e zhvillimeve politike në fazat e vonshme të ekzistencës së kësaj federate, ajo tentoi që në mënyrë graduale, të ndërmerr aktivitetet e nevojshme që çonin drejt pavarësisë së saj, në suaza të së drejtës për vetëvendosje, që ia mundësonte kushtetuta e vitit 1974. Jo rastësisht, shumë studiues mendojnë që me kushtetutën e vitit 1974, sistemi politik i RSFJ-së hyri në fazën, e cila shënonte shpërbërjen graduale të saj. *Në këtë kuptim, në veçanti vlen të ceket miratimi i amandamenteve kushtetuese të prillit të vitit 1989 dhe shtatorit të vitit 1990, të cilat nënkuptonin ndryshime shumë të rëndësishme në sistemin ekonomik dhe politik të republikës.*¹⁰⁷

Këto amandamente u pasuan edhe nga shumë ndryshime të tjera, mirëpo rëndësia e atyre qëndron në faktin që ato për herë të parë, u sollën në mënyrë të pavarur, pas mos ndodhur ndryshime të ngjashme në Kushtetutën federale, si dhe në faktin që ato mundësuan zëvendësimin e socializmit vetëqeverisës me sistemin parlamentar shumëpartiak.

Kriza ekonomike dhe ajo politike në të cilën gjendej RSFJ-ja për një kohë të gjatë, por që fshihej me mjeshtëri nga elitat politike, duke mos dashur të pranohet fakti që socializmi vetëqeverisës mund të gjendet në krizë, u thellua edhe më shumë pas vdekjes së Titos në maj të vitit 1980.

Gjatë kësaj periudhe, kishte shumë përpjekje për gjetjen e mënyrave për të dalë nga kjo krizë, dhe një ndër ato ishte edhe plani i reformave ekonomike të qeverisë së Ante Markoviqit, të cilat në fillim jepnin rezultate pozitive, por jo edhe aq sa për të shpëtuar vendin nga gjendja e krizës dhe për ta penguar shkatërrimin e sistemit socialist.

Demonstratat e studentëve shqiptarë të Kosovës, që shpërthyen në pranverën e vitit 1981, ndonëse herët, e paralajmëruan shpërbërjen e RSFJ-së. Ndërsa, ndryshimet politike dhe revolucionet që ndodhnin në fund të viteve 80' në vendet komuniste të Evropës Qendrore dhe Lindore, të përcjella me ngjarjen e rëndësishme të shembjes së Murit të Berlinit, vetëm se e përshpejtuan procesin e pavarësimit të njësive federale nga RSFJ-ja. Mundësinë e fundit për të shpëtuar federatën Jugosllave nga shpërbërja përfundimtare, elita politike e shihte te Kongresi XIV i jashtëzakonshëm i LKJ-së, i cili u mbajt në janar të vitit 1990 në një atmosferë tejet të tensionuar. Njëkohësisht, ky kongres ishte edhe ai i fundit i Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë, dhe ai kurrë nuk i përfundoi punimet e tij. Në këtë kongres u përballën dy tabore me tendenca

¹⁰⁷ E. Aziri, po aty, fq. 79

dhe koncepte të kundërta, në lidhje me atë se si e shihnin ardhmërinë e LKJ-së dhe RSFJ-së në përgjithësi. Në njërin anë ishin delegatët slloven dhe kroat, propozimet e të cilëve i hidhnin poshtë dhe i kundërshtonin përfaqësuesit e delegacionit serb. I vetmi vendim, që u miratua në këtë kongres ishte heqja e pozitës së monopolit të LKJ-së që e kishte të garantuar me kushtetutë. Ky akt, në një mënyrë nxiti formimin e partive të reja politike në të gjitha njësitet federale, dhe lehtësoi rrugën për të kaluar nga sistemi njëpartiak në atë pluralist.

Maqedonia, ishte Republika e vetme e cila u shkëput dhe shpalli pavarësinë e saj nga RSFJ-ja, në mënyrë paqësore dhe që nuk u prek nga pasojat e konflikteve ushtarake. *Për pavarësimin e Maqedonisë, gjegjësisht rrumbullakimin e shtetësisë së saj, me rëndësi të veçantë ishin tre momente: miratimi i Deklaratës për Sovranitetin e Maqedonisë, Referendumi për pavarësinë e Maqedonisë, dhe miratimi i Kushtetutës së vitit 1991.*¹⁰⁸ Deputetët e parlamentit të sapo formuar shumëpartiak, në 25 janar të vitit 1991, miratuan Deklaratën për Sovranitetin e Maqedonisë, në të cilën theksohej sovraniteti i shtetit maqedonas si dhe e drejta e popullit maqedonas për vetëvendosje. Kjo deklaratë, edhe pse u votua nga deputetët shqiptarë në parlament, ishte fillimi i kundërthënieve të popullatës shqiptare dhe asaj maqedone. Arsyet kryesore për këtë ishin, mospërfshirja e qytetarëve shqiptar si bartës të sovranitetit shtetëror dhe mospërfaqësimi interesave dhe kërkesave të tyre, si etnitet i barabartë dhe shtetformues.

2. Zgjedhjet e para të lira dhe demokratike

Në vrullin e ndryshimeve të brendshme politike dhe ekonomike që kishin kapluar të gjitha republikat e RSFJ-së, dhe duke a pasur të qartë që federata jugosllave, të paktën jo në atë formë, më nuk do të ekzistojë, në Republikën e Maqedonisë më 11 nëntor të vitit 1990, u zhvilluan zgjedhjet e para demokratike dhe shumëpartiake. Kuvendi i parë u themelua më 8 janar 1991, ku dhe filluan punimet për formimin e qeverisë dhe emërimin e kryetarit të shtetit. Kandidati për kryetar i propozuar nga partitë majtiste ishte Kiro Gligorov, i cili fitoi besimin dhe u votua nga deputetët në parlament, vetëm në tentimin e dytë, dhe kështu u bë Kryetari i parë i Maqedonisë, si republikë parlamentare shumëpartiake.

¹⁰⁸ E. Aziri, po aty, fq. 134

*Në 20 mars 1991 u zgjodh edhe Qeveria në krye të së cilës u gjend Nikolla Kljusev. Kjo qeveri kishte karakter mbipartiak dhe duhej të vepronte si qeveri e ekspertëve.*¹⁰⁹ Formimi i qeverisë ndihmoi konsolidimin e organeve shtetërore mbi parimin e ndarjes së pushtetit, dhe sipas programit parashihte implementimin e reformave të nevojshme në drejtim të demokratizimit të shoqërisë. Kjo strukturë qeveritare nuk qeverisi për një kohë të gjatë, dhe në korrik të vitit 1992 u shpërnda, pas votimit të mocionit të mosbesimit nga parlamenti.

Më 8 shtator të vitit 1991 u mbajt referendumi për pavarësinë e Republikës së Maqedonisë, ku qytetarët duhej të deklaroheshin në lidhje me pyetjen: *A jeni për një shtet sovran dhe të pavarur të Maqedonisë me të drejtën për të hyrë në një bashkim të ardhshëm të shteteve sovrane të Jugosllavisë?* Në referendum votuan 75.7% nga numri i përgjithshëm i votuesve, ndërsa 96.4% prej atyre që votuan, u shprehën pozitivisht. Rezultati i referendumit u shpall i vlefshëm, dhe 8 shtatori i vitit 1991 njihet zyrtarisht si dita e pavarësisë së Maqedonisë. Është e rëndësishme të cekim faktin, që në këtë referendum u shpreh vetëm vullneti i lirë i popullit maqedonas, pasi që populli shqiptar nuk morri pjesë dhe e bojkotoi atë. Arsyet ishin veçmë të njohura, subjektet politike shqiptare dhe populli shqiptar nuk ishin të kënaqur me statusin e tyre shoqëror si pakicë kombëtare, që buronte nga vendimi i elitave politike maqedonase, që Maqedonia në të ardhmen të zhvillohet si shtet unitar i popullit maqedonas. Ndërsa, arsyeja tjetër ishte pjesa e dytë e pyetjes së referendumit, e cila lejonte mundësinë e rihyrjes në bashkim me republikat e tjera të RSFJ-së.

Populli shqiptar, pakënaqësitë e akumuluar, revoltën ndaj politikës nacionaliste maqedonase, dhe kërkesat e tyre, në periudhën pasuese, i shprehu nëpërmjet protestave, ku në mes tjerash kërkohej e drejta për shkollim në gjuhën shqipe dhe avancimi i statusit të tyre shoqëror. Në rrethana të tilla, plot tensione dhe kundërthënie, më 17 nëntor 1991 u miratua Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë si shtet i pavarur, për të cilën deputetët shqiptar në parlament, nuk votuan. *Kushtetuta e vitit 1991, kurorëzoi deklarin e popullit maqedon për pavarësi, të shprehur në referendum. Ajo proklamoi shtetin nacional maqedon, duke suprimuar statusin shtetëformues të shqiptarëve, të cilin ata e gëzonin me Kushtetutën e vitit 1974.*¹¹⁰ Mbi bazën e këtij diskriminimi juridiko-kushtetues, u ndërtua koncepti i shtetit nacional dhe unitar të

¹⁰⁹ E. Aziri, po aty, fq. 133

¹¹⁰ A. Bajrami, po aty, fq. 268

maqedonasve, të cilin partitë politike shqiptare e quanin gjeneratorin kryesor të krizave të vazhdueshme socio - politike në vend.

Pas miratimit të kushtetutës, gjithçka po shkonte në drejtim të pavarësimit të plotë të shtetit, kështu që në dhjetor të po atij viti u miratua Deklarata për pranimin ndërkombëtar të Maqedonisë si shtet sovran dhe i pavarur, ndërsa në janar të vitit 1992 me ligjin kushtetues u mor vendim që ajo të mos participon në organet federative. Nënshkrimi i marrëveshjes për tërheqjen paqësore të trupave të Armatës jugosllave nga territori Maqedonisë, finalizoi shkëputjen nga RSFJ-ja në mënyrë të qetë dhe pa konflikte ushtarake. *Subjektivitetin juridik-ndërkombëtar Maqedonia e fitoi me tetë prill 1993, me rastin e pranimit të saj si anëtarja e 181-të e barabartë e Kombeve të Bashkuara.*¹¹¹ Ndërsa, për shkak të kundërshtimit të Greqisë në lidhje me zgjedhjen e emrit zyrtar Maqedoni, dhe përdorimin e yllit të Verxhinës si simbol në flamurin kombëtar, ajo u pranua me referencën e përkohshme IRJM (Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë). Kontest mbi çështjen e emrit, i cili do të zgjasë për një periudhë të gjatë kohore, dhe do të zgjidhet në qershor të vitit 2018 me nënshkrimin e Marrëveshjes së Prespës, në bazë të cilës, emri kushtetues i Republikës së Maqedonisë u ndryshua zyrtarisht në “Republika e Maqedonisë së Veriut”. Arritja e kësaj marrëveshje mundësoi vendosjen e raporteve të mira ndërfqinjësore dhe krijimin e parnteritetit strategjik midis Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë, e cila në këmbim të ndryshimit të emrit, pranoi se do të njohë shtetësinë dhe gjuhën maqedonase dhe se nuk do të pengojë anëtarësimin e vendit fqinjë në strukturat euro – atlantike.

3. Procesi i privatizimit gjatë periudhës së tranzicionit

Ashtu si dhe shumica e shteteve ish komuniste të Evropës Qendrore dhe Juglindore, edhe Republika e Maqedonisë kaloi fazën e tranzicionit, e cila në vete ngërtheu disa procese shumë esenciale, të cilat u zhvilluan në mënyrë paralele me të. Një prej atyre ishte procesi i privatizimit të pronës shtetërore, që u paraqit si nevojë dhe parakusht themelor për vendet që pësuan ndryshime rrënjësore të sistemit, dhe që dëshironin demokratizimin e shoqërisë dhe

¹¹¹ E. Aziri, po aty, fq. 147

funkcionimin e ekonomisë së tregut. Natyrisht që procesi i tranzicionit ishte i vështirë dhe i gjatë, i përcjellur nga shumë probleme dhe dukuri të ndryshme shoqërore që u paraqitën në mënyrë identike, gati se në të gjitha shtetet ish – komuniste. Problemet karakteristike, me të cilat ballafaqoheshin shoqëritë në tranzicion dhe të cilat gjeneronin krizën ekonomiko – politike ishin: inflacioni i lartë, rritja e papunësisë dhe të varfërisë, rënia e prodhimit industrial, politika sociale dhe qeverisja jo stabile, korrupsioni, privatizimi i pronës shtetërore në mënyrë kriminele, pasurimi i një grupi të vogël të oligarkëve politik, etj. Qasja dhe rruga e tejkalimit të këtyre problemeve ishte e ndryshme, por me prirje dhe qëllim që mjetet të jenë të njëjta, që në mënyrë institucionale të gjendet zgjedhja e tyre.

Krizat e njëpasnjëshme dhe gjendja e rëndë ekonomike, ishin rezultat i ndryshimeve radikale dhe të shpejta, që këto shtete i ndërmorën, duke e ndjekur metodën e ashtuquajtur *“shok terapi” (shock therapy)* të ekonomistit amerikan Xhefri Saks, që parashihte privatizimin e shpejtë dhe pa kompromis, pavarësisht pasojave. Kjo gjendje ishte gati se e njëjtë në të gjitha shtetet ish-komuniste, mirëpo me rëndësi është të veçojmë mënyrën dhe metodat e privatizimit, duke i ndarë ato në shtete ku privatizimi u realizua me triska (vauçerë) dhe pa para, dhe në ato shtete ku kjo nuk u bë, por në të cilat u përdorën metoda të tjera, si në rastin e Maqedonisë.

Përgatitjet për realizimin e procesit të privatizimit të pronës shtetërore në Republikën e Maqedonisë filluan në prag të shpërbërjes së RSFJ-së, ndërsa fillimi i relizimit të këtij procesi filloi nga mesi i vitit 1990, me miratimin e Ligjit federativ për transformim të Kapitalit Shoqëror. Procesi i privatizimit në bazë të këtij ligji, u zhvillua shumë shpejt dhe zgjati një vit, deri më gusht të vitit 1991, kur edhe u ndërpre privatizimi në Maqedoni, sipas modelit të Ante Markoviqit. Metoda më e përdorur në privatizimin e pronës shtetërore, sipas këtij modeli ishte nëpërmjet lëshimit të aksioneve interne të ndërmarrjeve, të cilat më shumë shkruheshin se sa në të vërtetë paguheshin, kështu që blerësit, përpos që vet e përcaktonin çmimin ato edhe gjetën mënyra që ato të blihen dhe të mos paguhen. *Një numër i madh ndërmarrjesh, 34.4%, në numrin e përgjithshëm të ndërmarrjeve, e filluan privatizimin në muajin dhjetor të vitit 1990, kur*

*vlera e kapitalit shoqëror rriti inflacionin, dhe vlera kontabël ishte më e ulët se sa ajo në vitin 1991.*¹¹²

Duke e pasur parasysh kontekstin kohor dhe rrethanat politike në të cilën gjendej federata jugosllave në përgjithësi, procesit i privatizimit në Maqedoni dhe po thuaj në të gjitha republikat tjera u zhvillua me shumë kontradikta dhe shumë të panjohura, duke u kthyer në një plaçkitje apo grabitje të pronës shtetërore, nga e cila përfituan dhe u pasuruan vetëm një grup i vogël oligarkësh politik. Procesi i privatizimit vazhdoi të realizohej edhe pas pavarësimit të Maqedonisë dhe kjo gjendje kaotike dhe e pa kontrolluar në skenën politiko – ekonomike të Maqedonisë, vazhdoi deri më 14 qershor 1993, kur Kuvendi i Republikës së Maqedonisë miratoi Ligjin për transformimin e ndërmarrjeve me kapital shoqëror dhe formimin e Agjencisë për transformimin e ndërmarrjeve me kapital shoqëror, e ashtuquajtura Agjenci për privatizim.¹¹³

Pas miratimit të këtij ligji, në vitin 1995 u miratua edhe Ligji për ristrukturimin e një pjese të ndërmarrjeve, të cilat gjatë punës së tyre pësuan humbje të mëdha, poashtu, në vitin 1996 u miratua Ligji për privatizimin e kapitalit shtetëror në ndërmarrjet dhe ligjet për ndërmarrjet publike, me çka, ndonëse vonë, u rregullua pjesa e ligjeve mbi procesin e privatizimit në tërësi. Ajo çka është me rëndësi të potencohet, është fakti që gjatë procesit të tranzicionit, e në veçanti nëpërmjet atij të privatizimit, shumica e popullatës mbetën të zhgënjyer, pasi që pritjet e tyre nga sistemi i ri demokratik dhe nga ekonomia e tregut, sidomos në fazat e hershme, nuk u përmbushën kurrë. Thënë ndryshe, procesi i privatizimit dhe ai transformimit të ndërmarrjeve me kapital shoqëror, nuk solli zhvillim ekonomik dhe industrial, nuk solli prosperitet dhe rritje të standardit jetësor, nuk rriti produktivitetin dhe aplikimin e teknologjive të reja, por përkundrazi, rriti papunësinë, stagnoi zhvillimin ekonomik dhe thelloi krizën në vend.

4. Konflikti i armatosur i vitit 2001 dhe pasojat

4.1 Statusi politik i popullit shqiptar dhe diskriminimi institucional ndaj tyre para vitit 2001

¹¹² J. Abdullai, po aty, fq. 95

¹¹³ Po aty, fq. 87

Diskriminimi institucional i popullit shqiptar, mohimi i pozitës së tyre si komb shtetëformues dhe mospërfillja e të drejtave dhe kërkesave të tyre nga ana e elitës politike maqedonase, u zyrtarizuan me miratimin e Kushtetutës së re të vitit 1991. Republika e Maqedonisë, si shtet sovran, i pavarur dhe demokratik, në bazë të Kushtetutës, u zotua në sundimin e së drejtës, respektimin dhe garantimin e lirive dhe të drejtave e të gjithë qytetarëve të saj, barazisë nacionale dhe bashkëjetesës ndërmjet popullit maqedonas dhe kombësive tjera në vend. Megjithatë, kjo kushtetutë e definoi Maqedoninë si shtet nacional, dhe jo qytetar, duke mos e prezantuar karakterin multinacional, multikonfesional dhe multikulturor të shtetit. Në periudhën e hershme të pluralizmit politik dhe të pavarësimit të Maqedonisë, populli shqiptar vazhdoi të jetë i diskriminuar dhe të vendoset në rangun e qytetarëve të rendit të dytë, duke mos shënuar asnjë zhvillim në drejtim të përmirësimit të statusit të tyre shtetëformues, dhe përparimit të të drejtave individuale dhe kolektive kombëtare.

Në periudhën në vijim, kërkesat e ndryshme legjitime të subjekteve politike shqiptare, në vazhdimësi injoroheshin dhe nuk u përmbushën nga qeveritarët maqedonas, dhe si kundërpërgjigje të kësaj politike nacionaliste, faktori politik shqiptar bojkotoi regjistrimin e popullsisë, Referendumin për pavarësi të Maqedonisë, dhe nuk e votoi miratimin e Kushtetutës në parlament. Hapi i radhës, të cilin e ndërmorën partitë politike shqiptare në këtë drejtim, ishte organizimi i Referendumi për Autonomi politike territoriale të shqiptarëve në Maqedoni, *i cili u mbajt më 11 dhe 12 janar të vitit 1992.*¹¹⁴ Në referendum, 99.9% prej numrit të përgjithshëm të qytetarëve që votuan në 17 komunat e banuara me shqiptarë, u deklaruan për, dhe kjo ishte hera e parë që populli shqiptar të shpreh vullnetin e lirë dhe të vendos për fatin e vet. Kuptohet që organizimi i këtij referendumi, u pranua me një dozë të madhe negativiteti dhe brengosi rrethet e politikës maqedonase, duke e shpallur atë si të pavlefshëm dhe destabilizues. Rezultati i këtij referendumi edhe pse kishte një domethënie shumë të madhe dhe dërgoi një mesazh të fuqishëm, për fat të keq, ai kurrë nuk u jetësua dhe nuk u implementua. Kjo erdhi kryesisht si rezultat i pavendosmërisë dhe paraqitjes së divergjencave ndërmjet përfaqësuesve të partive politike shqiptare të PPD-së dhe PDP-së, dhe anëtarëve të

¹¹⁴ E. Aziri, po aty, fq. 158

tjerë të Kuvendit organizativ, në lidhje me çështjen se a është koha e duhur që kjo Autonomi të jetësohet apo të vazhdohej me kërkesën e të drejtave në mënyrë institucionale.

Në periudhën pas organizimit të referendumit për Autonomi, diskriminimi institucional ndaj shqiptarëve vazhdoi, ndërsa në raste të caktuara ushtrohej me intensitet më të lartë, dhe kjo u dëshmuar në disa raste, ku aparati shtetëror tregoi anën e dhunshme dhe represive ndaj popullatës shqiptare. Ndodhitë më tronditëse, ku forcat policore maqedonase ushtruan dhunë të tepërt dhe jonjerëzore ndaj popullatës shqiptare, janë ndërhyrja policore në fshatin Ladorisht të Strugës dhe në lagjen Bit Pazar të Shkupit, të vitit 1992, të cilat mbetën si çështje të pambyllura dhe irrituan shumë opinionin shqiptar në Maqedoni dhe jashtë saj.

E ashtuquajtura “afëra e armëve” ndodhi në nëntor të vitit 1993, ku u arrestuan tetë qytetarë shqiptarë për shkak të dyshimeve se kanë bërë vepër penale bashkim për rrënimin e rendit kushtetues. Kjo ngjarje ngjalli shumë dyshime dhe mbeti e pasqarur deri në fund, nga popullata shqiptare u quajt një proces i montuar politik që për qëllim kishte disiplinimin, njollosjen dhe përçarjen e partive dhe popullit shqiptar.

Politika diskriminuese dhe represive maqedonase vazhdoi edhe në vitet në vijim, kështu që sfida tjetër dhe kërkesa e radhës e shqiptarëve ishte në lidhje me të drejtën e arsimimit në gjuhën shqipe në të gjitha nivelet, e në veçanti në atë sipëror. Procesi i barazimit dhe standardizimit të arsimit në gjuhën shqipe dhe definimit ligjor apo kushtetues ishte një proces i gjatë dhe i përcjellë me shumë kundërtënie ndërmjet bllokut politik maqedonas dhe shqiptar, por që më në fund u realizua me sukses. Hapi i parë në këtë drejtim ishte nisma e vitit 1992 për hapjen e Fakultetit Pedagogjik në gjuhën shqipe pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, i cili u realizua disa vjet më vonë, në mënyrë të cunguar dhe me kundërshtime nga rrethet nacionaliste maqedonase. Në ndërkohë, partitë politike shqiptare, të cilat kishin mbështetjen e popullit shqiptar, ngritën nismën për themelimin e Universitetit të Tetovës, i cili do ishte Universiteti i tretë shtetëror në Republikën e Maqedonisë. Kuptohet që Qeveria maqedonase këtë nismë që në fillim e kundërshtoi dhe e shpalli si jashtëligjore, duke i ndërmarrë të gjitha masat për pengimin e themelimit të këtij Universiteti. Një ndër ato masa ishte aksioni policor i dhjetorit të vitit 1994, ku forcat policore të armatosura sulmuan zyrën përgatitore të UT-së dhe konfiskuan të gjitha dokumentacionet dhe aparatet teknike, dhe

rrënimi me buldozer i objektit të Bashkësisë lokale të Reçicës së Vogël, ku ishte paraparë mbajtja ligjëratave në disa nga lëmenjtë e shkencave matematikore – natyrore.

E gjithë kjo nuk i zbrapsi, por vetëm i inkurajoi edhe më tepër intelektualët dhe popullin shqiptar në përgjithësi, që të vazhdojnë nismën e tyre legjitime. *Kështu, më 17 dhjetor 1994 në Tetovë, Këshilli për themelimin e UT-së, kryetarët e tre kuvendeve komunale, Tetovës, Gostivarit dhe Dibrës, në praninë e një numri të madh të përfaqësuesve politikë, kulturorë e fetarë dhe mjeteve të komunikimit masiv, e nënshkruan Aktin për themelimin e Universitetit të Tetovës.*¹¹⁵

Në shkurt të vitit 1995, në fshatin Poroj të Tetovës filluan ligjëratat e para, që nënkuptonte legalizimin e punës të UT-së para opinionit të brendshëm dhe atij ndërkombëtarë ndërsa qeveria e Maqedonisë edhe njëherë e kundërshtoi atë, duke i angazhuar sërish forcat policore. Këtë herë ata sulmuan me armatim të rëndë qytetin e Studentit, ku jetën e humbi një i ri i pafajshëm dhe u plagosën mbi 100 të tjerë, poashtu u burgosën disa intelektuale shqiptar, përfshirë edhe Rektorin e Universitetit dhe kryetarin e Senatit. Ky aksion policor, në vend që të akuzohej nga opinioni i gjerë, ai u përkrah, dhe para Kuvendit të Maqedonisë u organizua protesta e studentëve maqedonas në shenjë të mbështetjes të masave policore.

Këtë pjesë do ta rrumbullakojmë me ngjarjet e Gostivarit dhe të Tetovës të vitit 1997, ku pas zhvillimit të zgjedhjeve të dyta lokale erdhën në shprehje kundërthëniet ndërmjet pushtetit qendror dhe atij lokal, me fjalë të tjera u ashpërsuan raportet e Qeverisë maqedonase kundrejt komunave me shumicë të popullatës shqiptare. Me ngjarjet e Gostivarit të 9 korrikut, shteti maqedonas dhe qeveria e atëhershme e treguan anën më të vrazhdë dhe të paskrupull, duke ndërmarrë aksionin policor kundër popullatës civile shqiptare, me pretekstin se flamuri kombëtar shqiptar është përdorur në mënyrë të paligjshme nga ana e komunës. Në realitet, Këshilli i komunës së Gostivarit miratoi Statutin e vet që nga shkurti i vitit 1997, *ku në nenin 140 të këtij akti, në mënyrë të tërësishme e rregullonte çështjen e përdorimit të flamujve.*¹¹⁶ Gjykata Kushtetuese, solli masë të përkohshme për shfuqizimin të këtij akti, situata në vend u tensionua dhe kërcënonte eskalimin e raporteve ndëretnike. Qeveria e Maqedonisë, e ndikuar nga situata e përgatiti dhe miratoi Ligjin për përdorimin e flamujve të nacionaliteteve, me procedurë të përsheptuar, ku nuk u morën parasysh amendamentet e kryetarëve të komunave shqiptare.

¹¹⁵ Po aty, fq. 187

¹¹⁶ Po aty, fq. 191

Ligji në fjalë u miratua në orët e vona të tetë korrikut dhe hyri në fuqi menjëherë pas votimit. Kjo hapësirë ligjore, u shfrytëzua nga pushteti maqedonas, dhe në orët e hershme të mëngjesit, flamuri shqiptar dhe ai turk u hoqën nga ndërtesat e Komunës së Gostivari dhe të Tetovës, nga ana e njësive speciale të policisë. Atë ditë ndodhi skenari i përgatitur dhe agresioni policor ndaj popullatës shqiptare, të cilët u tubuan spontanisht para ndërtesës së Komunës së Gostivarit. *Pasojat nga intervenimi policor ishin rrëqethëse, epilogu i ndodhive të Gostivarit ishte 3 të vdekur, mbi 200 persona të lënduar rëndë, mbi 700 të rrahur dhe të keqtrajtuar, mbi 300 të arrestuar, mbi 50 persona të dalë para organeve gjyqësore për veprime kundërvajtëse.*¹¹⁷ Mbi 10 persona u paraqitën për procedurë penale, ne mesin e të cilëve edhe kryetari i Komunës së Gostivarit, Rufi Osmani, i cili atë ditë u mbajt i mbyllur në zyrat e Komunës nga ana forcave policore, dhe në shtator të atij viti u dënua në mënyrë të padrejtë me 13 vite e tetë muaj heqje lirie.

4.2 Konflikti i armatosur i vitit 2001

Diskriminimi dhe shtypja sistematike e popullit shqiptar, shkelja e të drejtave dhe mospërfillja e kërkesave të tyre legjitime, dhe të gjitha rastet tragjike që u përmendën më lartë, padyshim që janë shkaqet të cilat gjeneruan apo sollën konfliktin e armatosur të vitit 2001. Të gjitha këto ngjarje, ua bënë të ditur subjekteve politike dhe popullit shqiptar, që rruga institucionale, të cilën ato e kishin zgjedhur për të fituar të drejtat e tyre shtetëformuese, nuk jepnin rezultatin e duhur.

Konflikti i armatosur ndërmjet Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK) dhe forcave të sigurisë (ushtarake dhe policore) të Maqedonisë filloi në shkurt të vitit 2001, ndërsa përfundoi me nënshkrimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit më 13 gusht të vitit 2001, e ndërmjetësuar dhe garantues e së cilës ishte faktori ndërkombëtar. Gjatë konfliktit, mbi 200 njerëz humbën jetën e tyre, forcat policore dhe ushtarake humbën 75 pjesëtarë të tyre, ndërsa numri i viktimave të pjesëtarëve të UÇK-së ishte diçka më i lartë, rreth 85, numri i civilëve që humbën jetën ka qenë rreth 70, por ky nuk është një numër zyrtar. Më shumë se 100.000 njerëz ishin të detyruar të

¹¹⁷ Po aty, fq. 199

lëshojnë shtëpitë e tyre, duke u zhvendosur për të gjetur strehim në vend por edhe jashtë kufijve.

Është me rëndësi të potencohet fakti se strukturat e UÇK-së gjatë komunikatave të tyre, i bënë të qartë qëllimet e formimit dhe të veprimit të saj, duke u deklaruar opinionit brenda shtetit por edhe faktorit ndërkombëtar, që ato nuk luftojnë për ndryshimin e kufijve e as për federalizimin e shtetit, se ato nuk janë kundër sovranitetit të Maqedonisë, por luftojnë për përparimin e statusit kombëtar të shqiptarëve si popull shtetëformues. *Pra, strukturat e UÇK-së bënë të qartë se angazhohen për përdorimin e barabartë të gjuhës shqipe në të gjitha nivelet, shkollimin sipëror sipas kushteve të njëjta me maqedonasit, përdorimin e simboleve kombëtare, përfaqësimin proporcional në administratën shtetërore, ushtri, polici etj.*¹¹⁸ Nga të gjitha këto deklarata, ishte e qartë që qëllimet e UÇK-së nuk dallonin nga programet, platformat politike dhe kërkesat paraprake të subjekteve politike shqiptare, dhe se ky konflikt, i cili kurrë nuk morri përmasat e një lufte civile ndëretnike, ishte vetëm vazhdimësi e aktivitetit të tyre politik të organizuar, por me metoda dhe mjete tjera.

5. Marrëveshja Kornizë e Ohrit dhe ndryshimet kushtetuese

Konflikti i armatosur i vitit 2001, u përmbyll në mënyrë paqësore me nënshkrimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. Kësaj marrëveshje i paraprinë negociata, të cilat u zhvilluan gjatë muajve korrik dhe gusht të vitit 2001, në qytetin e Ohrit. Negociatat kanë zgjatur gati se një muaj, dhe në to kanë marrë pjesë kryetari i shtetit, përfaqësues të partive politike shqiptare dhe maqedonase, përfaqësues (ndërmjetësues) të lartë të Unionit Evropian dhe të ShBA-ve, si dhe ekspert apo këshilltarë të tjerë.

Pas përfundimit të negociatave me sukses, Marrëveshja Kornizë e Ohrit u nënshkrua më 13 gusht të vitit 2001, në Shkup. Nënshkrues të marrëveshjes janë: kryetari i Republikës së Maqedonisë, Boris Trajkovski, kryetarët e partive politike shqiptare, Imer Imeri - PPD, Arbën Xhaferi - PDSH, si dhe të atyre maqedonase, Branko Červenkovski - LSDM, dhe Ljubčo Georgievski - VMRO-DPMNE. Poashtu, si garantues nga ana e faktorit ndërkombëtar,

¹¹⁸ Po aty, fq. 205

nënshkrues të marrëveshjes janë edhe përfaqësuesit special: Fransoa Leotar (Unioni Evropian) dhe Xhejms Perdju (ShBA).

Marrëveshja Kornizë e Ohrit solli ndryshime rrënjësore në funksionimin e shtetit të Republikës së Maqedonisë dhe njëkohësisht duke i dhënë fund konfliktit të armatosur ndëretnik, e hapi rrugën për demokratizimin e mirëfilltë të shoqërisë dhe institucioneve shtetërore, si dhe vendosi bazën për zhvillimin e konceptit qytetar dhe atë të multikulturalizmit. Me fjalë të tjera, Maqedonia, nga një shtet që zhvillonte politikë diskriminuese dhe promovonte vlera vetëm të një grupi etnik, u shndërrua në një shtet me politikë të barazisë dhe inkluzivitetit shoqëror dhe institucional të të gjitha grupeve etnike që jetojnë në të.

*Marrëveshja e Ohrit me vlerat e saj garanton një barazi më thelbësore në Maqedoni, jo duke imponuar vlerat e njërit grupi etnik ndaj të tjerëve, por duke lejuar përdorimin e elementeve të identitetit të grupeve etnike, si: gjuha, religjioni, arsimit, simbolet kombëtare, kultura dhe elemente të tjera të identitetit.*¹¹⁹

Në esencë, kjo marrëveshje paraqet një bazë për avancimin e statusit juridiko – politik të shqiptarëve në Maqedoni, por duhet të potencohet fakti që kjo varet nga klima dhe rrethanat e përgjithshme politike, këmbëngulësia dhe homogjeniteti i partive politike dhe popullit shqiptar, si dhe nga vetëdijesimi i palës maqedonase, që kjo marrëveshje garantohet nga komuniteti ndërkombëtar, dhe se ato duhet të pranojnë sa më shpejt këtë realitet dhe të pajtohen me të.

Marrëveshja Kornizë e Ohrit parashikonte implementimin e ndryshimeve të rëndësishme në rendin kushtetues dhe politik në Maqedoni, me qëllim të përmirësimit të pozitës së përgjithshme të shqiptarëve dhe grupeve të tjera etnike, duke iu dhënë atyre më shumë të drejta kolektive.

Marrëveshja Kornizë e Ohrit është e përbërë nga pjesa themelore, që i identifikon problemet kryesore dhe ndryshimet për Republikën e Maqedonisë, dhe tre Aneksat.¹²⁰

Në vazhdim do të paraqesim parimet dhe ndryshimet kryesore në pika të shkurtra:

¹¹⁹ Blerim Reka, *10 Vite nga Marrëveshja Kornizë e Ohrit: A funksionon Maqedonia si shtet multietnik?*, (Bekim Kadriu, *Marrëveshja e Ohrit: Mjet për arritjen e barazisë reale në Maqedoni*), UEJL, Tetovë, 2011, fq. 73

¹²⁰ B. Reka, po aty, (Agron Rustemi, Albulena Halili, Elena Andreevska, Memet Memeti, Sevil Rexhepi, *Fryma politike dhe funksionimi i administratës shtetërore sipas Marrëveshjes Kornizë të Ohrit*), fq. 102

1. Parimet themelore, ku përfshihen: refuzimi i përdorimit të dhunës për arritjen e qëllimeve politike; pika ku thuhet që sovraniteti, integriteti territorial dhe karakteri unitar janë të pacenueshëm dhe duhet të rruhen; ruajtja e karakterit multi-etnik të shoqërisë në jetën publike; sigurimi që kushtetuta të plotëson dhe siguron nevojat e qytetarëve; zhvillimi i pushtetit vendor dhe rëndësia për nxitjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në jetën demokratike.
2. Ndërprerja e armiqësive: që parashihte ndërprerje të tërësishme të armiqësive, çarmatimin e tërësishëm vullnetar dhe shpërndarjen e grupeve të armatosura shqiptare, proces i ndihmuar nga forcat e NATO-s.
3. Zhvillimi i pushtetit të decentralizuar: do të realizohej nëpërmjet miratimit të Ligjit të reviduar për pushtetin lokal, me të cilin autoritetet lokale do të fitonin kompetenca shtesë të bazuara në kushtetutë, në sferën e financave, urbanizmit, arsimit, shërbimeve publike etj. Poashtu, do të revidoheshin kufijtë komunal, dhe zgjedhja e kryeshefëve lokal nga ana e këshilltarëve komunal, nga lista e propozuar nga Ministria e punëve të brendshme.
4. Mosdiskriminimi dhe përfaqësimi i drejtë: ky parim do të respektohet plotësisht nga të gjithë në bazë të ligjit, ndërsa do të aplikohet sidomos në punësimet në administratën dhe ndërmarrjet publike, të përfaqësimi i barabartë i komuniteteve në të gjitha organet publike dhe lokale, si dhe në procedurën e zgjedhjes së një të tretës së gjykatësve në Gjykatën Kushtetuese, zgjedhjen e Avokatit të popullit (Prokurorit publik) dhe zgjedhjen e tre anëtarëve të Këshillit Gjyqësor. Kjo procedurë nënkupton që ato do të zgjidhen nga Kuvendi me një shumicë të numrit të përgjithshëm të deputetëve, që do të përmbajë shumicën e numrit të përgjithshëm të deputetëve, të cilët pohojnë se u takojnë komuniteteve që nuk janë popullatë shumicë në Maqedoni.
5. Procedurat e posaçme kuvendore: nënkuptojnë që për miratimin e ligjeve që ndikojnë kulturën, përdorimin e gjuhës, arsimit, dokumentet personale dhe përdorimi i simboleve, si dhe ligjet për financat lokale, zgjedhjet lokale, qytetin e Shkupit dhe kufijtë e komunave, duhet të ketë shumicë të votave, dhe brenda tyre të ekzistojë shumica e

votave të deputetëve që pohojnë se u takojnë bashkësive që nuk janë popullatë shumicë në Maqedoni.

6. Arsimimi dhe përdorimi i gjuhëve: kjo pikë parasheh që shkollimi fillor dhe i mesëm të zhvillohet në gjuhën amtare të nxënësve, sigurimi i financimit të arsimimit sipëror nga ana e shtetit në gjuhët ku të paktën 20 për qind e popullatës e flasin në Maqedoni, në bazë të marrëveshjeve të veçanta; në Maqedoni dhe marrëdhëniet ndërkombëtare gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase, si dhe çdo gjuhë tjetër që flitet nga të paktën 20 për qind e popullatës; kjo vlen poashtu edhe për komunat ku komuniteti i caktuar përbën të paktën 20 për qind të popullatës si dhe për të gjitha procedurat penale dhe qytetare gjyqësore.
7. Shprehja e identitetit: nënkupton që pranë simbolit të Republikës së Maqedonisë, autoritetet lokale do ta kenë lirinë që në anën e parë të objekteve publike vendore, të vendosin simbolet me të cilat shënohet identiteti i komunitetit i cili është shumicë në komunë.
8. Implementimi: parashikon që amendamentet e propozuara në Aneksin A, të prezantohen menjëherë para kuvendit dhe të sigurohet miratimi i tyre në periudhën prej 45 ditëve nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kornizë; këtu duhet të përfshihen edhe ndryshimet në legjislacion të përcaktuara në Aneksin B; poashtu palët e përfshira i bëjnë thirrje komunitetit ndërkombëtar që sa më shpejtë të thirrnin konferencën e donatorëve, për të ndihmuar financiarisht implementimin e kësaj marrëveshje dhe rajonet e goditura nga luftimet.

9. Anekset

Anekset vijuese janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshje Kornizë:

A. Amendamentet Kushtetuese

B. Ndryshimet në Legjislacion

C. Implementimi dhe masat e besimit.¹²¹

¹²¹ Burim: https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/ramkoven_dogovor-3.pdf

10. Dispozitat përfundimtare: kjo marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin e saj, versioni në gjuhën angleze është versioni i vetëm autentik i kësaj marrëveshje dhe ajo u zhvillua nën patronatin e kryetarit Boris Trajkovski.

Aneksi A – parashihte ndryshime në Preambulë si dhe në 15 nene të Kushtetutës. Aneksi A thotë se Preambula e tanishme e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë zëvendësohet nga një gjuhë e bazuar në konceptet e të drejtave individuale dhe shoqërisë civile. Të gjithë 15 amendamentet kushtetuese u miratuan në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë më 16 nëntor të vitit 2001, dhe këtu u përfshinë ndryshimet në: Nenin 7, Nenin 8, Nenin 19, Nenin 48, Nenin 56, Nenin 69, Nenin 77, Nenin 78, Nenin 84, Nenin 86, Nenin 104, Nenin 109, Nenin 114, Nenin 115, si dhe në Nenin 131 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

Aneksi B – parashihte ndryshimet në legjislacion, që mundësuan miratimin e këtyre ligjeve:

- Ligji për vetëqeverisje lokale
- Ligji mbi financat lokale
- Ligji për kufijtë komunal
- Ligjet që i përkasin policisë të vendosur në komunat
- Ligjet mbi shërbimin civil dhe të administratës publike
- Ligji për njësitë zgjedhore
- Rregullat e kuvendit
- Ligjet përkatëse për përdorimin e gjuhëve
- Ligji për prokurorin publik
- Ligje të tjera¹²²

Aneksi C – parashihte pjesën e implementimit dhe të masave të besimit, me anë të së cilës u rregulluan këto çështje: *mbështetja ndërkombëtare; regjistrimi dhe zgjedhjet; kthimi i refugjatëve, ripërtëritja dhe rindërtimi; zhvillimi i pushtetit të decentralizuar; Mos-diskriminimi dhe përfaqësimi i drejtë; Kultura, arsimit dhe përdorimi i gjuhëve.*¹²³

¹²² B. Reka, po aty, (Agron Rustemi, Albulena Halili, Elena Andreevska, Memet Memeti, Sevil Rexhepi, *Fryma politike dhe funksionimi i administratës shtetërore sipas Marrëveshjes Kornizë të Ohrit*), fq. 105

¹²³ Burim: https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/ramkoven_dogovor-3.pdf

Këtë pjesë do ta përfundojmë me konkluzionin që Marrëveshja Kornizë e Ohrit nuk paraqet një marrëveshje të përsosur, por gjithsesi mund të shërbejë si një model i suksesshëm në rajonin e Ballkanit Perëndimor, për rregullimin e raporteve ndëretnike dhe të drejtave të pjesëtarëve të grupeve etnike jo-shumicë brenda një shteti. Kjo marrëveshje, duke i shmangur ndarjet dhe forcat destruktive i dha shans paqes dhe zhvillimit demokratik të shoqërisë, duke ua hapur rrugën sfidave të reja dhe aspiratave integruese euro – atlantike të shtetit. Marrëveshja Kornizë e Ohrit solli për disa muaj ndryshime, që në vitet e kaluara kërkoreshin në mënyrë të vazhdueshme nga shqiptarët në Maqedoni, megjithatë zbatimi i plotë i kësaj marrëveshje mbetet një sfidë e vërtet dhe mjet i rëndësishëm në drejtim të avancimit të pozitës së shtetit në perspektivën evropiane dhe në kontekst të rregullimit të brendshëm juridiko – politik, duke parandaluar në të ardhmen të ndodhin mospajtime eventuale apo konflikte të tjera në baza etnike.

6. Kriza politike në Maqedoni dhe sfidat me të cilat ballafaqohet shoqëria bashkëkohore

Që nga pavarësimi i Republikës së Maqedonisë në vitin 1991, në kontinuitet atë e kanë përcjellë kriza të ndryshme sociale, ekonomike dhe politike. Duke filluar nga periudha e hershme e tranzicionit dhe të përpjekjeve për demokratizim të shoqërisë, Maqedonia u ballafaqua me probleme të cilat ishin karakteristike gati se për të gjitha shtetet e Evropës Qendrore dhe Juglindore që kaluan nga sistemi njëpartiak komunist në atë demokratik. Ndërkaq, në periudhën e më vonshme, si pasojë e politikave të gabuara dhe diskriminuese të elitave politike maqedonase, Maqedonia u gjet në fazën ndoshta më të vështirë të historikut të saj si shtet i pavarur dhe sovran, dhe ajo ishte Konflikti i Armatosur i vitit 2001, që për fat të mirë përfundoi në mënyrë paqësore me nënshkrimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. Në këtë pjesë do të mundohemi që në mënyrë të shkurtër të shpjegojmë këto sfida, duke u përqendruar te ato me të cilat Maqedonia është ballafaquar në periudhën bashkëkohore dhe pas konfliktit të vitit 2001.

Mosimplementimi i plotë i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit – sipas shumë studiuesve, kjo çështje ka qenë dhe vazhdon të jetë gjeneruesi kryesor i krizave politike dhe të raporteve të tensionuara ndëretnike në vend. Kjo marrëveshje ishte e paraparë që të implementohet deri në vitin 2004, pra, tre vite pas nënshkrimit të saj, ndërsa nga kjo distancë kohore mund lirisht të thuhet që ajo ende nuk është plotësisht e implementuar. Sipas profesor Blerim Rekës, pikat kryesore ku kjo marrëveshje ende nuk është implementuar janë: *mosimplementimi përfaqësues, mosimplementimi zyrtar gjuhësor, mosimplementimi i ndërtimit të besimit dhe mosimplementimi buxhetor*.¹²⁴ Ndërsa shkaqet kryesore për këtë mund t'i gjejmë kryesisht te partitë politike maqedonase, të cilat nuk shprehën vullnet dhe gatishmëri për implementim të tërësishëm të këtyre parimeve, por edhe te partitë politike shqiptare, të cilat nuk kanë treguar një pajtueshmëri dhe konsistencë në politikën e tyre, për realizimin konkret të këtyre parimeve. Poashtu, faktorë të tjerë që ndikuan në zvarritjen e implementimit kësaj marrëveshje ishte shpërqendrimi apo zhvendosja e prioriteteve politike, sidomos në drejtim të zgjidhjes së kontestit të emrit me Greqinë, si dhe zbehja e interesit të komunitetit ndërkombëtar pas shtyrjes dhe mos zbatimit në kohë të parimeve themelore të marrëveshjes nga faktori politik i brendshëm.

Decentralizimi i pushtetit lokal – paraqet rezultat i procesit të diferencimit të institucioneve administrative, me anë të cilit arrihet rritja e përgjegjësisë të niveleve më të ulëta të institucioneve shtetërore dhe ndërmarrjeve publike. Decentralizimi është pjesë esenciale a procesit të demokratizimit të shoqërisë, ngase me atë vendimmarrja transferohet te instancat më të ulëta dhe kështu arrihet një transparencë më e madhe në procesin e vendosjes si dhe në qasjen që qytetarët duhet ta kenë të institucionet lokale përkatëse. Në periudhën e hershme të tranzicionit, kjo çështje zvarritej dhe u rregullua pjesërisht, duke rezultuar me shumë probleme në këtë fushë, siç ishin: dallimi i shprehur ndërmjet komunave, e sidomos ndërmjet atyre rurale dhe urbane; mungesa e partneritetit ndërmjet institucioneve qendrore dhe atyre lokale;

¹²⁴ B. Reka, po aty, (Blerim Reka, *Marrëveshja Kornizë e Ohrit – filozofi e re politike për funksionimin e shtetit multietnik*), fq. 13

mungesa e instrumenteve dhe mekanizmave mbikëqyrëse; probleme në decentralizimin fiskal dhe financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale, e shumë të tjera. *Edhe pse decentralizimi nënkupton reforma kushtetuese dhe ligjore, problemet politike janë pjesë e patjetërsueshme e këtij procesi. Procesi i decentralizimit është proces politik që varet nga vullneti i elitave politike.*¹²⁵ Në parim, ky proces kërkon vendosjen e raporteve të reja dhe të qëndrueshme midis pushtetit qendror dhe atij lokal për ndarjen e kompetencave, përgjegjësi dhe resurseve.

Zhvillimi i pushtetit të decentralizuar ishte një ndër parimet themelore të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, kështu që prej vitit 2001, implementimi i këtij parimi u bë i detyrueshëm, dhe filloi me miratimin e Ligjit për vetëqeverisje lokale të vitit 2002. Në këtë drejtim, Qeveria e atëhershme solli programin e ashtuquajtur Programi legjislativ i ligjeve të lidhura me decentralizimin, ku përfshiheshin Ligji për organizim territorial, Ligji për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale, Qytetin e Shkupit si dhe 40 ligje plotësuese të cilat e rregullojnë transferimin faktik të kompetencave. *Procesi i decentralizimit të kompetencave dhe resurseve filloi më 1 korrik të vitit 2005. Njësitë e vetëqeverisjes lokale (komunat dhe qyteti i Shkupit) filluan ti zbatojnë kompetencat e reja në kushtet e organizimit të ri territorial për vetëqeverisje lokale, me përfaqësues të rinj të zgjedhur të pushtetit lokal dhe me metodë të re për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale.*¹²⁶

Kriza politike – që nga fillimet e tranzicionit dhe të demokratizimit të shoqërisë, Republika e Maqedonisë është përballuar me sfida të ndryshme, që padyshim kanë destabilizuar jetën politike dhe janë reflektuar edhe në aspektin social dhe ekonomik të vendit. Procesi i privatizimit të pronës private në mënyrë jotransparente, lindja e korrupsionit si fenomen negativ shoqëror dhe zhvillimi i politikës diskriminuese institucionale nga partitë politike maqedonase, ishin vetëm disa prej problemeve që rezultuan me kriza politike të njëpasnjëshme, ne periudhën deri më vitin 2001. Kjo krizë politike kulminoi me Konfliktin e armatosur të vitit 2001, i cili u përmbyll në mënyrë paqësore me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit, në të cilën u parashikua avancimi i statutit juridiko – politik të shqiptarëve dhe minoriteteve që

¹²⁵ Etem Aziri, Jonuz Abdullahi, Ali Pajaziti, Memet Memeti, *Shteti i së Drejtës dhe Reformat në Administratën Publike: Rasti Maqedoni*, Qendra për Hulumtime në Administratën Publike – UEJL – Tetovë, 2008, fq. 47

¹²⁶ J. Abdullahi, po ay, fq. 169

jetojnë në Republikën e Maqedonisë. Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje pasoi periudha e implementimit të parimeve themelore dhe ndryshimeve kushtetuese që parashikoi ajo, mirëpo, ky proces pësoi ngecje serioze dhe këto ndryshime kurrë nuk u jetësuan plotësisht. Që nga ardhja në pushtet në vitin 2006, e veçanërisht që nga mos marrja e ftesës për anëtarësim në NATO në vitin 2008, si pasojë e vënies së vetos nga ana e Greqisë, partia djathtiste VMRO DPMNE zhvilloi një politikë të ashtuquajtur të “Antikuizimit”, si mjet për të rindërtuar identitetin kombëtar maqedonas dhe për të ushtruar presion ndaj politikës greke. Politika nacionaliste e kësaj qeverie u kurorëzua me implementimin e projektit “Shkupi 2014”, i cili parashihte ndërtimin e statujave të figurave historike të Aleksandrit të Madh dhe Filipit të dytë, rindërtimin e objekteve dhe institucioneve të kryeqytetit në stilin barok, si dhe riemërimi i shumë infrastrukturave publike pas këtyre figurave historike. Këto veprime u cilësuan si provokime direkte në Greqinë fqinje, dhe i përkeqësuan edhe me tej raportet edhe ashtu të brishta ndërmjet këtyre dy shteteve në lidhje me kontestin e emrit, duke penguar edhe më tej procesin e integritimit euro-atlantik të vendit. Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të qershorit të vitit 2008 u zhvilluan me shumë parregullsi, ku procesi demokratik u dhunua nga institucionet shtetërore në favor të partive në pushtet, ndërsa raportet që vinin nga Unioni Evropian dhe organizatat tjera ndërkombëtare ishin shqetësuese dhe shumë negative. Në vitin 2009, në zgjedhjet lokale dhe presidenciale, të cilat u zhvilluan relativisht qetë, partia në pushtet VMRO DPMNE arriti të fitoj “pushtetin absolut”, tani duke i pasur kandidatët e vetë në krye të postit të presidentit të shtetit dhe në postet e kryetarëve në shumicën e komunave maqedonase.

Në maj të vitit 2015, ishte fillimi i protestave kundër qeverisjes së kryeministrit Nikolla Gruevski dhe VMRO DPMNE-së, ndërsa arsyeja ishte publikimi i skandalit të përgjimeve nga ana e kryetarit të LSDM-së Zoran Zaev, ku thuhej që kjo qeveri ka përgjuar bisedat telefonike të qytetarëve të Maqedonisë. Mijëra qytetarë shprehën pakënaqësinë e tyre, përderisa protestat vazhduan të zhvillohen me kërkesë që Kryeministri të jep dorëheqje. Me arritjen e “Marrëveshjes së Przhinos” në qershor të vitit 2015, Gruevski dha dorëheqje, u vendos organizimi i zgjedhjeve të parakohshme parlamentare dhe situata dukej se u qetësua

përkohësisht. Në prill të vitit 2016 shpërthyen përsëri protestat që u quajtën “Revolucioni i Larëm”, dhe këtë herë qytetarët ishin kundër vendimit të presidentit Gjorgje Ivanov që të ndërpriten hetimet kundër Gruevskit dhe funksionarëve tjerë të përfshirë në skandalin e përgjimeve. Protestat vazhduan të zhvillohen me ditë të tëra në shumë qytete të Maqedonisë dhe u mbështetën nga mijëra qytetarë, ndërsa rezultuan me tërheqjen e vendimit të presidentit dhe me mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare më 11 dhjetor të vitit 2016, pasi fillimisht ishin planifikuar të mbahen më 24 prill, dhe më vonë në 5 qershor. Kjo shënoi edhe fundin e qeverisjes gati se 10 vjeçare të VMRO DPMNE-së në krye me Nikolla Gruevskin, pasi që LSDM e udhëhequr nga kreu i saj Zoran Zaev, pas zhvillimit të negociatave me partitë politike shqiptare të BDI-së, Besës dhe koalicionit Aleanca për Shqiptarët arritën të formojnë shumicë parlamentare. Kriza politike dyvjeçare kulminoi më 27 prill të vitit 2017, kur ndodhi incidenti i pushtimit të dhunshëm të Parlamentit të Republikës së Maqedonisë nga ana e qindra protestuesve maqedonas të grupit nacionalist "Për një Maqedoni të Përbashkët", me qëllim të pengojnë zgjedhjen e Talat Xhaferit për kryetar të Kuvendit. Megjithatë, Xhaferi u zgjodh kryetar i parlamentit, ndërsa zgjedhja e tij u njoh edhe nga faktori ndërkombëtar. Protestuesit e dhunshëm sulmuan fizikisht deputetët dhe gazetarët, ndërsa krerët e LSDM-së dhe Aleancës për Shqiptarët, Zoran Zaev dhe Zijadin Sela morën lëndime të rënda trupore.

Marrëveshja e Prespës – paraqet marrëveshje për zgjidhjen e kontestit të emrit, e nënshkruar më 17 qershor të vitit 2018 ndërmjet Greqisë dhe Republikës së Maqedonisë. Kjo marrëveshje u nënshkrua nga Ministrat e punëve të jashtme të Maqedonisë dhe të Greqisë, Nikolla Dimitrov dhe Nikos Kozijas, në prani të kryeministrave përkatës, Zoran Zaev dhe Alexis Tsipras si dhe nga ndërmjetësuesi i procesit të negociatave, përfaqësuesi i lartë i OKB-së, Methju Nimitz. Me Marrëveshjen e Prespës u zgjodhën mosmarrëveshjet pothuaj se 30 vjeçare të cilat filluan me pavarësimin e Maqedonisë dhe miratimin e kushtetutës të vitit 1991, ku u vendos përdorimi i emrit Maqedoni, përdorimi i flamurit zyrtar me simbolin e diellit të Verxhinës dhe me paraqitjen e disa qëndrimeve në lidhje me popullatën maqedonase që jeton jashtë kufijve të saj. Si rezultat i presionit të fuqishëm nga Greqia, kushtetuta e vitit 1991 pësoi ndryshimet e para ndërsa në vitin 1993 Maqedonia u pranua si anëtare e Kombeve të Bashkuara me

referencën e përkohshme IRJM. Marrëveshja e Prespës zëvendëson Marrëveshjen e Përkohshme të nënshkruar në shtator të vitit 1995 dhe sipas të njëjtës Republika e Maqedonisë ndryshoi emrin e saj kushtetues në Republika e Maqedonisë së Veriut, ndërsa Greqia do ta njohë shtetësinë e vendit fqinjë si maqedonas/qytetar i Republikës së Maqedonisë Veriore, do të pajtohet që gjuha zyrtare e shtetit të emërohet si gjuhë maqedonase dhe nuk do të pengojë anëtarësimin e shtetit në organizatat ndërkombëtare.

Më 20 qershor 2018, Marrëveshja e Prespës u ratifikua nga parlamenti i Republikës së Maqedonisë, me votimin e 69 deputetëve pro asaj, ndërsa më 25 qershor Ministria e Punëve të Jashtme e Greqisë informoi NATO-n dhe BE-në që ato nuk do jenë më pengesë për integrimet euro-atlantike të vendit, nën emrin e ri. Më 27 qershor Bashkimi Evropian aprovoi fillimin e bisedimeve për anëtarësim me Republikën e Maqedonisë, ndërsa në korrik të po atij viti NATO zyrtarisht ftoi vendin të fillojë bisedimet e pranimit në përpjekjen për t'u bërë anëtarja e 30-të e aleancës Euro Atlantike. Më 5 qershor marrëveshja u ratifikua përsëri në parlament, ndërsa në 30 shtator u mbajt referendumi konsultativ ku populli u shpreh në lidhje me Marrëveshjen e Prespës dhe ndryshimin e emrit të shtetit, ku 91% të votuesve votuan pro, me një dalje prej 37% nga numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar. Duke mos e arritur censusin e nevojshëm të daljes së votuesve prej 50%, rezultati i referendumit u bë objekt i shumë polemikave, kështu që mbështetësit e partisë në pushtet, LSDM-së e shpallën të suksesshëm, ndërsa partia opozitar e VMRO DPMNE-së, të cilët edhe e bojkotuan këtë referendum, e shpallën si të dështuar. Rrumbullakimi i ratifikimit të Marrëveshjes së Prespës ndodhi më 11 janar të vitit 2019, kur 81 deputet të Parlamentit të Maqedonisë votuan pro dhe miratuan ndryshimet kushtetuese që parashihte Marrëveshja e Prespës, ndërsa në Greqi me ratifikim e marrëveshjes në parlament, më 25 janar të atij viti, me 153 vota pro, 146 kundër, dhe 1 abstenim.

Procesi i integritetit në Bashkimin Evropian dhe anëtarësimi në NATO – ka qenë dhe mbetet orientimi i drejtë dhe i vetëm strategjik i Republikës së Maqedonisë, për krijimin e një stabiliteti politik, institucional dhe ekonomik. Maqedonia, është vendi i parë i Ballkanit perëndimor që

nënshkroi Marrëveshjen për stabilizim dhe asociim, ndërsa raportet me Bashkimin Evropian datojnë që nga viti 1992, edhe pse në këtë fazë ajo vetëm shfrytëzoi ndihmën kritike humanitare nga Programi Kritik për Ndihmë nga Zyra Humanitare e BE-së. Që nga viti 1995 Maqedonia u bë shfrytëzuese e fondeve nga programi PHARE, që parashihte ndihma në reformat e vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, që synojnë anëtarësimin në BE. Në vitin 1997 ajo nënshkroi marrëveshjen e parë zyrtare për bashkëpunim me BE-në, ndërsa në shkurt të vitit 1998 realizohet dialogu politik midis BE-së dhe Maqedonisë. *Më 8 shtator të vitit 1999, Komisioni Evropian aprovoi Direktivën për fillimin e negociatave me Maqedoninë për Marrëveshjen e stabilizimit dhe asociimit.*¹²⁷ Kjo direktivë parashihte fillimin e negociatave në fillim të vitit 2000, dhe me këtë Maqedonia u bë shteti i parë nga 5 shtetet e Evropës Juglindore që u ftua të fillojë negociatat për stabilizim dhe asociim me BE-në. Negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit me Komisioni Evropian zyrtarisht filluan më prill të vitit 2000, ndërsa pas përfundimit të negociatave, marrëveshja u nënshkrua më 9 prill 2001, dhe më pastaj në prill të vitit 2004 u ratifikua nga parlamentet shtetërore të vendeve anëtare. Në ndërkohë, më 22 mars 2004 Qeveria e Republikës së Maqedonisë bëri kërkesën për anëtarësim në BE, duke riafirmuar angazhimin e saj të vazhdueshëm dhe të qartë politik për t'u anëtarësuar në BE. *Në Samitin e Brukselit, më 17 dhjetor 2005, Këshilli Evropian vendosi që Republika e Maqedonisë të fitojë statusin e një vendi kandidat për anëtarësimin në BE. Që atëherë, në fund të vitit, Komisioni Evropian po boton raporte të rregullta për përparimin e Republikës së Maqedonisë.*¹²⁸

Më tetor të vitit 2009 Komisioni Evropian rekomandoi fillimin e negociatave për anëtarësimin e Maqedonisë në BE, ndërsa në nëntor të atij viti Këshilli Evropian miratoi vendimin për liberalizimin e vizave për qytetarët e Republikës së Maqedonisë, duke hyrë në fuqi më 19 dhjetor 2009. Në mars të vitit 2020, pas zhgënjimeve të viteve 2018 dhe 2019, Republika e Maqedonisë së Veriut mori përgjigje pozitive, pasi që Këshilli për çështje të përgjithshme në nivel të Ministrave për çështje evropiane të BE-së, zyrtarisht miratoi vendimin për fillim të negociatave për anëtarësim të vendit në BE.

¹²⁷ Blerim Reka, Arta Ibrahim, *Studime Evropiane: Identiteti, historia, integritet evropiane, institucionet, politikat, e drejta e Unionit Evropian*, UEJL, Arbëria Design, Tetovë, 2004, fq. 255

¹²⁸ Burim: <https://www.sobranie.mk/r-makedonija-na-pat-kon-eu.nsp>

Në prill të vitit 1999, në Samitit e NATO-s në Uashington, Maqedonia është bërë zyrtarisht vend kandidat për anëtarësim në Aleancën e Atlantikut të Veriut. Që atëherë, duke marrë parasysh konsensusin e të gjithë aktorëve politik në vend dhe mbështetjen e lartë të publikut për anëtarësim, Maqedonia vazhdimisht punon në ndërtimin dhe përmirësimin e marrëdhënieve me Aleancën. Në prill të vitit 2008, në Samitin e NATO-s të Bukureshtit, Maqedonia nuk pranoi ftesë për anëtarësim, edhe përkaj konfirmimit të përparimit të Maqedonisë dhe përmbushjes së kriterëve për anëtarësim, dhe kjo erdhi si rezultat i kontestit të pazgjidhur për emrin me Greqinë. Në Samitet e NATO-s të vitit 2009 (Strasburg dhe Këln), 2010 (Lisbonë), 2012 (Çikago), 2014 (Uells) dhe 2016 (Varshavë), kontributi i Republikës së Maqedonisë në operacionet ndërkombëtare të udhëhequra nga NATO dhe mbështetja për arritjen e qëllimeve janë mirëpritur vazhdimisht.¹²⁹ Megjithatë Aleanca ritheksoi qëndrimin e saj, që ftesa për anëtarësim do të dërgohet vetëm pas gjetjes së zgjidhjes reciproke për mosmarrëveshjen e emrit me Greqinë. Në Samitin e NATO-s në Bruksel, të mbajtur më korrik të vitit 2018, Republika e Maqedonisë zyrtarisht u ftua të filloj bisedimet e pranimit për anëtarësim në NATO. Më 11 shkurt 2020, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut ratifikoi Protokollin e Anëtarësimit në NATO. Pa vota kundër dhe abstenime, 114 deputetë votuan pro anëtarësimit të vendit tonë në Aleancën e Atlantikut të Veriut. Më 17 mars, Spanja ratifikoi Protokollin e Anëtarësimit në NATO, duke përfunduar kështu procesin e ratifikimit të këtij protokolli në të gjitha shtetet anëtare të Aleancës dhe i njëjti u depozitua në Uashington pas dy ditësh. Më 20 mars 2020, Presidenti Stevo Pendarovski nënshkroi instrumentin për pranimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Aleancën e Atlantikut të Veriut, ndërsa në 27 mars 2020, Republika e Maqedonisë së Veriut u bë anëtarja e 30-të e plotë e NATO-s.

¹²⁹ http://www.mod.gov.mk/?page_id=1960&lang=mk

Konkluzione dhe rekomandime

Gjatë procesit të hulumtimit dhe përgatitjes së këtij punimi, jemi përpjekur që të argumentojmë dhe të shfaqim idetë tona, duke mbështetur hipotezat që fillimisht i përpiluar dhe të cilët paraqiten si pikë referencë për analizën dhe qasjen tonë metodologjike. Ky punim bazohet kryesisht në tre hipoteza themelore, të cilat në vijim do të mundohemi që shkurtimisht t'i elaborojmë dhe sublimojmë, për të dhënë një pasqyrë më të qartë rreth tyre.

1. Zhvillimet dhe ndryshimet gjeopolitike në Ballkanin Perëndimor janë si pasojë e ndikimit permanent të aktorëve kryesorë të Luftës së Ftohtë.

Në periudha të ndryshme historike, territori i Ballkanit, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ka qenë nën ndikimin e vendimeve dhe politikave të fuqive të mëdha botërore. Kjo ishte më se e dukshme gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë, e në veçanti pas mbarimit të saj, me rënien e Murit të Berlinit, nga ku edhe filloi procesi i ndryshimeve rrënjësore politike dhe ekonomike në shtetet ish socialiste. Kjo valë e trazirave dhe ndryshimeve shoqërore që kaploi Evropën Qendrore dhe Lindore nuk i anashkaloi shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe shtetet që ishin pjesë e RSFJ-së. Procesi i tranzicionit të këto shtete u dëshmuar si mjaft i komplikuar, e sidomos pas shpërthimit të luftërave ndëretnike të disa prej tyre, gjatë procesit të pavarësimit nga federata jugosllave. Ndikimi i fuqive të mëdha, sidomos të ShBA-së dhe vendeve tjera të Evropës Perëndimore erdhën në shprehje dhe u rikonfirmuan gjatë intervenimit dhe angazhimit të tyre në procesin e përmbylljes së këtyre konflikteve në mënyrë paqësore dhe ristrukturimit territorial të shteteve, duke mbrojtur popullatën civile nga dhuna dhe krimet e luftës, në emër të vlerave demokratike dhe liberale. Prezenca dhe ndikimi i faktorit ndërkombëtar mbetet të jetë mjaft i fuqishëm në rajon edhe pas mbarimit të konflikteve ushtarake, nëpërmjet vendosjes së strukturave administrativo - institucionale dhe të trupave ushtarake të misioneve të ndryshme paqeruajtëse të udhëhequra nga ShBA, OKB, OSBE dhe NATO.

2. Procesi i tranzicionit i vendeve të Ballkanit Perëndimor, një proces i stërzgatur, që ndikoi në krijimin e krizave të njëpasnjëshme politike, sociale dhe ekonomike.

Republika e Maqedonisë së Veriut dhe shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor me fillimin e procesit të tranzicionit u ballafaquan me shumë vështirësi dhe sfida. Si shoqëri postkomuniste, ato u ndeshën me probleme shumë të ndërlikuara, të cilat ishin të përbashkëta gati se për të gjithë ato. Sfidat më të shpeshta u shfaqën sidomos në procesin e ngritjes dhe të konsolidimit të institucioneve demokratike, në reformat për funksionimin e ekonomisë së tregut, në privatizimin e pronës shtetërore, dhe vendosjen e një elite administrative efikase dhe të kompletuar, që sollën rrezikun e varfërimit social dhe mundësitë për shpërthimin e trazirave shoqërore si rezultat i pakënaqësive të akumuluar. Në dekadën e tretë nga pavarësimi dhe nga fillimi i tranzicionit, për fat të keq, këto shtete kanë bërë progres shumë të vogël dhe ende identifikohen me gjendje politike dhe ekonomike jo stabile, me indeks të ulët të demokratizimit të shoqërisë, me marrëdhënie të brishta ndëretnike, poashtu shënojnë ngecje në respektimin e të drejtave themelore të njeriut dhe në parimet e shtetit të së drejtës. Këto faktorë janë gjeneruesit kryesorë të krizave të njëpasnjëshme që kanë përcjellë këto shtete dhe nuk i kanë lënë të dalin nga procesi i stërzgatur i tranzicionit, duke e vështirësuar kështu edhe procesin e integritetit të rajonit në strukturat euro – atlantike.

3. Dialogu në rajon dhe marrëveshjet ndërfqinjësore janë mundësia më e mirë për tejkalimin e ndasive dhe problemeve të shumta, duke mundësuar fokusimin në sfidat e shekullit të ri.

Argumentimi i kësaj hipoteze dhe idetë të cilat e mbështesin, ndërliiden ngushtë me rekomandimet të cilat do mundohemi që ti elaborojmë. Si rrjedhojë, kjo hipotezë ka kuptimin e dyfishtë, dhe mund ta konsiderojmë edhe si rekomandim.

Gjuha e diplomacisë dhe dialogu paraqesin metodën më efektive për tejkalimin e problemeve dhe sfidave me të cilat janë përballuar shtetet post komuniste që nga pavarësimi i tyre. Kjo u dëshmuar më mirë gjatë konflikteve ushtarake, dhe marrëveshjet paqësore që sollën fundin e tyre, duke filluar nga Marrëveshja e Dejtonit në luftën në Bosnjë dhe Hercegovinë, Rezoluta 1244 e miratuar nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së që i dha fund agresionit serb në Kosovë, dhe duke vazhduar me nënshkrimin Marrëveshjes Kornizë të Ohrit që i dha fund Konfliktit të armatosur në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në historinë më të re, një shembull pozitiv dhe model për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërfqinjësore, që duhet ndjekur i gjithë rajoni, është Marrëveshja e Prespës, e nënshkruar nga

Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë në qershor të vitit 2018, duke përmbyllur kontestin shumëvjeçar në lidhje me emrin. Kjo mosmarrëveshje ishte faktori kryesor në ngecjen e procesit të anëtarësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO dhe Bashkimin Evropian. Nënshkrimi i kësaj marrëveshje jo vetëm që zhblokoi rrugën për anëtarësimin e vendit në strukturat euro – atlantike por kontribuoi edhe për vendosjen e raporteve të mira ndërfqinjësore, që do të iniciojnë dhe stimulojnë stabilizimin e gjithë rajonit dhe sigurimin e paqes afatgjate, duke lejuar mundësi për bashkëpunim dhe fokusim në tejkalimin e sfidave të të shekullit të ri dhe të kohës së Globalizimit.

Në vazhdim, nga e gjithë kjo që thamë, mund të nxjerrim disa konkluzione dhe rekomandime tjera mbi gjendjen reale politike dhe hapat të cilat duhet të ndërmerren për t'i tejkaluar këto sfida dhe probleme, duke krijuar kushte për stabilizim të vendit, dhe rajonit në përgjithësi.

- Raportet e tensionuara dhe mosmarrëveshjet ndërfqinjësore të shteteve të Ballkanit Perëndimor kanë penguar zhvillimin e proceseve demokratike dhe integrimin e rajonit në strukturat euro – atlantike.

Rekomandim: Mbetet nevoja që shtetet e Ballkanit Perëndimor nëpërmjet dialogut dhe zhvillimit të raporteve të mira ndërfqinjësore, të lënë anësh mosmarrëveshjet dhe të mbyllin çështjet e pazgjidhura, duke hapur rrugën për bashkëpunim të ndërsjellë, i cili do të mundësojë zhvillimin dhe inkuadrimin sa më të shpejtë të shteteve të rajonit në NATO dhe Bashkimin Evropian, dhe vendosjen e paqes afatgjatë në rajon.

- Ngecja në demokratizimin e shoqërive dhe zhvillimin ekonomik të vendeve të rajonit është pasojë e zhvillimeve socio - politike pas shpërbërjes së RSFJ-së, që rezultuan me luftëra ndëretnike për pavarësi, dhe tranzicion të stërzgatur.

Rekomandim: Vendet e Ballkanit Perëndimor duhet në mënyrë të unifikuar të angazhohen në zgjidhjen e problemeve kryesore sociale dhe politike të brendshme, si dhe gjetjen e një konsensusi për çështjet e pambyllura të politikës së jashtme, që vazhdojnë të jenë gjeneruesit kryesor të krizave të njëpasnjëshme politike dhe faktor destabilizimi për rajonin. Në këtë drejtim do të përmendim, njohjen e pavarësisë së Kosovës nga ana e Serbisë, vendosja e marrëdhënieve bilaterale midis këtyre dy shteteve, njohja përfundimtare e kufijve shtetërore në rajon, zhvillimi i raporteve miqësore ndërmjet tre etniteteve më të

mëdha në Bosnjë dhe Hercegovinë (Boshnjakëve, Kroatëve dhe Serbëve), normalizimi i raporteve ndërshtetërore ndërmjet Greqisë dhe Maqedonisë së Veriut pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Prespës etj.

- Zhvillimi i proceseve politike dhe demokratizimi në Republikën e Maqedonisë së Veriut pengohet nga polarizimi i skajshëm i aktorëve kryesorë politik në vend.

Rekomandim: subjektet politike maqedonase dhe shqiptare brenda strukturave të veta dhe ndërmjet tyre duhet të gjejnë gjuhë të përbashkët dhe të angazhohen në drejtim të interesave shtetërore prioritare, që do të sjellin një ardhmëri më të sigurt dhe mirëqenie për të gjithë qytetarët e saj. Me këtë nënkuptojmë vazhdimin e agjendës pro perëndimore dhe euro - atlantike, duke qenë të inkurajuar nga rezultatet pozitive të zhvillimeve të fundit, ku Republika e Maqedonisë së Veriut u bë zyrtarisht anëtare e NATO-s dhe morri ftesën për fillimin e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Kjo mund të arrihet vetëm me një bashkëpunim dhe unifikim të brendshëm të të gjithë faktorëve politik, duke vazhduar të angazhohen në drejtim të implementimit të reformave të suksesshme dhe zhvillimin e institucioneve dhe strukturave shtetërore demokratike dhe transparente.

Prioritete tjera për Republikën e Maqedonisë së Veriut mbeten: pavarësi dhe depolitizimi i pushtetit gjyqësor dhe i administratës publike, duke rritur efikasitetin dhe vendosjen e saj në shërbim të popullit, krijimi i mekanizmave për llogaridhënie dhe qasje të hapur për qytetarët brenda institucioneve publike, vendosja e mekanizmave për kontrollin dhe mbikëqyrjen e brendshme në institucionet e nivelit qendror dhe te ato të vetëadministrimit lokal. Më tej, do të theksojmë gjetjen e vullnetit politik për respektimin dhe implementimin e plotë të parimeve që dolën nga Marrëveshja Kornizë e Ohrit, avancimin e shoqërisë civile dhe zhvillimin e bashkëpunimit në mes aktorëve nga sektorë të ndryshëm, respektimi i të drejtave të njeriut dhe lirinë e mediave, funksionimi i shtetit të së drejtës, zhvillimi i dialogut politik parlamentar, lufta kundër korrupsionit dhe nepotizmit, funksionimi i mirëfilltë i demokracisë konsensuale, zhvillimi i bashkëpunimit dhe ruajtja e raporteve miqësore me organizatat joqeveritare ndërkombëtare me qëllim të avancimit të proceseve demokratike në vend, miratimi e implementimi i ligjeve konformë standardeve dhe legjislaturës evropiane, dhe decentralizimi eficient i pushtetit lokal dhe arritja e financimit të pavarur të njësive të vetëqeverisjes lokale.

Punimin e lekturoi prof. Gjylsime Zenuni – Jashari

Tetovë, qershor 2020

Bibliografia

- Arsim Bajrami, *Demokracia Palramentare: Aspekte Krahasese*, Prishtinë, 2005
- Bejtush Gashi, Pjetër Hidri, *Konfliktet Ndërkombëtare dhe Ndëretnike*, Prishtinë, 2008
- Blendi Fevziu, *100 Vjet (1912-2012)*, UET Press, Tiranë. 2012
- Бленди Февзиу, *Енвер Хоџа: Прва биографија заснована на документи од лична архива и на исповедите на оние што го познаваа*, Фондација Отворено Општество – Македонија, (превод од албански: Ким Мехмети), Скопје, 2014
- Blerim Reka, Arta Ibrahim, *Studime Evropiane: Identiteti, historia, integritet evropiane, institucionet, politikat, e drejta e Unionit Evropian*, UEJL, Arbëria Design, Tetovë, 2004
- Blerim Reka, *10 Vite nga Marrëveshja Kornizë e Ohrit: A funksionon Maqedonia si shtet multi-etnik?*, UEJL, Tetovë, 2011
- Elizabet M. Kusens, Çetan Kumar, Karin Vermester, *Ndërtimi i paqes si politikë: Ruajtja e paqes në shoqëritë e brishta*, Ars Lamina, Shkup, 2012
- Etem Aziri, *Sistemi politik i Republikës së Maqedonisë: Formimi, sfidat dhe perspektiva e zhvillimit demokratik*, Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, 2012
- Etem Aziri, Nazmi Maliqi, Ali Pajaziti, *Proceset e Integritet Euroatlantik dhe Republika e Maqedonisë*, Qendra për Hulumtime në Administratën Publike, UEJL - Tetovë dhe Friedrich Ebert Stiftung - Shkup, Tetovë, 2008
- Etem Aziri, Jonuz Abdullai, Ali Pajaziti, Memet Memeti, *Shteti i së Drejtës dhe Reformat në Administratën Publike: Rasti Maqedoni*, Qendra për Hulumtime në Administratën Publike – UEJL – Tetovë, 2008
- Francis Fukuyama, *Ndërtimi i Shtetit: Qeverisja dhe rendi botëror në shekullin e njëzet e një*, AHS, Tiranë, 2010
- Henry Kissinger, *Diplomacia*, Tiranë, 1999
- Joshua S. Goldstein, *Marrëdhëniet Ndërkombëtare*, Bot. i katërt, Dituria, Tiranë, 2003
- Jonuz Abdullai, *Ndryshimet Sociale dhe Tranzicioni*, CRPA & Arbëria Design, Tetovë, 2008
- Jonuz Abdullai, *Politika dhe Politikat Publike*, Arbëria Design, Tetovë, 2010
- Kalevi J. Holsti, *Shteti, lufta dhe gjendja e luftës*, Tiranë, 2008

- Lekë Sokoli, *Metodat e Kërkimit*, Instituti i Sociologjisë, Tiranë, 2011
- Lisen Bashkurti, *Diplomacia Shqiptare në fillimet e Luftës së Ftohtë, 1945-1961*, Vëllimi i dytë, Tiranë, 2003
- Lisen Bashkurti, *Diplomacia Shqiptare – Diplomacia e Vetëizolimit*, Vëllimi i tretë, Tiranë, 2004
- Radovan Vukadinoviç, *Marrëdhëniet ndërkombëtare nga Lufta e Ftohtë deri te rendi global*, Kolegji Universitar Victory, Prishtinë, 2007
- Samuel P. Huntington, *Vala e Tretë: Demokratizimi në Fund të Shekullit të Njëzetë*, AHS, Tiranë, 2011
- Samuel P. Huntington, *Përplasja e Qytetërimeve dhe Ribërja e Rendit Botëror*, Logos-A, Shkup, 2017
- Rexhep Meidani, *Mbi Qeverisjen, Pjesa e parë*, Botimet Dudaj, Tiranë, 2009
- Verner Vajdenfeld, *Demokracia dhe Ekonomia e Tregut në Evropën Lindore: Strategji për Evropën*, Argeta LMG & Shtëpia e Librit e Fondacionit Soros, Tiranë, 1999
- Vladimir Milçin, *25 vite dedikim*, Fondacioni Shoqëri e Hapur – Maqedoni, Shkup, 2018
- Zeqir Kadriu, Ejup Ajdini, Vebi Bexheti, *Shkrim Akademik: Doracak për studentë të viteve të para*, UEJL, Arbëria Design, Tetovë, 2006

Burime nga interneti:

- <https://www.cvce.eu/en/recherche/unit-content/-/unit/02bb76df-d066-4c08-a58a-d4686a3e68ff/812f82eb-0e36-4146-b935-b768901971e6>
- <https://www.nytimes.com/2004/01/03/opinion/after-the-cold-war-we-need-to-build-a-new-world-order.html>
- <https://www.ncafp.org/2016/wp-content/uploads/2018/05/Time-for-Action-in-the-Western-Balkans.pdf>, fq. 2
- <https://history.state.gov/milestones/1989-1992/breakup-yugoslavia>
- <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2014/04/Doktoratura-Elda-Zotaj-Instituti-Studimeve-Europiane.pdf>

- <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2018/10/Tranzicioni-A.-Nexhipi.pdf>
- https://www.palmecenter.se/wp-content/uploads/2014/03/ContextAna_2015_WESTERN-BALKANS_eng.pdf
- [https://www.nvosorabotka.gov.mk/sites/default/files/dokumenti/STRATEGY_FOR_COOPERATION_OF_THE_GOVERNMENT_WITH_THE_CIVIL_SOCIETY\(2012-2017\).pdf](https://www.nvosorabotka.gov.mk/sites/default/files/dokumenti/STRATEGY_FOR_COOPERATION_OF_THE_GOVERNMENT_WITH_THE_CIVIL_SOCIETY(2012-2017).pdf)
- <https://www.nvosorabotka.gov.mk/sites/default/files/ZZFprecistentekst2016.pdf>
(Закон за Здруженија и Фондации, Редакциски пречистен текст)
- <https://fosm.mk/25-godini-temi/foom-za-graganskoto-opshtestvo-vo-makedonija/>
- https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/ramkoven_dogovor-3.pdf
- <https://www.sobranie.mk/r-makedonija-na-pat-kon-eu.nspх>
- http://www.mod.gov.mk/?page_id=1960&lang=mk
- https://sq.wikipedia.org/wiki/Lufta_e_Kosov%C3%ABs